



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 658 Akti

Nr. 802 Vendimi
Tiranë, më 23.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Brunilda Bektashi	Relatore
Etleđa Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 23.9.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Flora Çela**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, administroi rezultatet e testimit nga

Shkolla e Magjistraturës dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Brunilda Bekteshi dhe Lulzim Hamitaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Brunilda Bekteshi.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesues komisioneri Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela. Subjekti i rivlerësimit me *email*-in e datës 2.2.2021 deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ sipas nenit 45 të këtij ligji, për të vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK, ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

7. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret, në datën 28.9.2023, me vendimin e ndërmjetëm nr. 2 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatorja e çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47

të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

8. Në datën 28.9.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 9.10.2023.

9. Në datën 8.10.2023, subjekti i rivlerësimit përmes postës elektronike¹ i dërgoi Komisionit parashtrimet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe i depozitoi ato pranë zyrave të Komisionit, protokolluar me nr. *** prot., datë 9.10.2023.

10. Në datën 6.10.2023, pranë Komisionit është depozituar për subjektin e rivlerësimit denoncimi nr. *** prot., datë 6.10.2023. Në datën 9.10.2023, Komisioni e njohu subjektin e rivlerësimit me këtë denoncim dhe njëkohësisht i kërkoi shpjegime brenda datës 10.10.2023 lidhur me pretendimet e parashtruara në të. Po në datën 10.10.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e saj dhe depozitoi dokumentacionin sipas kërkesës së Komisionit, i cili u administrua në dosjen e subjektit.

11. Komisioni, me vendimin nr. 3, datë 9.10.2023, vendosi ta ftojë subjektin për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative. Në datën 10.10.2023, Komisioni nëpërmjet postës elektronike njoftoi subjektin se seanca dëgjimore do të mbahet në datën 12.10.2023, ora 10:00.

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.10.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, ku subjekti paraqiti qëndrimin e saj dhe kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 12.10.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 16.10.2023, në orën 9:45, për shpalljen e vendimit. Në datën 13.10.2023, Komisioni për arsye objektive vendosi të shtyjë njoftimin e seancës për shpalljen e vendimit për në datën 17.10.2023, në orën 9:45, duke njoftuar subjektin e rivlerësimit, si dhe duke e publikuar këtë shtyrje edhe në faqen zyrtare të tij.

13. Në përfundim të seancës së datës 12.10.2023, trupi gjykues, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 58, nenit 44/b, si dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: “Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela dhe detyrimin e saj për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”. Vendimi i ndërmjetëm nr. 4, datë 17.10.2023, i pezullimit nga detyra të znj. Flora Çela për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimi për të ndjekur Programin e Trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës iu dërgua Shkollës së

¹ Me *email*-in datë 8.10.2023.

Magjistraturës, me qëllim përgatitjen e Programit të Trajnimit për subjektin e rivlerësimit sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, dhe u publikua në faqen zyrtare të Komisionit.

14. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2023, vendimi i Komisionit iu dërgua Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përgatitjen e programit të trajnimit për subjektin e rivlerësimit.

15. Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2024, ka dërguar pranë Komisionit rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit, bazuar në pikën 2 të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. ***, datë 30.7.2024.

16. Pas administrimit të këtyre rezultateve, trupi gjykues i mbledhur në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 5, në datën 16.9.2024 diskutoi, vlerësoi dhe vendosi të konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Flora Çela, duke vijuar me njoftimin e saj në seancë dëgjimore për shpalljen e vendimit përfundimtar.

17. Komisioni me anë të postës elektronike, në datën 17.9.2024, njoftoi subjektin e rivlerësimit se Shkolla e Magjistraturës, bazuar në pikën 2 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2024, ka dërguar pranë Komisionit rezultatet e provimit përfundimtar dhe rezulton se subjekti është vlerësuar gjithsej me 82.09 pikë, në nivelin “Mirë”, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Gjithashtu, e njoftoi se trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, vendosi ta ftojë në seancë dëgjimore për shpalljen e vendimit përfundimtar në datën 23.9.2024, në orën 9:45. Në këtë datë u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

20. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti

i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017² të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

22. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 29.3.2018, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Në datën 24.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

23. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu dhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

² Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

26. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* sipas formularit (shtojca nr. 2), datë 24.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

27. Apartament në Vlorë, blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012, në vlerën 30.000 euro. Burimi i blerjes së apartamentit:

- Llogari në Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën 8.650 euro + interesat, krijuar nga të ardhurat nga paga personale si prokurore dhe të ardhurat e bashkëshortit E.G (vërtetim datë 24.10.2016 nga Intesa Sanpaolo Bank, si dhe vërtetimi i lëshuar nga institucionet përkatëse mbi të ardhurat e krijuara nga pagat, shpërblimet etj., gjatë martesës);

- Kontratë dhurimi në shumën 225.791 lekë, nga nëna e subjektit, burimi i së cilës është kompensimi si rezultat i statusit të të përndjekurve politikë (bashkëlidhur kontrata, si dhe vërtetimi i burimit të të ardhurave).

- Kontratë kredie bankare pranë NBG Bank, sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 28.5.2015, në vlerën 25.000 euro (sipas kontratës bashkëlidhur dhe vërtetimit datë 20.1.2017, *specimenti* përkatës për detyrimet e mbetura dhe shumën e paguar) - 5.000 euro *cash* nga mbetja e kredisë, gjendje si detyrim ndaj shoqërisë “****”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës³.

³ Kontratë shitblerjeje paraprake nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012; mandat depozitimi *cash*, datë 6.10.2011, pranë Intesa Sanpaolo Bank, të shumës 3.300 euro, nga shtetasi E.G në llogarinë e shtetasve Flora Çela dhe E.G; mandat tërheqjeje *cash* datë 4.5.2012 pranë Intesa Sanpaolo Bank të shumës 8.650 euro nga shtetasi E.G në llogarinë e shtetasve Flora Çela dhe E.G; lëvizjet e llogarisë bankare në emër të shtetasve Flora Çela & E.G pranë Intesa Sanpaolo Bank gjatë periudhës 1.10.2008 – 4.5.2012; mandat depozitimi *cash* datë 4.5.2012 në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. pranë Societe Generale Albania të shumës 10.000 euro nga shtetasi E.G, me përshkrimin “pagesë këst apartamenti”; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2012, e shtetasës B.Ç; mandat tërheqjeje *cash* datë 14.6.2011 nga llogaria e shtetasës B.Ç pranë Raiffeisen Bank, të shumës 225.791 lekë; kontratë kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2015, me palë kredidhënëse NBG Bank dhe palë kredimarrëse shtetasit Flora Çela dhe E.G; kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.5.2015, me palë përfituese NBG Bank Albania dhe palë hipotekuese shtetasit B.Ç dhe F.B – bashkëlidhur mjetet e identifikimit të palëve pjesëmarrëse në kontratë – certifikatat familjare të hipotekuesve; certifikata e pronësisë së pasurisë nr. ***, “truall + ndërtesë” me sipërfaqe 238 m², në emër të shtetasve B.Ç dhe F.B - vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë trashëgimtarëve B.Ç e F.B, - kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2015, bashkëlidhur mjetet e identifikimit të palëve pjesëmarrëse në kontratë - certifikatat familjare të hipotekuesve; certifikata e pronësisë së pasurisë nr. ***, vol. ***, fq. ***, lloji “****” me sip. 39.96 m², në emër të shtetasit S.A.D, si dhe kartela e pasurisë; kërkesë për transferim fondi pranë NBG Bank, si dhe mandatet përkatëse, datë 18.6.2015, nga shtetasi E.G në favor të “****” sh.p.k., të shumës 22.000 euro me përshkrimin “Kalim fondi sipas kontratës së shitblerjes nga Flora Çela për “****” sh.p.k., nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012; kërkesë për transferim fondesh pranë NBG Bank, datë 18.6.2015, nga “****” sh.p.k. në favor të shtetasit E.G, të shumës 8.000 euro me përshkrimin “Kthim detyrimi nga *** sh.p.k. për E.G”. Mandate likuidimi për blerje pajisje/mobilim të shtëpisë, shumën 207.366 lekë dhe 1.500 euro (Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

27.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur:

- Është e paqartë shuma e likuiduar nga subjekti për blerje apartamenti në vitin 2012 në Vlorë, pasi referuar kontratës së shitblerjes paraprake nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012, ndër të tjera citohet se është likuiduar si vlerë kapari nga pala blerëse shuma 10.000 euro. Gjithashtu, rezulton se në datën 4.5.2012 shtetasi E.G (bashkëshorti) ka transferuar në favor të shoqërisë “***” sh.p.k. shumën 10.000 euro nëpërmjet Societe Generale Albania.

- Është i paqartë fakti se që nga viti 2012 deri në deklaratën e pasurisë Vetting janë likuiduar vetëm 24.000 euro, pasi konstatohet se kredia e marrë në NBG Bank, në shumën 22.500 euro, me qëllim blerje apartamenti, është kaluar në datën 18.6.2015 në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., e cila po në këtë datë kalon nga kjo shumë në llogarinë e bashkëshortit të subjektit shumën 8.000 euro, me përshkrimin “Kthim detyrimi”.

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me shumën e shlyer, si dhe detyrimin e mbetur të shoqërisë “***” sh.p.k., për blerjen e apartamentit me sip. 105 m² në lagjen “***”, Vlorë, në vitin 2012.

Hetimi i kryer nga Komisioni

27.2 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, në rubrikën “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, me përshkrimin “Tërhequr shuma e depozituar në Intesa Sanpaolo Bank, kursyer nga të ardhurat deri në vitin 2011, me qëllim pagesë kësti fillestar apartamenti. Kontrata e shitblerjes paraprake, ambient banimi apartament. nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012”. Gjithashtu, po në këtë rubrikë, subjekti ka deklaruar dhurimin e një shume prej 225.791 lekësh sipas deklaratës noteriale.

27.3 Në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar shumën e shlyer prej 10.000 euro dhe detyrimin në lidhje me kontratën e shitblerjes paraprake të apartamentit në vlerën 20.000 euro. Këtë detyrim subjekti e ka deklaruar edhe në deklaratat periodike vjetore për vitet 2013 dhe 2014.

27.4 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar marrjen e një kredie pranë NBG Bank sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol. në vlerën 25.000 euro. Gjithashtu ka sqaruar se: “Kredia është marrë për shtëpi, apartament në Vlorë sipas deklarimeve të mëparshme, dhe është disbursuar nga vlera 25.000 euro shuma prej 22.000 euro, e cila ka kaluar në favor të firmës së ndërtimit, duke kthyer një shumë prej 8.000 euro, nga të cilat me marrëveshje shuma 5.000 euro (cash) do t’i kalojë në momentin e certifikatës së pronësisë dhe 3.000 euro janë shpenzime për mobilim sipas faturës tek “***”, Tiranë, kolltuk dhe parket. Vlera prej 3.000 euro nga shuma 25.000 euro është ngrirë në bankë për shkak të garancisë së lënë. Shlyer nga detyrimi i shtëpisë 24.000 euro, detyrimi i mbetur 6.000 euro”.

27.5 Detyrimin e mbetur në vlerën 6.000 euro subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, si dhe në atë Vetting.

27.6 Nga dokumentacioni i administruar konstatohet se ZQRPP-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2017⁴, ka bashkëlidhur përgjigjen negative të ZVRPP-së Vlorë⁵, e cila nuk konfirmon pasuri të paluajtshme në emër të shtetasve E.G dhe Flora Çela.

27.7 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar me deklaratën *Vetting* kontratë shitblerjeje paraprake (ambient banimi apartament) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012, me palë premtuese shoqërinë “***” sh.p.k. dhe palë përfituese shtetasen Flora Çela, të një ambienti banimi, apartament me sipërfaqe totale rreth 105 m². Çmimi i shitjes së apartamentit 30.000 euro. Në këtë kontratë citohet se është likuiduar si vlerë kapari nga pala blerëse shuma 10.000 euro jashtë zyrës noteriale. Vlera e mbetur për likuidim prej 20.000 euro do të kryhet me mirëkuptim të palëve, deri në dorëzimin e apartamentit me çelësa në dorë.

27.8 Komisioni e ka pyetur⁶ subjektin lidhur me ecurinë e procesit të nënshkrimit të kontratës së shitjes, si dhe i ka kërkuar të depozitojë dokumentacion mbi statusin e kësaj pasurie. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar: *“Nga të dhënat e marra pranë zyrës noteriale L.C, konkretisht përmes email-it datë 22.7.2023, të dërguar nga kjo zyrë në email-in tim zyrtar, jam vënë në dijeni se shoqëria e ndërtimit, dhe konkretisht administratori i saj, ka njoftuar përmes email-it të tij në datën 12.5.2023 zyrën noteriale për daljen e certifikatës së regjistrimit të pronësisë, datë 18.1.2023, bashkëlidhur asaj edhe kartela e pasurisë me emrin Flora Çela, kodi unik ***, pasuri në zonën kadastrale nr. ***, nr. pasurie ***, sipërfaqe 94 m², të lëshuara nga ASHK Vlorë, datë 15.4.2023. Nga kjo kartelë rezulton se fitimi i pronësisë nga “***” është me leje legalizimi nr. ***, datë 30.6.2022, regjistruar me nr. ***, datë 15.12.2022. Aktualisht jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes së apartamentit”*.

27.9 FSHU-ja⁷ informon se me gjeneralitetet Flora Çela, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, identifikohet 1 abonent me kontratë furnizimi nr. ***, në instancën Vlorë. Nga të dhënat e kartelës identifikohet që kontrata e furnizimit në emër të Flora Çela është në instancën Vlorë, kabina elektrike me emrin “***”

27.10 UKT-ja⁸ nuk konfirmon të dhëna të regjistruara në sistem për këtë shërbim në emër të subjektit të rivlerësimit apo bashkëshortit të saj. ILDKPKI-ja⁹ ka vendosur në dispozicion të Komisionit procesverbalet e mbajtura me subjektin e rivlerësimit dhe dokumentacionin e depozituar ndër vite. Ndër të tjera, gjendet edhe librezja e UKT-së, e cila konfirmon kontratën nr. *** në emër të subjektit Flora Çela, në adresën rruga “***”, Vlorë.

27.11 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament

Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se si burim krijimi për këtë pasuri kanë shërbyer:

- tërheqja nga llogaria në Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 8.650 euro + interesat, krijuar nga të ardhurat nga paga personale si prokurore dhe nga të ardhurat e bashkëshortit E.G;

⁴ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.8.2017 (Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

⁶ Pyetësor nr. 3, datë 21.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 22.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

- dhurimi i shumës prej 225.791 lekësh nga nëna, burim i të cilave është kompensimi si rezultat i statusit të të përndjekurit politik;
- kredi bankare pranë NBG Bank sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., datë 28.5.2015, në vlerën 25.000 euro.

27.11.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 se “Ka paguar këst apartamenti”, duke tërhequr 8.800 euro pranë bankës, si dhe dhurimin e shumës prej 225.791 lekësh nga nëna e saj. Në deklaratën periodike të vitit 2015 ka deklaruar kredinë e marrë pranë NBG Bank, me qëllim blerje apartamenti.

27.11.2 Komisioni analizoi secilin prej burimeve të krijimit të kësaj pasurie, si më poshtë trajtuar e arsyetuar:

a. Në lidhje me shumën 8.650 euro, tërhequr nga llogaria në Intesa Sanpaolo Bank

i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 depozitën e çelur pranë Intesa Sanpaolo Bank në shumën 5.000 euro, si dhe shtesën në këtë llogari prej 3.300 euro në deklaratën periodike të vitit 2011.

ii. Nga korrespondenca e Komisionit me Intesa Sanpaolo Bank¹⁰, kjo e fundit informon se shtetasit Flora Çela dhe E.G kanë pasur llogari pranë kësaj banke. Nga analizimi i *statement*-it rezulton se bashkëshorti i subjektit, z. E.G, ka depozituar në datën 9.10.2009 shumën 5.000 euro, e cila është investuar në depozitë dhe në datën 6.10.2011 ai ka depozituar shumën 3.300 euro, e cila është investuar në depozitë së bashku me shumën e mëparshme. Nga ky investim janë përfituar interesa, në total në shumën 485,52 euro.

iii. Rezulton se shuma e akumuluar në llogari prej 8.650 euro është tërhequr në datën 4.5.2012 nga bashkëshorti i subjektit, me qëllim pagesën e këstit të apartamentit. Po në këtë datë, 4.5.2012, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën 10.000 euro në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. në ish-bankën Societe Generale Albania, me përshkrimin “Pagesë kësti apartamenti”. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burim krijimi i depozitës kanë qenë pagat e saj dhe të bashkëshortit.

iv. Komisioni e ka pyetur subjektin lidhur me burimin e krijimit të shumës 3.300 euro të depozituar në vitin 2011. Subjekti ka sqaruar: *“Në deklaratën vjetore të vitit 2010 është deklaruar kursim në vlerën 300.000 lekë nga të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e marra gjatë vitit 2010. Në deklaratën e vitit 2011 është deklaruar shtesë në llogarinë bankare 3.300 euro, depozituar në datën 6.10.2011. Pra, shumës së kursyer në vitin 2010 në vlerën 300.000 lekë, pra nga të ardhurat e këtij viti i është shtuar edhe kursimi ynë nga të ardhurat nga paga ime dhe bashkëshortit deri në muajin tetor 2011, duke u depozituar në datën 6.10.2011. Gjatë depozitimit të shumës prej 3.300 euro, në deklaratën e vitit 2011 është përcaktuar që depozita është nga të ardhurat tona, pavarësisht faktit se nuk është specifikuar në detaje kursimi ynë cash në vitin 2011, deri në muajin tetor të vitit 2011. Kjo për shkak se ne nuk kemi pritur mbylljen e vitit kalendarik për mbledhje kursimi, por e kemi kryer depozitim në përfundim të vitit kalendarik, pasi kemi vlerësuar mjaftueshmërinë e kursimit për mbyllje si depozitë bankare”.*

¹⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.4.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

v. Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2011, por ka deklaruar shtesën e depozitës, pa cituar specifikisht burimin e saj, që është pakësimi i gjendjes *cash*. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni vëren se nga njëra anë marrja ose jo në konsideratë e gjendjes *cash* nuk ka efekt në analizën financiare, pasi ajo rezulton pozitive, por nga ana tjetër deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit për pakësimin e *cash*-it përputhet me gjendjen *cash* me deklarimet e mëvonshme periodike, si dhe me deklaratën *Vetting*.

vi. Komisioni kreu analizën financiare për të parë mundësitë financiare të subjektit për të investuar në këtë depozitë në datën 9.10.2009, në vlerën 5.000 euro, si dhe për ta shtuar atë në datën 6.10.2011, në shumën 3.300 euro, duke përlogaritur të ardhurat e shpenzimet si më poshtë referuar:

- të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe bashkëshortit të saj, të konfirmuara nga institucione shtetërore, si dhe sipas *statement*-it bankar;
- të ardhurat nga dhurimi i nënës së subjektit të rivlerësimit sipas deklaratës noteriale të lëshuar prej saj;
- kredia e marrë në vitin 2011, në vlerën 420.000 lekë;
- shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare për periudhën e analizuar, duke u bazuar tek INSTAT-i;
- shpenzimet për qiranë sipas deklarimit të subjektit dhe deklaratave noteriale të depozituara;
- shpenzimet për pagesat e principalit + interesit të kredive të marra;
- ndryshimi në likuiditete, që konsiston në diferencën mes gjendjes së likuiditeteve në datën e analizuar me atë të vitit të kaluar;
- dhurimi i shumës 225.791 lekë nga nëna është konsideruar i shpenzuar, për sa kohë që nuk është deklaruar si gjendje *cash* nga subjekti i rivlerësimit.

vii. Nga përlogaritjet e kryera, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë shumën 5.000 euro në depozitë në vitin 2009, ta shtojë atë me 3.300 euro në vitin 2011, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

b. Në lidhje me dhurimin e shumës prej 225.791 lekësh nga nëna e subjektit

i. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhurimin e shumës 225.791 lekë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012. Për këtë dhurim, së bashku me deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar¹¹: deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.5.2012, të shtetasës B.Ç (nëna e subjektit të rivlerësimit), e cila deklaroi se i ka dhuruar vajzës së saj Flora Çela shumën prej 225.791 lekësh, në muajin korrik 2011, të cilën e ka përfituar nga fondi “Për dëshmipërblimin e të burgosurve politikë”, si trashëgimtare ligjore e shtetasit H.G (dokument i njësuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. *** rep., datë 24.10.2016); mandat tërheqjeje *cash*, datë 14.6.2011, nga llogaria e shtetasës B.Ç pranë Raiffeisen Bank, të shumës 225.791 lekë.

ii. Nga korrespondenca e Komisionit me Raiffeisen Bank, kjo e fundit¹² konfirmon se shtetasja B.Ç ka llogari pranë kësaj banke. Nga analizimi i *statement*-it të llogarisë së znj. Ç, Komisionit i rezultoi se ajo ka përfituar në datën 24.5.2011 shumën 225.791 lekë. Këtë shumë e ka tërhequr në

¹¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

datën 14.6.2011. Gjithashtu, rezultoi se znj. Ç. të njëjtën shumë e ka përfituar edhe në datat 14.6.2013 dhe 22.2.2021 (duke përfituar në këtë mënyrë këstet përkatëse si rezultat dëmshpërblimi për ish të dënuarit politikë).

iii. Nga analizimi i deklarimit të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, Komisionit i rezultoi se ky dhurim sipas deklaratës noteriale të lëshuar nga nëna e subjektit në vitin 2012 është kryer në korrik të vitit 2011, ndërsa subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhurimin e kësaj shume në vitin 2012.

iv. Komisioni, nisur edhe nga fakti se subjekti nuk e ka deklaruar shumën e dhuruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2011, për pasojë nuk e përfshiu atë në analizën financiare për vitin 2012.

vi. Ndërsa lidhur me ligjshmërinë e burimit të kësaj shume, Komisioni nuk konstatoi problematika për sa kohë ajo vjen si dëmshpërblim i zbatimit të një ligji nga një institucion shtetëror.

c. Lidhur me pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament

i. Rezultoi se në kontratën paraprake të shitblerjes datë 30.4.2012 citohet se është likuiduar si vlerë kapari nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale shuma 10.000 euro.

ii. Komisioni pasi konstatoi se kjo vlerë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit deri në fazën e hetimit, mori të mirëqenë kryerjen e kësaj pagese sipas parashikimit në kontratën paraprake të shitblerjes.

iii. Komisioni kreu analizën financiare në datën 4.5.2012, kur janë tërhequr kursimet nga llogaria bankare dhe në po këtë datë është paguar shoqëria në rrugë bankare, në vlerën 10.000 euro.

Në analizën e kryer janë përfshirë:

- të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe bashkëshortit të saj, të konfirmuara nga institucione shtetërore, si dhe sipas *statement*-it bankar;
- të ardhurat nga interesat e përfituar nga depozita.
- shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare për periudhën e analizuar, duke u bazuar tek INSTAT-i;
- shpenzime të kryera për qiranë, sipas deklarimit të subjektit dhe deklaratave noteriale të depozituara;
- shpenzime të kryera për pagesat dhe principal + interes i kredisë së marrë;
- pagesa e kaparit në datën 30.4.2012, në vlerën 10.000 euro, sipas kontratës, si dhe kësti 10.000 euro sipas depozitimit në llogarinë bankare të shoqërisë në datën 4.5.2012, konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012;
- ndryshimi në likuiditete, që konsiston në diferencën mes gjendjes së likuiditeteve në datën e analizuar me atë të vitit të kaluar. Meqenëse në vitin 2012 subjekti ka deklaruar 200.000 lekë kursime *cash*, Komisioni ka përlllogaritur në datën 4.5.2012 vlerën 66.666¹³ lekë të kursyer *cash* deri në këtë datë.

iv. Nga përlllogaritjet e kryera, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 1.109.001 lekë të paguajë shumën 20.000 euro (respektivisht

¹³ Vjen si rezultat i ndarjes në mënyrë të barabartë për çdo muaj. Pra 200.000 lekë/12 muaj x 4 muaj.

shumën 10.000 euro - datë 30.4.2012 dhe shumën 10.000 euro - datë 4.5.2012) për blerjen e apartamentit, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

d. Në lidhje me kredinë në NBG Bank

i. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 marrjen e një kredie pranë NBG Bank sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 25.000 euro. Në këtë deklaratë, subjekti ka sqaruar se kredia është marrë për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës dhe nga vlera 25.000 euro është disbursuar shuma 22.000 euro, e cila ka kaluar në favor të firmës së ndërtimit. Shoqëria e ndërtimit i ka kthyer një shumë prej 8.000 euro, nga të cilat me marrëveshje shuma 5.000 euro (*cash*) do t'i kalojë në momentin e marrjes së certifikatës së pronësisë dhe 3.000 euro janë shpenzuar për mobilim sipas faturave.

ii. Nga korrespondenca e Komisionit me ABI Bank (ish-NBG), kjo e fundit¹⁴ informon se shtetasja Flora S. Çela ka marrë një kredi në euro për blerjen e një apartamenti në datën 17.6.2015, në shumën 25.000 euro dhe me afat maturimi 17.6.2031. Bashkëhuamarrës në kredi rezulton shtetasi E.G dhe garantues janë shtetasit S.D, H.D, B.D, F.Q.B.

iii. ABI Bank, së bashku me shkresën përcjellëse, ka depozituar dosjen e plotë të kredisë. Nga analizimi i dokumentacionit rezultoi se është nënshkruar:

- Kontrata e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2015, me palë kredidhënëse NBG Bank dhe palë kredimarrëse shtetasit Flora Çela dhe E.G. Në kontratë, në nenin 1 të saj, konkretisht pikat 1.01 dhe 1.02 citohet se: *“Banka bie dakord t’u japë kredimarrësve një kredi në monedhën Eur në shumën 25.000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti me adresë lagjja “***”, Vlorë. Pjesëmarrja e kredimarrësve në këtë investim është në shumën 10.000 euro. Shuma e kredisë do të disbursohet në 2 këste. Shuma e kështit të parë që do të disbursohet menjëherë, është 90% e shumës së kredisë. Kësti i dytë prej 10% i shumës së kredisë do të disbursohet pas paraqitjes në ambientet e Bankës, brenda një muaji, të dokumentit të pronësisë për kolateralin e ofruar, të inskriptuar si hipotekë e nivelit të parë në favor të bankës”.*
- Shtesë kontrate kredie datë 16.6.2015 me palë kredidhënëse NBG Bank dhe palë kredimarrëse shtetasit Flora Çela dhe E.G, me qëllim saktësimin e përmbajtjes së kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2015.
- Kontrata e hipotekës nr.*** rep., nr. *** kol., datë 29.5.2015, ku hipotekuesit, znj. B.Ç dhe znj. F.B, hipotekojnë pasurinë e tyre truall + ndërtesë (banesë një kat me sip. 52 m²), me sip. 238 m², me adresë lagjja “***”, Lushnjë, e regjistruar pranë ZVRPP Lushnjë, në zonën kadastrale nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, në pronësi të znj. B.Q.Ç dhe znj. F.Q.B, që vërtetohet nga dokumenti hipotekor, lëshuar në datën 5.2.2015 dhe harta treguese e regjistrimit.
- Kontrata e hipotekës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2015, ku hipotekuesit, z. S.D dhe znj. H.D, hipotekojnë pasurinë e tyre “njësi” me sip. 39,96 m², me adresë rruga “***”, Tiranë, e regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, në zonën kadastrale nr. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, në pronësi të shtetasit S.A.D, që vërtetohet nga certifikata e pronësisë, lëshuar në datën 20.5.2014 dhe kartela e pasurisë së paluajtshme.

¹⁴ Me shkresën Nr. prot.*** datë 10.3.2021 të ABI Bank, administruar në dosjen e Komisionit.

iv. Nga hetimi rezultoi se kredia është disbursuar në datën 17.6.2015 në vlerën 22.500 euro dhe në datën 18.6.2015 është transferuar shuma 22.000 euro në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim fondi sipas kontratës së shitblerjes nga Flora Çela për “****” sh.p.k., nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012”. Po në këtë datë, 18.6.2015, shoqëria “****” sh.p.k. ka kthyer në llogarinë bankare në NBG Bank, të bashkëshortit të subjektit, shumën 8.000 euro, me përshkrimin “Kthim detyrimi”.

v. Për shumën e kthyer 8.000 euro, subjekti ka sqaruar se 5.000 euro janë gjendje *cash* në banesë, ndërsa pjesa tjetër është përdorur për arredimin e apartamentit.

vi. Komisioni konstatoi se kredia nuk është disbursuar e plotë për shkak të mospërmbushjes së kushtit të kolateralit. Kolateral nuk është vendosur apartamenti për të cilin po disbursohet kredia, pasi nuk ka qenë i hipotekuar, por janë vendosur pasuri të tjera.

vii. Për sa më sipër, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, për sa kohë ato burojnë nga kredia.

viii. Të ardhurat e përfituara nga kredia janë përfshirë në analizën financiare si burim i likuidimit të pasurisë 5.000 euro *cash* dhe 3.000 euro për arredimin e apartamentit.

ix. Nga analizimi i dokumentacionit të dosjes së kredisë rezultoi se në dokumentin e hartuar nga banka për planin e investimit, është cituar se: “Sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., nënshkruar datë 30.4.2012 dhe aneks-kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, çmimi i apartamentit është 35.000 euro”. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime¹⁵ lidhur me çmimin 35.000 euro, ndërkohë që sipas kontratës nr. *** rep., nr.*** kol., datë 30.4.2012 dhe deklarimit të saj, vlera e apartamentit ishte 30.000 euro. Subjekti në përgjigje ka sqaruar se: “Ndërmjet meje dhe firmës së ndërtimit “****” është nënshkruar kontratë në kushte noteriale pranë noterit publik, pasi është arritur në marrëveshje mbi çdo detaj të saj vetëm kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., nënshkruar në datën 30.4.2012, ku pasqyrohet se çmimi i shitjes së apartamentit është 30.000 euro. Administratori i shoqërisë së ndërtimit, z. Q.D, ka nënshkruar me vullnet të plotë këtë kontratë, sa kohë është kryer para noterit L.C dhe gjithashtu ka lëshuar në favor të kësaj kontrate edhe deklaratën noteriale, dorëzuar në pyetësin nr. 2, konkretisht “Deklaratë noteriale” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.6.2023. Në këtë deklaratë shprehimisht rezulton se vlera e shitjes së apartamentit është 30.000 euro, si dhe çdo sqarim për mënyrën e pagimit të detyrimit të saj ndaj firmës, duke përfshirë edhe këstin e fundit në shumën 6000 euro. ...Në çdo deklaratë periodike vjetore të saj nga momenti kur është lidhur kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., nënshkruar në datën 30.4.2012 e në vijim, çmimi i shitjes është deklaruar në vlerën 30.000 euro, dhe detyrimi i saj deri në momentin e aplikimit për kredi ka qenë 20.000 euro. ...Edhe në specifikimet në kontratën e kredisë sqarohet “kredi për blerje apartamenti” sipas kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012, duke mos iu referuar asnjë aneks-kontrate të nënshkruar nga unë apo shoqëria e ndërtimit.

...Sipas faturës datë 18.6.2015 është disbursuar shuma e kredisë prej 22.000 euro, por me specifikimin përfitues “****” në numrin e llogarisë së saj ***. Gjithashtu, në faturë specifikohet kalim fondi sipas kontratës së shitblerjes së Flora Çela dhe “****” nr. *** rep., nr. *** kol.,

¹⁵ Me pyetësin nr. 3, datë 21.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

*nënshkruar në datën 30.4.2012 ...Unë si subjekt deklarimi pasurie kam detyrimin të deklaroj çdo kontratë noteriale që ndryshon kushtet e shitjes, blerjes apo tjetër, që lidhen me pasuri të paluajtshme dhe, në rastin konkret, unë nuk kam nënshkruar asnjë kontratë tjetër për ndryshim kushtesh mbi pronën, të cilën duhet ta deklaroja. Nga të dhënat e marra, një akt me ekstremitetet e kërkuara nuk ekziston si kontratë noteriale (dokument zyrtar) e lidhur me vullnet mes palëve, meje si subjekt rivlerësimi dhe shoqërisë “****” pasi: 1. duke qenë akt noterial, do të duhet të regjistrohej si i tillë të paktën në një zyrë noteriale; 2. nuk ka pasur në asnjë moment shfaqje vullneti nga unë apo shoqëria e ndërtimit, administratori i saj, për të ndryshuar kushtet e përcaktuara në kontratën fillestare të shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012”.*

x. Në mbështetje të deklarimit të saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar kërkesat drejtuar institucioneve, si dhe përgjigjet e marra lidhur me këtë problematikë.

Subjekti i është drejtuar:

- ABI Bank lidhur me dosjen e kredisë, ku në përgjigje nuk ka marrë aktin e kërkuar noterial dhe i ka kërkuar kësaj banke kryerjen e një hetimi administrativ, si dhe të informohet mbi ecurinë e këtij hetimi;
- Noterit publik L.C, ku është hartuar kontrata e shitblerjes paraprake, e cila në përgjigje nuk konfirmon që aneks-kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, të jetë hartuar në zyrën e saj;
- Ministrisë së Drejtësisë, për t’i vendosur në dispozicion aktin noterial, si dhe informacion mbi noterin ku është përpiluar kontrata, e cila në përgjigje informon se nuk rezulton i regjistruar në këtë sistem nga ndonjë noter akti noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

xi. Nga hetimi i kryer, edhe Komisionit nuk i rezultoi e konfirmuar nga Ministria e Drejtësisë aneks-kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015.

27.12 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se mbetet i paqartë citimi i aneks-kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, në dokumentin e bankës, se çmimi i apartamentit është 35.000 euro.

27.13 Komisioni hetoi edhe në lidhje me ndonjë trajtim të mundshëm preferencial në përfitimin e kësaj pasurie, nisur nga fakti se subjekti ka aplikuar për një kredi 25.000 euro, kur detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë ishte 20.000 euro.

27.13.1 Komisioni i ka kërkuar¹⁶ subjektit të depozitojë kontrata të ngjashme të lidhura me shtetas të tjerë thuajse në të njëjtën kohë dhe sipërfaqe. Subjekti ka depozituar dy kontrata, konkretisht për dy apartamente, përkatësisht një me sipërfaqe totale 197 m², në vlerën 60.000 euro, nënshkruar kontrata në datën 7.10.2013 dhe për një tjetër apartament me sipërfaqe 105 m², në vlerën 30.000 euro, nënshkruar kontrata në datën 6.11.2014. Duket se njëra nga kontratat është me të njëjtin çmim blerjeje, si dhe kontrata e subjektit, pra 285 euro/m² (30.000 euro/105 m²), ndërsa kontrata tjetër ka çmim më të lartë sesa kontrata e subjektit, 304.5 euro/m² (60.000 euro/197 m²).

27.13.2 Komisioni gjithashtu iu referua edhe udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”. Sipas

¹⁶ Me pyetësin nr. 2, datë 5.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

këtij udhëzimi, rezulton se kostoja e shitjes në tregun e lirë të apartamenteve, në qytetin e Vlorës, është 60.298 lekë/m² sipërfaqe e shfrytëzueshme.

27.13.3 Në raport me këto të dhëna, konstatohet se apartamenti i porositur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012 është me sipërfaqe 105 m². Duke u bazuar në çmimet referuese, rezultoi se vlera e apartamentit është 6.331.290 lekë (105 m² x 60.298 lekë/m²). Kjo vlerë rezulton më e lartë nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 4.191.600 lekë¹⁷. Në këto kushte, rezultoi se kjo pasuri është blerë 2.139.690 lekë¹⁸ më lirë nga çmimet e tregut.

27.13.4 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se dukej se subjekti e ka përfituar këtë pasuri me trajtim preferencial, në raport me çmimet referuese të tregut.

27.14 Njëkohësisht, Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi midis subjektit të rivlerësimit për shkak të ushtrimit të funksionit dhe shoqërisë “***”, me administrator Q.D. Subjekti depozitoi përgjigjen e institucionit punëdhënës¹⁹, i cili konfirmon se ajo nuk ka hetuar çështje për/me shoqërinë “***” apo administratorin Q.D.

27.15 Bazuar në dokumentacion e administruar, Komisioni konstatoi se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

27.16 Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime bindëse dhe të depozitonte dokumentacion, pasi ngriti dyshime për vlerën reale të paguar për këtë pasuri, nisur nga faktet e dala se: (i) në kontratën e shitblerjes paraprake datë 30.4.2012 citohej se është likuiduar jashtë zyrës noteriale, si vlerë kapari nga pala blerëse, shuma 10.000 euro, ndërkohë që rezultoi se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pagesë; (ii) duke marrë të mirëqenë kryerjen e pagesës së kaparit, dukej se subjekti rezultonte në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në shumën 1.109.001 lekë, për të kryer pagesat në datat 30.4.2012 dhe 4.5.2012; (iii) në dosjen e kredisë citohej aneks-kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, ku çmimi i apartamentit pasqyrohet 35.000 euro; (iv) referuar çmimeve të tregut, dukej se pasuria apartament është blerë 2.139.690 lekë më lirë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

27.17 Në prapësimet e saj në funksion të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se nuk rezulton në pamundësi financiare, pasi, siç ka deklaruar gjatë hetimit administrativ, nuk është paguar asnjë vlerë kapari në vitin 2012, dhe e vetmja vlerë e paguar si këst i parë për blerjen e apartamentit është ajo e paguar në datën 4.5.2012 nga bashkëshorti i saj, përmes derdhjes në bankë të shumës 10.000 euro në llogarinë e firmës, me përshkrimin “Këst apartamenti”.

27.17.1 Sipas subjektit, gjetja e Komisionit në këtë pikë është bazuar në referimin e paragrafit të parë, pika 2 “Kushtet e kontratës”, të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.4.2012, në të cilin ndër të tjera shënohet “Likuiduar si vlerë kapari nga pala blerëse në vlerën 10.000 euro jashtë zyrës noteriale”, për të cilën ka shpjeguar se nga ana e saj dhe e bashkëshortit, katër ditë pas lidhjes së kontratës së datës 30.4.2012, është paguar me transfertë bankare shuma 10,000 euro si këst i parë

¹⁷ Konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012 (30.000 euro x 139.72).

¹⁸ Vjen si rezultat i diferencës së vlerës me çmime referuese dhe çmimit të paguar nga subjekti, pra 6.331.290 lekë - 4.191.600 lekë.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, depozituar me pyetësorin nr. 2, datë 5.6.2023.

i pagesës së apartamentit dhe përpara këtij momenti nuk është likuiduar/paguar në favor të shoqërisë ndërtuese ndonjë vlerë tjetër, as si kapar dhe as si këst për blerjen e apartamentit.

27.17.2 Sipas subjektit, shënimi në kontratë “Likuiduar si vlerë kapari nga pala blerëse në vlerën 10.000 euro jashtë zyrës noteriale” është lapsus apo gabim material i noterit, që rezulton e provuar nga analiza logjike e të dhënave të pasqyruara në dokumentet shkresore të administruara gjatë hetimit, konkretisht: (i) çmimi i blerjes së apartamentit sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., nënshkruar në datën 30.4.2012, është në vlerën 30.000 euro; (ii) shuma e paguar nga/në favor të firmës së ndërtimit për blerjen e këtij apartamenti është 30.000 euro (vlerë e cila përputhet me çmimin e plotë të përcaktuar në kontratë), e ndarë në: kësti i parë është paguar me faturë të datës 4.5.2012, derdhje E.G në llogari të firmës “****” pranë Societe Generale Albania; kësti i dytë është paguar përmes disbursimit të kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2015, kaluar në datën 18.6.2015, shuma 14.000 euro; kësti i tretë dhe i fundit është paguar në Raiffeisen Bank, datë 27.7.2023, sipas faturës me numër reference *** dhe faturës me numër reference ***, datë 27.7.2023, në llogari të noteres L.C pranë BKT-së, me përshkrimin “Këst i fundit i apartamentit sipas kontratës”; (iii) distanca kohore nga nënshkrimi i kontratës, datë 30.4.2012, deri në pagesën e vlerës 10.000 euro datë 4.5.2012, në favor të firmës është vetëm katër ditë, referuar edhe marrëdhënies së mirëbesimit midis palëve.

27.17.3 Subjekti ka shpjeguar se nga vetë përmbajtja e dokumentit “Tabelë përmbledhëse në PDF” që gjendet në praktikën dokumentare të marrjes së kredisë në vitin 2015, në të cilën pasqyrohet përmbledhje e kontratës së shitjes e datës 30.4.2012, rezulton se çmimi i apartamentit është 30,000 euro, sepse në këtë dokument shënohet “*Deal price 30.000 euro; costumer participation 10.000 euro; banks participation 25.000 euro*”, por ajo që duhet të theksohet, është fakti se edhe në këtë dokument të bankës të prodhuar në vitin 2015 shënohet se janë paguar vetëm 10,000 euro (pra, shumë e paguar në datën 4.5.2012). Ky fakt përjashton tërësisht mundësinë që në vitin 2012, krahas shumës 10,000 euro të transferuar në llogarinë e shoqërisë në datën 4.5.2012, të jetë paguar ndonjë vlerë tjetër. Edhe në kontratën e kredisë bankare me NBB Bank, shpjegon subjekti, rezulton se i referohen çmimit sipas kontratës së shitblerjes, datë 30.4.2012, ku thuhet se pjesëmarrja e subjektit është 10.000 euro.

27.17.4 Përveç dokumentacionit të dorëzuar dhe administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës subjekti ka depozituar edhe dokumentacion, duke sqaruar se: (i) Me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2023, i është kërkuar informacion shoqërisë “****” nëse nga ana e saj apo e bashkëshortit është kryer ndonjë pagesë në datën 30.4.2012 apo para kësaj date, në vlerën 10.000 euro, *cash* pranë zyrave të financës së shoqërisë apo në llogaritë bankare të saj. Shoqëria “****” ka konfirmuar se nuk rezulton që subjekti apo bashkëshorti i saj të kenë kryer derdhje të shumës 10.000 euro në bankë apo pranë zyrës së financës saj (*cash*), në favor të kësaj shoqërie, as në datën 30.4.2012, kur është nënshkruar kontrata dhe as në data para nënshkrimit të kontratës për efekt të shitblerjes së apartamentit sipas kontratës datë 30.4.2012; (ii) Me shkresën nr. *** prot., datë 30.9.2023, i ka kërkuar informacion bankës Societe Generale Albania (ku rezulton të ketë llogarinë bankare shoqëria e ndërtimit) nëse në llogarinë e firmës është kryer derdhje e shumës 10.000 euro, në datën 30.4.2012, apo para kësaj date për efekt të kësaj kontrate shitblerjeje. Nga banka është vënë në dispozicion *specimenti* i llogarisë së shoqërisë “****” (me autorizim të saj), nga data 1.1.2012 – 30.5.2012, nga këqyrja e të cilit nuk rezulton që

subjekti apo bashkëshorti i saj të kenë kryer ndonjë pagesë në favor të firmës për blerjen e apartamentit objekt hetimi as në datën 30.4.2012, kur është nënshkruar kontrata dhe as para kësaj date; (iii) Nga *statement*-et bankare rezulton se e vetmja pagesë në këtë periudhë, 1.1.2012 – 30.5.2012, është vetëm ajo e datës 4.5.2012, e kryer nga bashkëshorti në llogarinë e firmës së ndërtimit, me përshkrimin “Pagesë këst apartamenti”.

27.17.5 Subjekti, përveç sa më sipër, ka parashtruar analizë mbi dispozitat ligjore²⁰ të kaparit, parashikuar në Kodin Civil, dhe vendimin nr. 553/2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës ë Lartë²¹. Sipas subjektit, duke iu referuar përkufizimit të kontratës së kaparit, duke qenë se ajo siguron lidhjen e kontratës së shitjes dhe siguron ekzekutimin e saj, pagesa e kaparit do të kryhet ose në datën e nënshkrimit të kontratës, që kjo kontratë të sjellë pasoja, ose më parë se data e nënshkrimit të kontratës, dhe do të jetë pjesë e detyrimit të shumës totale të çmimit të apartamentit, pra pasurisë së paluajtshme. Në këto kushte, sipas subjektit, kapari është inekzistent, sepse: (i) nuk ekziston si pagesë e kryer në asnjë moment para apo ditën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, datë 30.4.2012, referuar *statement*-it bankar, dokument shkresor i “****”, dhe nuk është pjesë e çmimit të shitblerjes, sikurse kërkon neni 601-602 i Kodit Civil; (ii) ajo ka kryer pagesë kësti me përshkrimin “Këst apartamenti” datë 4.5.2012, në shumë 10.000 euro, 4 ditë pas nënshkrimit të kontratës datë 30.4.2012, pasi ka plotësuar shumën e plotë edhe me kontratën e dhurimit, marrë nga nëna e saj datë 4.5.2012, çka provon edhe vonesën prej 4 ditësh nga nënshkrimi i kontratës; (iii) kontrata duhet të interpretohet sipas nenit 681 të Kodit Civil.

27.17.6 Sipas subjektit, rezulton plotësisht e provuar se e vetmja shumë e paguar gjatë vitit 2012 është shuma 10.000 euro, transferuar në llogarinë e shoqërisë në datën 4.5.2012. Pamundësia financiare në shumën 1.109.001 lekë, në analizën financiare të Komisionit për blerjen e apartamentit, rezulton për shkak se në vitin 2012 është përlllogaritur pagesë në shumën 20.000 euro, nga 10.000 euro të paguar realisht. Në këto kushte, sipas subjektit, provohet se togfjalëshi “*likuiduar si vlerë kapari nga pala blerëse në vlerën 10.000 euro jashtë zyrës noteriale*” është lapsus, gabim material, dhe se situata e saj financiare është pozitive, megjithëse Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shumën e dhuruar me kontratën datë 4.5.2012 nga nëna e saj.

27.17.7 Përveç shpjegimeve sa më sipër, subjekti ka sqaruar se edhe aneks-kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, ku çmimi i apartamentit është 35.000 euro, nuk ekziston, referuar verifikimeve e dokumentacionit që ajo ka depozituar pranë Komisionit gjatë hetimit. Po ashtu, ajo ka depozituar shkresën nr. ***, datë 21.8.2023, e ABI Bank, nga e cila konkludohet se: “*Në dokumentacionin e dosjes së kredisë suaj të administruar pranë bankës, nuk është gjetur dokumenti i kërkuar prej jush “aneks-kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015”. Sjellim në vëmendjen tuaj se çdo dokument i administruar nga banka në dosje, me qëllim kryerjen e*

²⁰ Kuptimi i kaparit përcaktohet në nenin 601 të Kodit Civil, sipas të cilit: “*Kapar quhet shuma në të holla, që njëra nga palët i jep tjetrës për llogari të shumës që do t’i paguhet në bazë të kontratës, me qëllim që të vërtetojë lidhjen e kontratës dhe të sigurojë ekzekutimin e saj*”. Ndërsa në nenin 602, nën titullin “Efektet juridike” përcaktohet se: “*Kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka dhënë kapar, kjo palë e humbet kaparin; kur kontrata nuk ekzekutohet nga faji i palës që ka marrë kaparin, kjo palë është e detyruar të kthejë dyfishin e kaparit. Pala që ka faj për mosekzekutimin e kontratës, është e detyruar t’i shpërblejë palës tjetër edhe dëmin, duke llogaritur në shpërblimin e këtij dëmi dhe shumën e kaparit, përveç kur në kontratë është parashikuar ndryshe*”.

²¹ Vendimi nr. 553/2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë analizon se kapari ka një funksion të dyfishtë: (i) të vërtetojë lidhjen e kontratës; (ii) të sigurojë përmbushjen e saj: “*Kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës.*”

analizës së kredisë, vihet në dispozicion nga klienti në momentin e aplikimit për kredi”. Më tej, ABI Bank informon se banka ka akorduar kredinë ku pjesëmarrja ime, sqaron subjekti, është në shumën 10.000 euro.

27.17.8 Në lidhje me analizën e çmimit të blerjes së apartamentit me çmim më të lirë se vlera e tregut, subjekti ka sqaruar se momenti i prenotimit të këtij apartamenti prej saj është në datën 30.4.2012, kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes paraprake me firmën. Subjekti ka parashtruar se sipas dokumentacionit leja e ndërtimit të objektit është zbardhur në muajin janar të vitit 2012. Subjekti ka prapësuar, duke sqaruar se në analizën e kryer mbi çmimin e shitjes, sipas EKB-së për vitin 2012, referenca e çmimit të tregut duhet të lidhet edhe me momentin e prenotimit të apartamentit. Në kushtet kur firma sapo kishte filluar punimet e ndërtimit, çmimi i shitjes do të ishte jo kaq afër çmimit mesatar të tregut të lirë, të caktuar nga EKB-ja. Çmimet janë më të ulëta në momentin fillestar kur nis objekti, sesa në momentin e përfundimit të tij dhe pajisjes me certifikatë pronësie. Subjekti ka paraqitur kontrata të ngjashme gjatë hetimit, duke sqaruar detaje të aplikimit të çmimeve në raport me sipërfaqen dhe vitet përkatëse, duke theksuar se kontrata e saj me shoqërinë e ndërtimit mban datën 30.4.2012, dhe leja e ndërtimit të marrë nga shoqëria e ndërtimit është sipas vendimit datë 28.9.2011, nr. ***, zbardhur në datën 18.1.2012, çka sipas saj tregon se punimet e ndërtimit kanë qenë të reja dhe në fillim të tyre. Nisur nga këto fakte, të provuara me dokumentacion shkresor, sipas subjektit, nga ana e Komisionit nuk mund të bëhet analiza e çmimit të shitjes vetëm mbi shifra të pasqyruara në kontratë, por edhe mbi bazën e të gjitha kushteve e rrethanave në të cilat ajo ka porositur dhe më pas ka blerë këtë apartament. Subjekti ka sqaruar se zona në të cilën ndodhet apartamenti nuk ka qenë zonë me përparësi investimi, kanë qenë vetëm dy pallate të ndërtuara shumë vite më parë dhe nuk ka pasur infrastrukturën përkatëse. Po për këtë çështje, subjekti shpjegon se referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”, sipas këtij formulari të tabelës së EKB-së, përcaktohet kostoja e ndërtimit për metër katror në vlerën 30.147 lekë, kurse kostoja e sipërfaqes së shfrytëzimit të ndërtimit është 36.712 lekë. Çmimi i shitjes për metër katror në këtë apartament është 285 euro, që në këmbim rezulton 39.814 lekë, pra më lart se kostoja e përcaktuar nga EKB-ja sipas udhëzimit më lart. Subjekti ka konfirmuar se apartamenti është blerë në vlerën 30.000 euro. Referuar këtij udhëzimi, duke qenë se kostoja e sipërfaqes së ndërtimit është 30.147 lekë, dhe sipërfaqja e objektit është 105 m², në total rezulton se vlera e shitjes është 3.165.435 lekë. Ndërsa në analizë me vlerën e koston së sipërfaqes së shfrytëzimit të ndërtimit, po sipas këtij udhëzimi vlera e apartamentit prej 105 m² është 3.854.760 lekë. Vlera prej 30.000 euro, duke iu referuar kursit mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012 (30.000 x 139.72), i përket shumës prej 4.191.600 lekësh. Në rastin konkret, rezulton e provuar se vlera e apartamentit dhe kostoja e ndërtimit të tij, pra investimi i firmës, është 3.165.435 lekë, ndërsa po ta analizosh me vlerën e koston së sipërfaqes së shfrytëzimit të ndërtimit, vlera e shitjes së apartamentit rezulton të jetë 3.854.760 lekë. Subjekti sqaron se, sipas kësaj analize, çmimi i shitjes dhe blerjes së apartamentit objekt hetimi, nga ana e saj, është më shumë se çmimi i tij sipas analizës, po të shitej me koston e sipërfaqes së ndërtimit dhe më e madhe se çmimi i tij po të shitej sipas koston së sipërfaqes së shfrytëzimit të ndërtimit, pra konkretisht është 1.026.165 lekë më shumë se vlera e koston së sipërfaqes së ndërtimit dhe 336.840 lekë me vlerën e koston së sipërfaqes së shfrytëzimit të ndërtimit.

27.17.9 Në lidhje me trajtimin preferencial, subjekti ka shpjeguar se referuar nenit 23 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, rezulton se për të qenë në kushtet e trajtimit preferencial duhet të plotësohen në mënyrë kumulative²² kushtet: (i) subjektit të deklarimit duhet t'i jepen shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme, të cilat mund të jenë edhe në përdorim të tij; (ii) këto shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme duhet t'i jepen subjektit të deklarimit për shkak të detyrës së tij; (iii) këto shërbime, mallra ose përfitime të tjera të ngjashme duhet t'i jepen subjektit të deklarimit pa shpërblim. Ajo ka theksuar se përveçse çmimi është i ngjashëm me kontrata të tjera të shoqërisë, është provuar mungesa e konfliktit të interesit ndërmjet saj dhe shoqërisë së ndërtimit “****”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

27.18 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

27.18.1 Lidhur me çmimin e paguar për këtë pasuri, trupi gjykues çmon të vlerësojë paraprakisht parashikimet e palëve në kontratën e shitjes paraprake në raport me pagesat e kryera. Në këtë drejtim rezulton e provuar se kontrata datë 30.4.2012 nuk ka të përcaktuar pagesën e kësteve, numrin dhe afatin e shlyerjes së tyre, dhe po ashtu konstatohet se pagesa e bërë nga subjekti në datën 4.5.2012 me përshkrimin “Këst apartamenti” në shumën 10.000 euro është kryer 4 ditë pas nënshkrimit të kontratës paraprake, datë 30.4.2012. Rezulton se në deklaratën periodike të vitit 2012 subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në rubrikën “Ndryshimet e pasurive” dhe burimi i krijimit me përshkrimin “*Tërhequr shuma e depozituar në bankën Intesa Sanpaolo, kursyer nga të ardhurat deri në vitin 2011, me qëllim pagesë kësti fillestar apartamenti*”, - pra duke cilësuar në këtë mënyrë këtë pagesë si këstin e parë. Përgjatë procesit të hetimit për këtë subjekt, nuk rezultoi asnjë provë që të mbështesë citimin në këtë kontratë “Likuiduar si vlerë kapari nga pala blerëse në vlerën 10.000 euro jashtë zyrës noteriale”, pasi nuk u identifikua ndonjë pagesë tjetër për llogari të shoqërisë. Nga ana tjetër, aneks-kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.5.2015, në tabelën e mbajtur nga punonjësi i bankës, ku çmimi i apartamentit referohet 35.000 euro, nuk u konfirmua nga institucionet përkatëse. Po ashtu, nga analizimi i dokumentacionit bankar “Kontratë kredie bankare pranë NBG nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2015”, e cila i referohet kontratës paraprake datë 30.4.2012, rezultoi se banka në formularin mbi çmimin e shitjes së apartamentit ka referuar të dhëna sipas kontratës paraprake së shitjes datë 30.4.2012 në çmimin 30.000 euro, ku vlera e subjektit në pjesëmarrje është 10.000 euro, çka përjashtoi dyshimet e mundshme në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit, si dhe vlerën e paguar nga ana e subjektit përtej çmimit të përcaktuar në kontratën paraprake mes palëve.

27.18.2 Në këto kushte, trupi gjykues, duke përjashtuar dyshimet në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, kreu rillogaritjet²³ e pagesës së këstit të parë prej 10.000 euro në datën 4.5.2012, nga ku rezulton se subjekti nuk gjendet në pamundësi financiare për krijimin e saj.

27.18.3 Në lidhje me diferencën e çmimit, si një e dhënë e dalë nga referencat e tregut, trupi gjykues, duke vlerësuar të dhënat e pasqyruara në kontratat e ngjashme, si dhe kohën e afërt të

²² Duke referuar vendimin nr. 42, datë 18.11.2022, të Kolegjtit.

²³ Komisioni ka saktësuar të ardhurat e bashkëshortit të subjektit, të cilat deri në datën 4.5.2012 janë në vlerën 171.196 lekë.

dhënies së lejes për ndërtimin e objektit në janar të vitit 2012 me atë të nënshkrimit të kontratës paraprahe të shitjes nga subjekti, në prill 2012, krijon bindjen se çmimi i përcaktuar për këtë pasuri është vullnet i palëve kontraktuale e, për rrjedhojë, çmon se në çështjen objekt vlerësimi nuk evidentohen rrethana të tilla për të konkluduar në një trajtim preferencial, edhe për sa kohë ato nuk u shoqëruan me ndonjë situatë të konflikt të interesit.

27.18.4 Në vijim të arsyetimit për këtë çështje objekt vlerësimi, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se jemi përpara një kontrate paraprahe të palëve, e cila është finalizuar me kontratën e shitjes përfundimtare nr. ***, datë 7.8.2023, ku në nenin 2 të saj referohet kontrata paraprahe dhe specifikohet çmimi i paguar po në vlerën 30.000 euro.

27.19 Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në faktet e dala për këtë çështje dhe shpjegimet bindëse të subjektit, çmon se nuk identifikohen rrethana faktiko-ligjore, që mund të penalizojnë subjektin për efekt të këtij procesi.

28. Automjeti tip “Nissan Micra”, me targë ***, blerë sipas faturës tatimore të shitjes nr. ***, datë 6.1.2014, në vlerën 167.215 lekë. Regjistrimi në KSHA, në emër të znj. Flora Çela (bashkëlidhur dosja e automjetit, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 14.10.2016, të KSHA-së Vlorë). Burimi i blerjes së automjetit: Kontratë kredie bankare pranë Raiffeisen Bank (sipas kontratës bashkëlidhur edhe *specimenti* i lëshuar nga banka datë 20.1.2017). Vlera e kredisë: 371.000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës²⁴.

28.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Rezulton se kredia në Raiffeisen Bank në shumën 371.000 lekë është disbursuar në datën 11.3.2014, kurse automjeti është blerë në datën 16.1.2014.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

28.2 Nga hetimi i kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, me përshkrimin “Blerje automjeti “Nissan Micra” në datën 6.1.2014. Kryer pagesa sipas faturës tatimore të shitjes në vlerën 167.215 lekë. Kryer regjistrimi në KSHA në emër të Flora Çela, me targë ***, duke paguar detyrimin në vlerën rreth 20.000 lekë, dokumentacion regjistrimi”.

28.3 DPSHTRR-ja²⁵ informon se shtetasja Flora S. Çela ka në pronësi automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka depozituar dosjen e plotë të këtij automjeti, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka blerë me faturën tatimore nr. ***, datë 6.1.2014, nga shoqëria “****” sh.p.k. automjetin tip “Nissan Micra” në vlerën 167.215 lekë.

²⁴ Shkresë kërkim të dhënash nr.*** prot., datë 14.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Vlorë, për kopje të praktikës së regjistrimit të automjetit tip “Nissan Micra” me targë ***, regjistruar në emër të znj. Flora Çela; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga DPSHTRR-ja, Drejtoria Rajonale Vlorë, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilën janë bashkëlidhur fotokopjet e dokumentacionit të dosjes së mjetit me targë ***. Leja e qarkullimit rrugor të automjetit tip “Nissan Micra”, vit prodhimi 2003; certifikata e kontrollit fizik, datë 10.1.2014; fotografi të automjetit; faturë tatimore shitjeje nr. ***, datë 6.1.2014, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe blerës Flora Çela, të automjetit tip “Nissan Micra”, kundrejt vlerës totale 167.215 lekë. Dokumentacioni i pronësisë së automjetit në emër të shoqërisë “****” s.r.l. në Itali; fatura e blerjes së automjetit nga shoqëria “****” sh.p.k., pranë shoqërisë “****” s.r.l. në Itali kundrejt shumës 850 euro; praktika e zhdoganimit të automjetit. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

28.4 Nga korrespondenca e Komisionit me Raiffeisen Bank, kjo e fundit²⁶ konfirmon kredi në emër të znj. Flora Çela, disbursuar në datën 11.3.2014, në vlerën 371.000 lekë.

28.5 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti e ka deklaruar këtë kredi, duke sqaruar edhe destinacionin e saj. Më konkretisht, subjekti ka deklaruar se: *“Me vlerën e kredisë është dhënë për masterin e vëllait F.Ç vlera 1.300 euro, Universiteti P., Vlorë, pjesa tjetër është mbyllur overdraft-i personal 400 euro, si dhe shpenzime të vogla familjare”*.

28.6 Duke qenë se automjeti është blerë më 6.1.2014 dhe kredia është disbursuar më 11.3.2014, dukej se ajo nuk ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

28.7 Komisioni e ka pyetur²⁷ subjektin lidhur me burimin e krijimit të këtij automjeti, e cila në përgjigje ka deklaruar: *“Burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga paga ime dhe bashkëshortit, të deklaruara kursime në gjendjen cash nga të ardhurat e pagës, marrë në vitin 2012 në shumën 200.000 lekë dhe të ardhurat e pagës, marrë në vitin 2013 po në shumën 200.000 lekë... Pra, gjendja cash për dy vitet 2012 dhe 2013 ka qenë në shumën 400.000 lekë, çka ka krijuar edhe burimin e blerjes së mjetit”*.

28.7.1 Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se: *“Në deklaratën Vetting, datë 23.1.2017, pasaktësisht kam shkruar se burimi i krijimit të blerjes së mjetit “Nissan Micra”, me targë *** është kredia bankare datë 11.3.2014, në vlerën 371.000 lekë. Rezulton se mjeti është blerë sipas faturës tatimore të shitjes datë 6.1.2014 dhe kredia është marrë në datën 11.3.2014, pra dy muaj më vonë, çka e bën të pamundur faktin që kredia të ketë qenë burim i krijimit të kësaj pasurie, pasi unë kam pasur gjendje cash për blerjen e mjetit”*.

28.8 Duke qenë se subjekti deklaroi se burim krijimi i kësaj pasurie janë kursimet *cash*, Komisioni ka pasqyruar në tabelën e mëposhtme deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike dhe shumën e akumuluar vit pas viti për kursimet, deri në vitin 2014, kur është investuar në blerjen e automjetit.

Tabela nr. 1

Viti	Përshkrimi sipas subjektit në deklaratat periodike	Vlera e deklaruar	Shuma e akumuluar sipas Komisionit
2010	Kursime në vlerën 300.000 lekë nga të ardhurat nga paga mujore, shpërblimet e marra gjatë vitit 2010 (të padepozituara)	300,000	300,000
2011	Shtesë në llogarinë bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank në vlerën 3.300 euro	- 300,000	-
2012	Kursime në vlerën 200.000 lekë nga të ardhurat e marra nga paga, personale dhe bashkëshortit (<i>cash</i>)	200,000	200,000
2013	Kursime në vlerën 200.000 lekë nga të ardhurat e marra nga paga, personale dhe të bashkëshortit (<i>cash</i>)	200,000	400,000
2014	S'ka deklarim		400,000
2015	Ulje e të ardhurave të kursyera <i>cash</i> deri në vitin 2014, në vlerën 250.000 lekë, për nevoja familjare, pushime dhe punime në banesë në vitin 2015	- 250,000	150,000

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

²⁷ Pyetësor nr. 2, datë 5.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

	5.000 euro <i>cash</i> do t'i kalojnë firmës në momentin e marrjes së certifikatës së pronësisë	€ 5,000	€ 5,000
2016	Ulje të ardhurash në shumën 150.000 lekë për pushime, dalje jashtë shtetit	- 150,000	€ 5,000
	5.000 euro <i>cash</i> , të mbetura nga disbursimi i kredisë pranë NBG Bank, që do i kalojnë firmës në momentin e regjistrimit të pronës	€ 5,000	

28.9 Siç është pasqyruar edhe në tabelën e mësipërme, rezulton se shuma e akumuluar në vitin 2013 është në vlerën 400.000 lekë. Kjo shumë është më se e mjaftueshme për të blerë automjetin në datën 6.1.2014, në vlerën 167.215 lekë.

28.10 Meqenëse për vitin 2014 subjekti nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash*, Komisioni kreu analizën financiare të këtij viti, për të parë nëse subjekti kishte mundësi të investonte në blerjen e këtij automjeti, si dhe të mbante të pandryshuar gjendjen e kursimeve *cash*.

28.11 Nga përlllogaritjet financiare të kryera, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare të investojë në blerjen e automjetit, të mbajë të pandryshuar shumën e kursimeve, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

28.12 Pavarësisht këtij rezultati paraprak, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime, pasi konstatoi se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi në deklaratën *Vetting* ka deklaruar kredinë e marrë në Raiffeisen Bank në datën 11.3.2014, ndërsa gjatë hetimit deklaroi kursime *cash*.

28.13 Në qëndrimin e saj, subjekti, veç referimit të shpjegimeve të saj në pyetësonin nr. 5, ka parashtruar se në deklaratën e dorëzuar në datën 18.3.2013 tek përshkrimi “Ndryshimet dhe burimi i krijimit” është pasqyruar kursimi gjendje *cash* në shumën 200.000 lekë (për vitin 2012) dhe, po kështu, në deklaratën e dorëzuar në datën 20.3.2014, po në të njëjtën rubrikë është pasqyruar kursimi gjendje *cash* në shumën 200.000 lekë (për vitin 2013). Pra, ajo ka parashtruar “Gjendja *cash* për të dyja vitet, 2012 dhe 2013, ka qenë në shumën 400.000 lekë”, çka ka krijuar edhe burimin e blerjes së automjetit të mësipërm. Komisioni nga dokumentacioni i administruar konstatoi se subjekti në deklaramet e vitit 2016 pranë ILDKPKI-së ka sqaruar uljen e të ardhurave, dhe se në datën 31.12.2014 gjendja *cash* ka qenë rreth 250.000 lekë, si dhe në deklaramin periodik vjetor të dorëzuar në datën 21.3.2016, në rubrikën “Ndryshimet e pasurisë dhe burimi i krijimit”, ka sqaruar se nga të ardhurat e kursyera *cash* deri në vitin 2014 ka ulje në vlerën rreth 250.000 lekë (të cilat kishin mbetur pas shpenzimeve të kryera më sipër).

28.14 Subjekti ka shpjeguar se: “Në deklaratën *Vetting*, datë 23.1.2017, në rubrikën “Deklarami i pasurisë”, pasaktësisht kam shkruar se burimi i krijimit të blerjes së automjetit “Nissan Micra”, me targë ***, është kredia bankare datë 11.3.2014, në vlerën 371.000 lekë. Rezulton se mjeti është blerë sipas faturës tatimore të shitjes datë 6.1.2014 dhe kredia është marrë në datën 11.3.2014, pra dy muaj më vonë, çka e bën të pamundur faktin që kredia të ketë qenë burim i krijimit të kësaj pasurie, pasi konfirmon se ka pasur gjendje *cash* për blerjen e mjetit të përdorur, vit prodhimi 2002 – 2003”.

28.15 Në përfundim, subjekti ka pranuar konstatimin e Komisionit mbi këtë pasaktësi, por njëkohësisht ka shpjeguar se nuk është bërë qëllimisht²⁸.

28.16 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, çmon se pasaktësia e deklaratimit të burimit të krijimit mbetet evidente, por për sa kohë ajo nuk shoqërohet me mungesë financiare, nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit në këtë proces.

29. Automjet tip “Volkswagen Golf”, me targë ***, blerë nga shtetasi E.G, sipas deklaratës datë 25.10.2011 dhe datë 17.1.2012, noterizuar pranë noteres D.A, Vlorë, duke u regjistruar në KSHA me nr. *** rep., vlera 700 euro, dogana (vërtetim dogane) 32.121 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës²⁹.

29.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Në deklaratën e pasurisë Vetting nuk është deklaruar burimi financiar për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf” në vitin 2011.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

29.2 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 me përshkrimin “Blerje e një automjeti me dokumente të huaja 1.000 euro, i paregjistruar në DRSHTRR për vitin 2011”. Ndërsa në rubrikën e detyrimeve financiare subjekti ka deklaruar: *“Marrë një shumë 1.000 euro nga babai i bashkëshortit E.G për blerjen e automjetit dhe pajisjen me dokumente në muajin tetor 2011”*.

29.3 DPSHTRR-ja³⁰ informon se shtetasi E.G ka pasur në pronësi automjetin me targë ***. Kjo drejtori ka depozituar dosjen e plotë të këtij automjeti, nga ku rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë në datën 25.10.2011 nga shtetasja L.A automjetin tip “Volkswagen Golf” në vlerën 700 euro. Automjeti është zhdoganuar në datën 3.12.2011 dhe bashkëshorti i subjektit ka paguar 33.000 lekë për zhdoganimin e automjetit.

29.4 Nga verifikimi i dosjes rezultoi se ky mjet është shitur në datën 25.10.2017, me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., në vlerën 100.000 lekë.

29.5 Komisioni e ka pyetur³¹ subjektin lidhur me burimin e krijimit të shumës 1.000 euro, dhënë nga babai i bashkëshortit. Në përgjigje, subjekti ka sqaruar se babai i bashkëshortit ka përfutur të ardhura nga statusi i ushtarakut dhe për këtë ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 8.6.2023, të lëshuar nga ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Tiranë, i cili vërteton se shtetasi E.G ka përfutur të ardhura nga sigurimet shoqërore nga 1.1.1999 – 30.10.2013, në vlerën 2.312.424 lekë. Subjekti i

²⁸ Subjekti ka referuar vendimet e Kolegjit, përkatësisht nr. 10/2022; nr. 37/2021; nr. 20, datë 31.7.2019; nr. 01, datë 12.1.2021.

²⁹ Shkresë kërkim të dhënash nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Vlorë, për kopje të praktikës së regjistrimit të automjetit tip “Golf”, në pronësi të shtetasit E.G; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.10.2016, nga DPSHTRR-ja, Drejtoria Rajonale Vlorë, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilën janë bashkëlidhur fotokopjet e dokumentacionit të dosjes së mjetit me targë ***; kartela e automjetit tip “Volkswagen Golf”, datë 17.1.2012, në emër të shtetasit E.G; certifikata e kontrollit fizik, datë 17.1.2012. Fotografi të automjetit. Dokumentacioni ligjor i automjetit në emër të shtetasit L.A, ndodhur në Itali; dokumenti i mjetit të përdorur me targë, nënshkruar nga shtetasja L.A, datë 25.10.2011, e cila deklaroi se i ka shitur automjetin tip “Volkswagen Golf”, viti 1998, kundrejt vlerës 700 euro (dokument i përkthyer nga gjuha italiane) (Aneks nr. *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.3.2021.

³¹ Me pyetësin nr. 2, datë 5.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

rivlerësimit ka depozituar mandatarkëtimet në BKT, për të provuar kursimet e babait të bashkëshortit, të investuara në depozitë, në vitet 1997 – 2002. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar dhe dokumentuar investimin në një pasuri të paluajtshme, në vlerën 16.500 USD, në vitin 2002, në qytetin e Tiranës. Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se likuidimi i kësaj pasurie ka përfunduar në vitin 2003.

29.6 Në përlllogaritjet e kryera për të parë mundësinë financiare të babait të bashkëshortit për t'i dhënë djalit të tij shumën 1.000 euro, Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizë të ardhurat e përfituara pas vitit 2003, pra pas përfundimit të likuidimit të apartamentit në qytetin e Tiranës dhe deri në tetor 2011, kur është blerë automjeti.

29.7 Nga analiza, rezulton se me të ardhurat dhe shpenzimet për një person babai i bashkëshortit të subjektit ka pasur mundësi të japë shumën 1.000 euro (ose 138.300 lekë, e konvertuar me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2011).

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	2004 – tetor 2011
1	Të ardhura	1,362,614
2	Shpenzime jetese	973,308
3	Mundësia për kursim	389,306

29.8 Lidhur me vlerën e këtij automjeti, si dhe burimin e krijimit të tij, duket se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore. Komisioni ka analizuar secilin deklaram të subjektit, konkretisht:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 ka deklaruar se automjeti ka kushtuar 1.000 euro, me burim marrjen e një shume 1.000 euro nga babai i bashkëshortit për blerjen e automjetit dhe pajisjen me dokumente.
- Në deklaratën *Vetting*, më 24.1.2017, subjekti deklaroi vlerën e automjetit 700 euro, si dhe shpenzime zhdoganimi 32.121 lekë, pa deklaruar burimin e krijimit.
- Në pyetësin standard datë 2.2.2021, subjekti deklaroi se vlera totale e automjetit ka shkuar rreth 200.000 lekë dhe se është përdorur për blerjen e tij një pjesë e kredisë datë 8.6.2011 në Raiffeisen Bank.

29.9 Në analizën financiare të kryer për vitin 2011, Komisioni ka përfshirë vlerën 200.000 lekë sipas deklaramit të subjektit në pyetësin standard, ku pas përlllogaritjeve ajo ka rezultuar pozitive.

29.10 Lidhur me këto konstatime³², Komisioni i kërkoi subjektit të sqaronte dhe jepte shpjegime bindëse, pasi dukej se përmes deklaramit ka ndryshuar vlerën e automjetit nga 1.000 euro në 200.000 lekë, si dhe ka ndryshuar burimin e krijimit, duke shtuar edhe një pjesë të kredisë, në raport me deklaramin periodik se si burim kishte shërbyer dhurimi i vlerës 1.000 euro nga babai i bashkëshortit dhe, për pasojë, dukej se subjekti kishte kryer deklarim të pasaktë për këtë pasuri.

29.11 Në qëndrimin e saj, subjekti ka shpjeguar se në formularin nr. 1 ka sqaruar: “*Shtetasi E.G, babai i bashkëshortit E.G, na ka ndihmuar financiarisht me një shumë rreth 1.000 euro (një mijë)*”

³² Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

në vitin 2011, sipas deklarimeve periodike, e cila është dhuruar. Konkretisht: është gjetur dhe është porositur nga jashtë, në vitin 2011, një automjet tip "Golf", ngjyrë e zezë, i përdorur, me targa të huaja, ***, në pronësi të shtetas L.A, në Itali, kundrejt vlerës 700 (shtatëqind) euro. Duke qenë se sipas ligjit të kohës lejoheshin mjetet me dokumente të huaja, nga data e blerjes së mjetit, 25.10.2011, dokumentet e tij janë bërë në datën 17.1.2012, shpenzime të cilat na janë hequr nga babai i bashkëshortit. Mjeti është targuar me targë *** në pronësi të E.G, në momentin që ka ardhur çregjistrimi i mjetit nga jashtë. Është përdorur për blerjen e mjetit një pjesë kredie, datë 8.6.2011, pranë Raiffeisen Bank, Flora Çela dhe E.G, afati 60 muaj. Mbyllur në datën 5.9.2014. Vlera totale e mjetit ka shkuar rreth 200.000 (dyqind mijë) lekë". Në deklaratën periodike vjetore, dorëzuar në datën 15.3.2012, rubrika "Detyrime financiare", fq. nr. 5 e deklaratës kam deklaruar: "Marrë një shumë 1000 euro nga babai i bashkëshortit për blerjen dhe pajisjen me dokumente në muajin tetor 2011". Në deklaratën Vetting, më 24.1.2017, ka deklaruar vlerën e mjetit 700 euro, si dhe shpenzime zhdoganimi 32.121 lekë.

29.12 Subjekti ka vijuar të deklarojë se: "Duke qenë se është bashkëshorti personi që ka dalë në cilësinë e porositësit e më pas blerësit të kësaj pasurie, ajo nuk ka qenë shumë e saktë në deklarimin e vlerës së kësaj pasurie. Fakt është që sipas kontratës mjeti është me vlerë 700 euro ose, sipas kursit të këmbimit të euros në vitin 2011, vlera e tij është 700 x 138.9, që shkon 97.230 lekë. Pra, kaq lekë janë shpenzuar për blerjen e tij në vitin 2011. Për blerjen e tij është përdorur një pjesë kredie e datës 8.6.2011 pranë Raiffeisen Bank, Flora Çela dhe E.G, afat 60 muaj. Më tej është ofruar babai i bashkëshortit për t'i bërë dokumentacionin, duke na dhënë një shumë prej 1.000 euro nga të ardhurat e tij. Tek vlera rreth 200.000 lekë përfshihet vlera e makinës 97.230 lekë, dogana 32.121 lekë, pjesa tjetër është regjistrimi i mjetit dhe siguracion, kontrollet bazë të mjetit (benzinë-gaz), kontrata te noteri 3000 lekë, shërbime fillestare të mjetit, që të gjitha shkojnë në vlerën 200.000 lekë.

Arsyeja e mosdeklarimit tim të saktë ka qenë, për shkak se nuk i kemi mbajtur faturat e pagesës për çregjistrimin e mjetit, shërbimet e kryera dhe taksat. Shuma e saktë që kam ditur, është vlera 700 euro dhe është pjesë e kredisë, si dhe shuma 1.000 euro, që na ka dhëna babai i bashkëshortit. Në këto kushte, pasaktësia (nëse do ta pranojmë si të tillë) është e karakterit formal".

29.13 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime dhe në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të rezultuara gjatë hetimit administrativ, çmon se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë. Kjo pasaktësi në deklarin, e pashoqëruar me ndonjë rrethanë që do të krijonte dyshime lidhur me ligjshmërinë e burimeve të cilat përfaqësonin kredinë e përfituar në vitin 2011, dhurimin e shumës 1.000 euro nga vjehri i saj, të deklaruara në kohë reale nga subjekti, por dhe në kushtet që analiza financiare nuk rezulton në balancë negative, çmohet nga trupi gjykues se nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut për penalizimin e subjektit në këtë proces.

Detyrime financiare

30. Kredi sipas kontratës datë 8.3.2007, pranë Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit E.G, e marrë para martesës dhe shlyer ky detyrim. Kredi sipas kontratës datë 25.6.2007, pranë Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit E.G, e marrë para martesës, sipas kontratës bashkëlidhur.

- Kredi sipas kontratës 15.1.2008, pranë Raiffeisen Bank, nga shtetasi E.G, e marrë para martesës, për mbylljen e kredisë datë 25.6.2007, pranë Raiffeisen Bank. Kredi sipas kontratës datë 8.6.2011, pranë Raiffeisen Bank, marrë nga shtetasit E.G dhe Flora Çela, për blerje automjeti tip “Volkswagen Golf” në emër të bashkëshortit.

- Kredi sipas kontratës datë 5.9.2014, nga shtetasi E.G, pranë BKT-së, për blerje kredie pranë Raiffeisen Bank, të marrë më parë, ku sipas vërtetimit të bankës nr. *** prot., datë 18.10.2016, nuk ka më asnjë detyrim ndaj bankës (pra, shlyer të gjitha detyrimet e marra me kontratat e mëparshme). Shlyer detyrimet e kontratave të kredisë më 8.3.2007, 25.6.2007, 15.1.2008, 8.6.2011, me kontratën datë 5.9.2014, marrë pranë BKT-së, sipas vërtetimit të BKT-së, datë 20.1.2017, nr. *** prot. (nuk ka asnjë detyrim nga këto kontrata kredie). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës³³.

30.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

30.2 Nga korrespondenca e Komisionit me bankat³⁴ e nivelit të dytë, konfirmohen kreditë e marra dhe të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Rezultoi se në momentin e depozitimit të deklaratës *Vetting* ato kanë qenë të mbyllura. Nga analizimi i kontratave të kredisë, të depozituara nga bankat e nivelit të dytë, konkretisht nga Raiffeisen Bank dhe BKT-ja, rezultoi se kreditë kanë qenë kryesisht konsumatore dhe janë përdorur për të mbyllur njëra-tjetrën ose për shpenzime të ndryshme familjare.

30.3 Komisioni i ka përfshirë kreditë e marra si të ardhura në analizën financiare, si dhe shpenzimet e kryera për likuidimin e tyre në çdo vit apo aty ku janë shpenzuar.

30.4 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, pasi nga analiza financiare konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi në shumën 79.113 lekë të shlyente kreditë në vitin 2009, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

30.5 Lidhur me këtë pamundësi financiare, subjekti ka pretenduar se ajo ka ndodhur për shkak se në analizën e Komisionit nuk rezulton të jetë marrë në konsideratë, kompensimi i qirasë që bashkëshorti i saj ka marrë në vitin 2009, në zbatim të urdhrin të Ministrit të Mbrojtjes nr. *** datë 13.2.2008 “Për kompensimin në qira banese”, urdhrin të Komandantit të Repartit ushtarak nr. *** datë 19.11.2009, sipas shkresës nr. *** prot., datë 19.11.2009 dhe kërkesës nga ana e bashkëshortit nr. *** prot., datë 23.10.2009. Subjekti ka shpjeguar se fondet janë kaluar në datën 26.11.2009. Subjekti ka depozituar urdhrin për kompensimin e qirasë, kërkesën dhe *statement*-in bankar të vitit 2009.

³³ Kontratë kredie bankare, e lidhur në datën 8.3.2007 ndërmjet kredimarrësit E.G dhe Raiffeisen Bank, për shumën 200.000 lekë. Kontratë kredie bankare, e lidhur në datën 25.6.2007 ndërmjet kredimarrësit E.G dhe Raiffeisen Bank, për shumën 360.000 lekë. Kontratë kredie bankare, e lidhur në datën 15.1.2008 ndërmjet kredimarrësit E.G dhe Raiffeisen Bank, për shumën 394.478,68 lekë. Kontratë kredie bankare, e lidhur në datën 8.6.2011 ndërmjet kredimarrësit E.G, bashkëkredimarrëses Flora Çela dhe Raiffeisen Bank, për shumën 420.000 lekë. Kontratë kredie bankare, e lidhur në datën 5.9.2014, ndërmjet kredimarrësit E.G dhe Bankës Kombëtare Tregtare, për shumën 250.000 lekë. Vërtetim nr. *** prot., datë 20.1.2017, nga Banka Kombëtare Tregtare për shtetasin E.G, i cili në datën 31.8.2016 ka shlyer përfundimisht detyrimet për sa i përket kredisë së përfutur në datën 5.9.2014, në shumën 250.000 lekë. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, nga Raiffeisen Bank dhe shkresë nr. *** prot., datë 26.3.2021, nga BKT-ja.

30.6 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar gjatë hetimit, si dhe në prapësime, në analizë të të gjitha fakteve dhe rrethanave, por kryesisht referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, vlerësoi të përfshijë bonusin e qirasë, duke iu referuar konkretisht urdhrin nr. ***, datë 19.11.2009 “Për pagesën e kompensimit të qirasë së banesës”, lëshuar nga Komanda e Forcave Detare, reparti ushtarak ***, i cili urdhëron që togerit E.G t’i bëhet kompensimi i qirasë së banesës nga data 1.1.2009 deri në datën 31.12.2009, kompensim në nivelin 70% të 12.000 lekë të garsonierës në qendër të qytetit të Vlorës, ku pas verifikimit të llogarisë së bashkëshortit të subjektit në Raiffeisen Bank konstatohet se atij i është kredituar në datën 26.11.2009 shuma 100.800 lekë, e cila korrespondon me vlerën e përcaktuar në urdhër, 70% e shumës 12.000 lekë (70% x 12.000 lekë x 12 muaj). Nën këtë arsytim dhe vlerësim, trupi gjykues konstatoi se analiza financiare rezulton pozitive dhe, për pasojë, konkludon se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të shlyente kreditë në vitin 2009, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

31. Kredi sipas kontratës datë 11.3.2014, pranë Raiffeisen Bank, në emër të znj. Flora Çela, përdorur për blerje automjeti tip “Nissan Micra” dhe shlyerje detyrimesh sipas faturave bashkëlidhur. Detyrimi i kontratës së datës 11.3.2014 pranë Raiffeisen Bank, sipas vërtetimit datë 20.1.2017, është në vlerën 36.687,28 lekë, detyrim i cili mbyllet në datën 11.3.2017. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës³⁵.

31.1 ILDKPKI në raportin e tij është shprehur: *Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, deklarimi referuar dokumentacionit të paraqitur i përket datës 31.12.2016, ndërsa konfirmimi i bankës i përket datës 24.1.2017.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

31.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 me përshkrimin “Lidhur kontratë kredie me bankën Raiffeisen Bank, për marrjen e një shume kredie konsumatore në vlerën 371.000 lekë sipas kontratës datë 11.3.2014, në emër të Flora Çela, duke paguar këstet mujore sipas kontratës përkatëse”.

31.3 Po në këtë deklaratë, përkatësisht në rubrikën e shpenzimeve të deklarueshme, subjekti ka deklaruar: *“Me vlerën e kredisë është dhënë për masterin e vëllait F.Ç vlera 1.300 euro, Universiteti P., Vlorë, pjesa tjetër është mbyllur overdraft-i 400 euro, personal, si dhe shpenzime të vogla familjare”.*

31.4 Nga korrespondenca e Komisionit me Raiffeisen Bank³⁶, kjo e fundit konfirmon kredinë e marrë në datën 11.3.2014, në shumën 371.000 lekë. Rezulton se subjekti i rivlerësimit pas disbursimit të kredisë, datë 11.3.2014, ka tërhequr në datën 17.3.2014 shumën 256.000 lekë.

³⁵ Kontratë kredie bankare, e lidhur në datën 11.3.2014 ndërmjet kredimarrëses Flora Çela dhe Raiffeisen Bank, për shumën 371.000 lekë. Tabela e amortizimit të kredisë. Vërtetim datë 20.1.2017, nga Raiffeisen Bank, mbi produktet bankare të klientit Flora Çela, ku evidentohet kredia e disbursuar në datën 11.3.2014, vlerë 371.0000 lekë, si dhe balanca në fund të vitit 2016, në shumën 36.687,36 lekë. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 16.3.2021, nga Raiffeisen Bank, administruar në dosjen e Komisionit.

31.5 Subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjatë hetimit³⁷ formularin për mbylljen e *overdraft*-it datë 11.3.2014, si dhe mandatarkëtimet për pagesat e kryera për masterin e vëllait F.Ç pranë Universitetit P., Vlorë, të cilat datojnë në 20.4.2014, 22.9.2014 dhe 14.10.2014. Në total, shuma e paguar rezulton në vlerën 1.250 euro.

31.6 Detyrimi i mbetur deri në datën 24.1.2017, kohë kur është depozituar deklarata *Vetting*, është në shumën 24.582,96 lekë. Ndryshimi midis detyrimit të mbetur të deklaruar nga subjekti dhe asaj të konfirmuar nga banka vjen si rezultat i paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe, konkretisht, subjekti i referohet detyrimit të mbetur deri në datën 31.12.2016, ndërsa konfirmimi i bankës i përket datës 24.1.2017.

31.7 Deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* se kredia është përdorur për blerje automjeti tip “Nissan Micra” dhe shlyerje detyrimesh duket se është pjesërisht i pasaktë. Kjo, për faktin se mjeti “Nissan Micra” është blerë në datën 6.1.2014 dhe kredia e datës 11.3.2014 nuk mund të ketë shërbyer për këtë investim.

32. Kontratë kredie bankare përfituar pranë NBG Bank, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2015, në vlerën 25.000 euro (sipas kontratës bashkëlidhur dhe vërtetimit datë 20.1.2017, *specimenti* përkatës për detyrimet e mbetura dhe shumën e paguar). Detyrim pranë NBG Bank në vlerën 21.141,60 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin nga NBG Bank, datë 20.1.2017, për kredinë e akorduar në datën 17.6.2015 shtetasve Flora Çela dhe E.G në shumën 25.000 euro, nga e cila është disbursuar shuma 22.500 euro. Balanca e kredisë në datën 20.1.2017 është në shumën 21.141 euro.

32.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga NBG Bank.*

32.2 Komisioni e ka trajtuar më sipër këtë kredi, e cila është deklaruar se ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament, ndaj vlerëson të mos bjerë në përsëritje në arsyetim.

32.3 Sa i përket detyrimit të mbetur, nga korrespondenca e mbajtur mes Komisionit dhe ABI Bank, kjo e fundit³⁸ ka depozituar planin e amortizimit, nga ku vërehet se përputhet vlera e deklaruar nga subjekti me përgjigjen e ardhur nga banka.

33. Kredi datë 30.8.2016, përfituar pranë Iutecredit, në vlerën 73.000 lekë, marrë nga shtetasi E.G, për arsye familjare të nënës së tij F.G, shpenzime mirëmbajtje banese. Detyrim pranë Iutecredit, sipas kontratës 30.8.2016, i cili mbyllet në datën 4.4.2017 (shihni kontratën bashkëlidhur). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratë specifike huaje³⁹ personale ***, lidhur në datën 30.8.2016, ndërmjet I.A sh.a. dhe shtetasit E.G, për shumën e huas 73.000 lekë, me afat shlyerjeje 8 muaj. Sipas grafikut të pagesave mujore, balanca e detyrimit në datën 4.1.2017 është në shumën 37.893,42 lekë.

33.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

³⁷ Me pyetësin nr. 2, datë 5.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

33.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 me përshkrimin “Kredi datë 30.8.2016, pranë Iutecredit, në vlerën 73.000 lekë, marrë nga E.G, për arsye familjare të nënës së tij F.G, shpenzime mirëmbajtje banese”.

33.3 Subjekti ka depozituar kontratën me I.A për kredinë e marrë në vlerën 73.000 lekë, datë 30.8.2016, me afat 8 muaj. Detyrimi i mbetur deri më 24.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*, rezulton në vlerën 37.893,42 lekë.

33.4 Komisioni i ka përfshirë në analizën financiare pagesat e kryera për likuidimin e kësaj kredie dhe nuk i kanë rezultuar problematika.

34. *Overdraft* pranë Raiffeisen Bank, në shumën 270.000 lekë. Detyrimi financiar 270.000 lekë.

34.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga Raiffeisen Bank.*

34.2 Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021, informon se znj. Flora Çela ka llogari page pranë kësaj banke. Gjendja e llogarisë së pagës në datën 24.1.2017 është në balancë negative, në vlerën -269.388,82 lekë. Komisioni nuk vërejtë problematika lidhur me këtë detyrim financiar.

Deklarimi i bashkëshortit të subjektit – E.G

35. Apartament në Tiranë, me sip. 64 m², i blerë në vitin 2000, deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting*, në zotërim të prindërve të tij E.G dhe F.G, me adresë “Kulla nr. ***”, hyrja e parë, apartamenti nr. ***, “****”, rruga “****”, e paregjistruar në ZVRPP. Ai ka deklaruar se babai i tij ka ndërruar jetë më 30.10.2013 për shkak të sëmundjes së kancerit në mushkëri dhe se nuk është bërë akti i trashëgimisë. Apartamenti zotërohet nga nëna e tij F.G dhe midis prindërve të tij dhe subjektit “****”, me administratorin E.S, është lidhur kontrata datë 7.1.2002 pranë noteres E.K, Tiranë, me adresë Rruga e ***, sipas faturave bashkëlidhur kontratës së noterizuar, datë 21.1.2017. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin mbështetës⁴⁰.

35.1 ILDKPKI-ja në raportin e tij është shprehur: *Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.*

Hetimi i kryer nga Komisioni

35.2 Nga dokumentacioni i administruar, konstatohet se ZQRPP-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2018⁴¹, ka bashkëlidhur përgjigjen negative të ZVRPP-së Tiranë, e cila nuk konfirmon pasuri të paluajtshme në emër të shtetasve E.G dhe Flora Çela.

⁴⁰ Vërtetim nr. *** rep., datë 21.1.2017, i fotokopjes së dokumentacionit me origjinalin; Kontratë sipërmarrjeje, nënshkruar në vitin 2002 ndërmjet palës sipërmarrëse “****” sh.p.k. dhe palës porositëse E.G, të një apartamenti me sip. të përgjithshme 65 m². Mandatpagesë e shumës 14.000 USD, datë 5.1.2002; 2.500 USD, datë 8.11.2003; 500 USD, datë 20.11.2003, nga shtetasi E.G, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për apartamentin ***, kati ***, sip. 65 m². Mandatpagesë e shumës 17.624 lekë (elektrik + ujë) në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

35.3 Subjekti ka deklaruar⁴² se bashkëshorti i saj është bashkëpronar në apartamentin e trashëguar pas vdekjes së babait të tij, me adresë Kulla ***, nr. ***, ap. ***, kati ***, rruga “****”, Tiranë. Për këtë deklaramin subjekti ka depozituar: (i) certifikatë pronësie datë 17.5.2018 në emër të bashkëshortit të saj dhe vjehrrës; (ii) vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.8.2017.

35.4 Gjatë hetimit, subjekti ka depozituar⁴³ edhe mandatet e likuidimit të kësaj pasurie në vlerën 16.500 dollarë, që datojnë në vitet 2002 dhe 2003.

35.5 Për sa kohë që kjo është një pasuri e blerë nga familja e bashkëshortit, që daton përpara njohjes së subjektit të rivlerësimit me bashkëshortin e saj, përpara fillimit të detyrës, pasi subjekti është emëruar në vitin 2007, ndërkohë që pasuria është blerë në vitin 2002, bashkëshorti i subjektit është bërë bashkëpronar për shkak të trashëgimisë, Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë për ekzistencën dhe burimin e krijimit të saj.

GJETJE TË TJERA

36. Nga verifikimi i të gjithë korrespondencës me DPPShtetit për sistemin TIMS, AMF-në dhe RNSH-në, Komisionit nuk i rezultuan të dhëna dhe informacione të tjera, përveç atyre të konfirmuara dhe të deklaruara nga subjekti gjatë hetimit.

37. Në rubrikën e të ardhurave, subjekti i rivlerësimit, përveç të ardhurave të siguruara nga punësimi, ka deklaruar: *“Nuk disponoj depozitë bankare apo gjendje cash nga të ardhurat, për shkak edhe të shpenzimeve në banesë. Disponoj një shumë prej 5.000 euro cash, mbetur pa paguar nga kredia pranë NBG Bank, si detyrim ndaj shoqërisë “****”, që do të kalojë në llogari të saj me marrëveshje me regjistrimin e pronës në ZRPP, apartament”*.

37.1 Komisioni e ka trajtuar këtë çështje më sipër në këtë vendimmarrje, pikërisht në hetimin e kryer për pasurinë apartament, dhe nuk ka konstatuar ndonjë problematikë.

Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë

38. Në përfundim, lidhur me hetimin e kryer për kontrollin e kriterit të pasurisë, bazuar në konkluzionet më lart, për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, trupi gjykues në vlerësimin tërësor arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka arritur nivel të besueshëm për këtë kriter, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

39. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramive dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi

⁴² Në pyetësorin standard datë 2.2.2021, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴³ Pyetësor nr. 2, datë 5.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

kontrollin e figurës, nr. *** prot., datë 30.10.2017, me konstatimin për përshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës.

Hetimi i kryer nga Komisioni

39.1 Më tej, pas kërkesës së Komisionit⁴⁴ për përditësimin e informacioneve, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 13.7.2023, deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së nr.***, datë 14.7.2023. Informacionet në raportin e përditësuar bëjnë me dije se:

a. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora S. Çela, disponohet një indikacion ...ku supozohet përfshirja e saj në veprimtari të kundërligjshme... dhe në vijim shprehen:

b. Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit, rezulton se:...

c. Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Flora S. Çela, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin tuaj nën dritën e informacioneve të tjera, që mund të dispononi si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ, që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

39.2 Lidhur me këtë informacion, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, dhe njëkohësisht edhe Prokurorisë së kësaj gjykate, informacion dhe dokumentacion mbi ekzistencën e procedimit/eve penal/e ndaj shtetasit M.B, veprën penale për të cilën ai është hetuar, kërkimin e organit të akuzës përpara gjykatës, si dhe përcjelljen e vendimit/eve gjyqësor/e të mundshme për këtë shtetas (gjithnjë nëse ka pasur të tilla).

39.3 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë⁴⁵ ka përcjellë vendimin gjyqësor të saj të formës së prerë, nr. ***, datë 16.7.2019.

39.4 Nga verifikimi i vendimit gjyqësor rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 23.11.2017, regjistruar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal⁴⁶, për të hetuarin M.B, i datëlindjes 6.10.1973, lindur në Turqi e banues në Vlorë.

39.5 Sipas vendimit gjyqësor, çështja është hetuar për më shumë se 18 muaj dhe, në përfundim, nga përfaqësuesi i organit të akuzës është kërkuar pushimi i saj sipas nenit 388/1, shkronja “a” e Kodit Penal, pasi fakti nuk provohet se ekziston.

39.6 Për të konstatuar mbi lidhjen apo marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas dhe, për rrjedhojë, edhe për dyshimin mbi ndikimin e saj në hetimin e çështjes penale, subjekti është pyetur dhe në përgjigje⁴⁷ ka sqaruar se nuk ka asnjë lloj marrëdhënieje me këtë shtetas, përveç faktit që njihet si biznesmen me orgjinë turke, në ushtrimin e profesionit dentar në qytetin e Vlorës.

⁴⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁵ Me shkresën datë 27.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Referuar parashikimit ligjor, neni 3/15⁴⁶ të ligjit nr. 84/2016, vepra penale për të cilën është regjistruar procedimi penal në ngarkim të këtij shtetasi përfshihet në veprat penale të parashikuara nga ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 (më konkretisht shkronja “d” e neni 3/1 të këtij ligji).

⁴⁷ Përcjellë me email-in datë 27.9.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

39.7 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me konkluzionet e AKSIK-së.

39.8 Subjekti në qëndrimin e saj ka parashtruar se në karrierën e saj prej 16 vjetësh si prokurore, është përpjekur të jetë e kujdesshme në çdo drejtim, dhe madje edhe në kontaktet, miqësitë, si në punë apo jashtë punës. Subjekti ka parashtruar analizën ligjore në lidhje me kontaktet e papërshtatshme referuar nenit 3/15 të ligjit nr. 84/2016, ku sipas shpjegimit të saj ligji kërkon që personi të jetë i dënuar penalisht apo i proceduar penalisht, për t'u konsideruar si kontakt i papërshtatshëm. Ajo ka sqaruar se sipas të dhënave të marra nga zyra e regjistrimit të regjistrimit të veprave penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ky shtetas nuk ka qenë asnjëherë i arrestuar nën efektin e ndonjë mase sigurimi, ose të jetë marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit në hetim.

39.9 Sipas subjektit, nga aktet në dosje nuk rezultojnë që ky shtetas të ketë emër të regjistruar sipas neneve 287 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale procedimin penal nr. ***. Kjo çështje është dërguar me kërkesë për pushim nga një subjekt tjetër rivlerësimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin se fakti nuk provohet se ekziston sipas nenit 328/1, shkronja “a” e Kodit të Procedurës Penale, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë 16.7.2019, ka vendosur pranimin e kësaj kërkesë dhe pushimin e procedimit penal, vendim i cili ka marrë formë të prerë. Subjekti ka parashtruar se hetimi i këtyre veprave penale bëhet në fshehtësi dhe se ajo nuk mund të ketë dijeni për ekzistencën e regjistrimit të këtij procedimi. Nga aktet e dosjes rezultojnë se materiali ka kaluar nga drejtuesi i prokurorisë A.Y për prokurorin A.K, sipas siglimit të tij datë 23.11.2017, dhe për këtë ka depozituar edhe vendimin përkatës.

39.10 Trupi gjykues, në analizë të konkluzionit të AKSIK-së, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar e verifikuar, konstatoi se në çështjen penale objekt hetimi nuk identifikohet roli i subjektit si prokuror i çështjes. Po ashtu, nuk u konstatua qoftë edhe në mënyrë indirekte ndonjë e dhënë, që të provonte ndonjë ndikim të mundshëm të subjektit tek prokurori i çështjes me qëllim favorizimin e të dyshuarit. Gjithashtu, nuk u konstatua ndonjë e dhënë që mund të prezantonte *indicie*, fakte apo rrethana, që provonin marrëdhënie/kontakte të subjektit të rivlerësimit me shtetasin M.B, përpara vitit 2017 apo edhe më pas, për të konkluduar në vlerësimin tërësor të subjektit.

39.11 Në përfundim, në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues, për sa kohë nga hetimi nuk evidentoi ndonjë fakt apo provë që mund të passillte cenimin e figurës së subjektit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

40. Raporti i vlerësimit të aftësisë profesionale është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Raporti është mbështetur në: (i) formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (ii) të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë

subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, pas të cilit është konkluduar në: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

40.1 Raporti i vlerësimit të aftësisë profesionale, në analizë të gjetjeve⁴⁸, si dhe bazuar në të gjitha burimet e informacioneve për subjektin e rivlerësimit, nuk ka evidentuar problematika në aspektin e aftësive profesionale, organizative, etikën dhe integritetin e saj.

Në lidhje me të dhënat nga burimet arkivore

41. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela, rezultojnë se:

41.1 Nga të dhënat që ndodhen në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk rezultojnë të jetë marrë ndonjë masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Flora Çela.

41.2 Në lidhje me pasjen e materialeve hetimore, është konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka materiale hetimore⁴⁹ dhe po ashtu është qartësuar se si janë ndjekur ato.

41.3 Në lidhje me çështje penale apo kallëzime penale të filluara ndaj subjektit të rivlerësimit, Drejtoria e Koordinimit Institucional, si dhe sektori i Protokoll - Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2019, bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme rezultojnë se nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit.

⁴⁸ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

⁴⁹ Me shkresën nr. ***, datë 11.10.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka konfirmuar se: (i) Është regjistruar kallëzimi penal nr. *** mbi bazën e kallëzimit të shtetasit N.J.J, ardhur me shkresën nr. ***, datë 9.3.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Kjo e fundit e ka dërguar materialin për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka verifikuar aktet, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 28.3.2018; (ii) Është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, ardhur me shkresën nr. ***, datë 29.12.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, mbi bazën e kallëzimeve të shtetasit F.M. Kallëzuesi ka bërë kallëzim penal kundër disa prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit Flora Çela. Ai ka kërkuar fillimin e procedimit për kryerje të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka verifikuar aktet, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 31.1.2016; (iii) Është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2014, të Prokurorisë së Përgjithshme, mbi bazën e kallëzimeve të shtetasit M (M) H. Ai ka kërkuar fillimin e procedimit për kryerje të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka verifikuar aktet, ka vendosur pushimin e procedimit penal në datën 20.2.2015; (iv) Është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 18.9.2017, i cili i ka kaluar për kompetencë në datën 30.7.2018 Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me shkresën nr. ***, datë 9.10.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka informuar se është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2018, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim është procedimi penal nr. ***, datë 18.9.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili ka ardhur për kompetencë. Ky procedim ka filluar në bazë të kallëzimit të shtetasve I.B dhe M.B kundër disa prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit Flora Çela, sepse këta prokurorë nuk kanë kryer detyrën. Nga aktet rezultojnë se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i është drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit. Me vendimin nr. ***, datë 2.7.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka rrëzuar kërkesën. Më pas, çështja është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Thuhet se ky procedim penal është ende në fazë hetimi.

41.4 Po ashtu, kjo drejtori ka konfirmuar se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave⁵⁰, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2020, rezultojnë disa ankesa, për të cilat ky institucion nuk ka konstatuar problematika.

41.5 Në lidhje me vlerësimet e punës për subjektin e rivlerësimit, raporti ka konfirmuar se pranë Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka të dhëna për vlerësimin e punës së kësaj prokuroreje, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, si dhe urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012 “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”. Konkretisht janë administruar: (i) vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2014, për prokuroren Flora Çela, në nivel “shumë mirë”; (ii) vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2015, për prokuroren Flora Çela, në nivel “shumë mirë”; (iii) vendim i Prokurorit të Përgjithshëm “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2016, për prokuroren Flora Çela, në nivel “shumë mirë”;

Analiza e gjetjeve

42. Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; të dhënave nga burimet arkivore në Drejtorinë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

42.1 Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Flora Çela, tregon korrektësi në zbatimin të ligjit. Në tri aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit. Konstatohet se ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur në respektim të dispozitave procedurale penale dhe urdhrin nr. ***, datë 5.9.2003 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore” (dosjet 4 dhe 5). Aktet e përpiluara prej saj janë administruar në sekretarinë e Prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrin. Rezulton se qëndrimet e prokurores janë mbështetur nga drejtuesi i Prokurorisë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej saj janë të kuptueshme. Nga pikëpamja gjuhësore, ka respektuar rregullat e drejtshkrimit, në funksion

⁵⁰ Nr. 36, e vitit 2010, e shtetas L.K; nr. *** e vitit 2010, e shtetasit R.T; nr.***, e vitit 2011, e shtetasit A.N - kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe është arkivuar; nr. ***, e vitit 2018, e shtetasit A.B, i cili ka kërkuar zëvendësimin e prokurores Flora Çela nga ndjekja e një procedimi penal, në të cilin znj. Flora Çela kishte zëvendësuar një prokuror tjetër. Kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe është arkivuar.

të qartësisë së arsytimit të aktit të përgatitur prej saj dhe përpiket të përdorë karakteret e gjuhës shqipe “ë” dhe “ç”.

Aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit janë të konceptuara përgjithësisht me tri pjesë. Përmbajtja e akteve u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Rezulton se në aktet e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit i kushtohet rëndësi pasqyrimin të përmbajtjes së provave, duke paraqitur në mënyrë të hollësishme përmbajtjen e tyre, si dhe tregimit të rrethanave të faktit. Në përmbajtjen e tyre (akteve) formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurorja. Rezulton se konkluzioni i prokurores, në aspektin arsytues, lidhur me konstatimin e faktit penal, mbështetet në analizimin dhe argumentimin e elementeve të figurës së veprës penale. Në të gjitha aktet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet e shortuara janë analizuar në mënyrë të hollësishme ose të përmbledhur elementet e veprës penale objekt hetimi. Prokurorja Flora Çela, në dosjet 4 dhe 5 ka përmendur rrethanat e vlerësuara në funksion të masës së dënimit të kërkuar. Për sa më sipër, konstatojmë se në aktin e diskutimit përfundimtar janë respektuar kërkesat për llojin dhe masën e dënimit, të parashikuara nga neni 47 i Kodit Penal, që ka të bëjë me mënyrën e caktimit të tij. Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

42.2 Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka ushtruar edhe detyrën e zëvendës drejtuesit. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela, ngarkesa dhe saktësia e statistikave që ka pasur dokumentohet me vërtetimin nr. *** prot., datë 20.9.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me procesverbalin “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së 5 dosjeve për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela”, datë 20.9.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe tabelat e administruara. Nga të dhënat statistikore, për periudhën e rivlerësimit, prokurorja Flora Çela ka trajtuar gjithsej 354 materiale hetimore, ku përfshihen mosfillimet, pushimet, gjykimet, por nuk përfshihen pezullimet, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka ushtruar kompetencat që ligji i njeh prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Prokurorja ka kryer detyrat e saj në pajtim me pikat 2 dhe 2.1 të urdhrit nr. 147, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për gjykimin e çështjes dhe konkluzionet përfundimtare formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e Prokurorisë. Nga dokumentet ligjore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga dosjet e përzgjedhura me short ka të dhëna në lidhje me kërkesa për caktimin e masës së sigurimit (në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale), por nuk ka të dhëna, vendime, për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materiale hetimore. Në referencë të të dhënave statistikore dhe obligimeve të saj ligjore si zëvendës drejtuese, konstatohet se prokurorja ka përballuar ngarkesë pune normale gjatë periudhës

së rivlerësimit. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i saj është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Subjekti i rivlerësimit në respektim të afateve procedurale ka paraqitur qëndrimin e saj para gjykatës dhe nuk është bërë ndonjëherë shkak për shtyrjen e gjykimeve për mospërgatitjen e saj për çështjen në gjykim. Vendimi i mosfillimit i procedimit penal për dosjen nr. 1 është marrë brenda afatit 30-ditor të parashikuar në udhëzim nr. 3, datë 19.6.2012 “Për një ndryshim dhe një shtesë në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” i ndryshuar, i Prokurorit të Përgjithshëm. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal dhe Kushtetutës, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurorja, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Flora Çela, është efiçente dhe efektive. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Flora Çela, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, qëndrimin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe disponimin e Gjykatës. Dosja nr. 1, kallëzimi penal nr. ***, me datë regjistrimi 24.12.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mosfilluar në datën 12.1.2015. Kohëzgjatja e hetimeve 19 ditë. Dosja nr. 2, procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 15.1.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (fillimisht pushuar në datën 24.2.2015 për pritjen e letërporosisë dhe rifilluar në datën 1.2.2016), pushuar më 4.4.2016. Kohëzgjatja e hetimeve 1 vit, 3 muaj e 12 ditë. Dosja nr. 3, procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 25.11.2015 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pushuar në datën 7.12.2015. Kohëzgjatja e hetimeve 12 ditë. Dosja nr. 4, procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 19.10.2013 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dërguar për gjykim në datën 13.11.2013. Kohëzgjatja e hetimeve 25 ditë. Dosja nr. 5, procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 5.6.2014 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dërguar për gjykim në datën 1.10.2014. Kohëzgjatja e hetimeve 3 muaj e 26 ditë.

42.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Flora Çela, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë të fundit, subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, ka ushtruar edhe detyrën e zëvendës drejtuesit dhe

drejtuesit të Njësisë së Përbashkët Hetimore. Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurorja Flora Çela, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

42.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej subjektit, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Flora Çela, rezulton t'i nënshtrohet programit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka deklaruar se është angazhuar në aktivitete profesionale (seminare) të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, duke marrë pjesë në 3 seminare. Formularit të vetëvlerësimit i është bashkëlidhur vërtetimi i lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe kopje të certifikatave të trajnimeve për pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese të programit të trajnimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Flora Çela, ka deklaruar në formular pjesëmarrjen në 8 trajnime të kryera nga organizata ndërkombëtare, si dhe jashtë periudhës së rivlerësimit. Formularit të vetëvlerësimit i janë bashkëlidhur kopje të certifikatave, që të vërtetojë kryerjen e këtyre trajnimeve.

C/1. Rivlerësimi i aftësive profesionale

43. Nga analizimi i të gjitha dokumenteve ligjore⁵¹ të administruara dhe akteve të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, pas të cilëve është përgatitur edhe raporti përkatës, duket se nuk vërehen problematika në lidhje me rivlerësimin e këtij kriteri.

43.1 Po ashtu, duket se nuk konstatohen problematika në lidhje me etikën, integritetin dhe paanësinë e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së saj funksionale.

44. Në lidhje me materialet hetimore/kallëzimet e depozituara dhe regjistruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier⁵², Komisioni pas analizimit, për disa prej tyre i kërkoj subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë hetimet e kryera, si dhe statusin e çështjeve.

44.1 Lidhur me kallëzimin penal nr. *** (për sa ishte përshkruar në raportin e vlerësimit të aftësisë profesionale), dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, mbi bazën e kallëzimeve të shtetasit F.M kundër disa prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, për shkak se këta prokurorë kishin vendosur mosfillim të procedimit penal për kallëzimet penale të bëra prej tij ndër vite, për të cilët ka kërkuar fillimin e procedimit për kryerje të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, rezultoi se prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka verifikuar aktet, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në datën 31.1.2016.

a. Komisioni i kërkoj subjektit të japë shpjegime për këtë çështje, të depozitojë kopje të vendimit të mosfillimit mbi këtë material kallëzues, të qartësojë e dokumentojë nëse është ushtruar ankim ndaj vendimit të mosfillimit, si dhe të konfirmojë statusin aktual të këtij vendimi. Po ashtu, Komisioni i kërkoj subjektit të qartësojë dhe dokumentojë çdo vendimmarrje tjetër të dhënë prej saj (nëse kishte të tilla) mbi materiale kallëzuese nga ky shtetas dhe statusin e tyre deri aktualisht.

b. Subjekti në shpjegimet e saj, ndër të tjera, ka sqaruar se sipas të dhënave në regjistër ajo si prokurore ka hetuar një procedim penal me nr. ***, aktet e të cilit bëjnë fjalë për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve,” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ajo ka shpjeguar se fakti penal i referohet kryerjes së hetimeve për pretendime të këtij shtetasi mbi falsifikime të konstatuara në një repart ushtarak të ndodhur në fshatin T., Vlorë. Ndaj këtij procedimi, fillimisht, pas kryerjes së veprimeve hetimore është marrë vendim pushimi datë 22.10.2010. Ky vendim është shfuqizuar

⁵¹ Tri dokumentet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit: kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; ankim “Për vendimin nr. ***, datë 10.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”; kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pesë dokumentet e shortuar: Dosja 1 – Kallëzimi penal nr. ***, datë regjistrimi 24.12.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i shortit: Dokumenti ligjor – Vendim “Për mosfillimin e procedimit penal” datë 12.01.2015, për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2014; Dosja 2 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 15.1.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i shortit: Dokumenti ligjor – Vendim “Për pushimin e çështjes”, datë 4.4.2016, përpiluar nga prokurorja Flora Çela, subjekt rivlerësimi; Dosja 3 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 25.11.2015, për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i shortit: Dokumenti ligjor – Vendim “Për pushimin e procedimit penal”, datë 7.12.2015, përpiluar nga prokurorja Flora Çela, subjekt rivlerësimi; Dosja 4 – Procedimi penal nr.***, regjistruar në datën 19.10.2013, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i shortit: Dokumenti ligjor – Kërkesë “Për gjykimin e çështjes” datë 13.11.2013, hartuar nga prokurorja Flora Çela, subjekt rivlerësimi; Dosja 5 – Procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 5.6.2014, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Objekti i shortit: Dokumenti ligjor – Kërkesë “Për gjykimin e çështjes”, datë 1.10.2014, përpiluar nga prokurorja Flora Çela, subjekt rivlerësimi.

⁵² Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2019.

me ankesën e kallëzuesit nga Prokuroria e Përgjithshme me vendimin nr. 16.5.2012, Drejtoria e Inspektimit, duke rifilluar më tej hetimet. Në përfundim është vendosur pushimi i procedimit penal nr. ***, datë 10.6.2013. Ky vendim sërish është ankimuar nga kallëzuesi F.M në Prokurorinë e Përgjithshme, ku nga Sektori për Hetimin dhe Kontrollin e Ndjekjes Penale, pas verifikimit të ankesës, referuar shkresës nr. *** prot., datë 16.8.2013, është vlerësuar se vendimi i prokurorit të çështjes për pushimin e saj është i bazuar. Subjekti ka sqaruar se nga Prokuroria e Përgjithshme është kryer verifikimi për faktin nëse ky vendim është ankimuar në gjykatë dhe sipas shkresës nr. *** prot. (K. B.) datë 4.11.2013, ka rezultuar se ndaj vendimit të pushimit nuk është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Subjekti ka sqaruar edhe në lidhje me arsyetimin e pushimit. Ajo ka konfirmuar se ky vendim është marrë pasi janë analizuar dhe administruar të gjitha aktet shkresore të ZRPP-së, Arkivit Qendror Teknik Tiranë, Ministrisë së Mbrojtjes, janë pyetur personat e kërkuar nga kallëzuesi deri tek kryetarja e komunës Q, F.K, është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit nëse ka pasur dëmtime apo zaptime të pronave private, nga i cili ka rezultuar se nuk ka asnjë dëmtim të tyre, janë administruar të dhëna nga komuna V. etj. Subjekti ka sqaruar se pretendimet e shtetasit F.M për falsifikim të sipërfaqes së repartit ushtarak nr. *** në H-V. Vlorë, sipas aktit të ekspertimit teknik dhe përgjigjes së Ministrisë së Mbrojtjes nuk janë provuar, pasi nuk ka pasur harta apo të dhëna në lidhje me sipërfaqen e saktë të këtij reparti. Subjekti ka depozituar disa akte provuese⁵³.

c. Trupi gjykues në analizë të shpjegimeve të subjektit, të cilat kryesisht kanë konsistuar në vendimmarrjen e radhës pas shfuqizimit të vendimit të parë nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme, dhe pas njohjes me aktet e depozituara, konstatoi se subjekti në këtë çështje ka hetuar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, duke disponuar me vendim pushimi datë 22.10.2010. Rezultoi se vendimi i pushimit datë 22.10.2010 është shfuqizuar nga organi më i lartë, Prokuroria e Përgjithshme me vendimin e saj datë 16.5.2012, pasi janë konstatuar disa shkelje procedurale të cilat e kanë kategorizuar vendimin të pabazuar në prova e ligj.

ç. Trupi gjykues nga aktet e administruara konkludoi se mangësitë e konstatuara në vendimin e pushimit ishin të provuara dhe të korrigjuara vetëm në vendimmarrjen e radhës, kësaj subjektit ka vepruar në kundërshtim me nenin 73/2 të ligjit nr. 84/2016. Më konkretisht, u konstatuan: (i) zvarritje të çështjes, pasi rezultoi se kallëzimi është depozituar në datën 10.3.2009 dhe regjistrimi i procedimit është bërë në datën 7.12.2009, pra rreth 9 muaj më pas, në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 27.10.2006, të Prokurorit të Përgjithshëm; (ii) nuk ishin pyetur e sqaruar rrethanat e plota të çështjes së pretenduar nga kallëzuesi apo fakteve të dala gjatë hetimit, të cilat kanë rezultuar të përmbushura vetëm pas prishjes së vendimit dhe rifillimit të hetimit; (iii) subjekti në kërkimet hetimore për sqarimin e fakteve nuk bashkëlidh dokumentin që kërkohet të sqarohet/konfirmohet nga ZVRPP Vlorë, skicën e pasurisë objekt hetimi me numrin kadastral përkatës.

⁵³ Vendim pushimi datë 10.6.2013; vendim shfuqizimi datë 16.5.2012; vendim pushimi 22.10.2012; kallëzim penal nr. *** prot., datë 10.3.2009; të dhëna nga regjistri elektronik etj.

d. Në kushte të tilla, mangësitë e konstatuara u vlerësuan së bashku me problematikat e diktuar në çështjet e tjera të renditura në vendimin e pezullimit të subjektit për dërgimin e saj në Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

44.2 Lidhur me kallëzimin penal nr. ***, dërguar me shkresën nr. ***, datë 9.7.2014, të Prokurorisë së Përgjithshme, mbi bazën e kallëzimeve të shtetasit M.(M) H. Ai ka pretenduar se prokurorja Flora Çela ka vepruar në kundërshtim me ligjin kur e ka marrë atë të pandehur dhe ka kërkuar gjykimin e tij për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”. Prokurorja Flora Çela së bashku me funksionar të tjerë të drejtësisë në Vlorë kanë bashkëpunuar për dënimin e tij. Ai ka kërkuar fillimin e procedimit për kryerje të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka verifikuar aktet, ka vendosur pushimin e procedimit penal në datën 20.2.2015.

Nga aktet e dosjes së administruar së bashku me raportin e vlerësimit profesional, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e çështjes, ndërsa gjykata me vendimin nr. ***, datë 14.4.2014, ka vendosur pushimin e saj për shkak të zbatimit të ligjit nr. 22/2014, “Për Amnistinë”.

44.3 Është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 18.9.2017, i cili ka kaluar për kompetencë në datën 30.7.2018 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

a. Me shkresën nr. *** prot., datë 9.10.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka informuar se: Është regjistruar procedimi penal nr. ***, viti 2018, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim është procedimi penal nr. ***, datë 18.9.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i cili ka ardhur për kompetencë. Ky procedim ka filluar në bazë të kallëzimit të shtetasve I.B dhe M.B kundër disa prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku përfshihet edhe subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, sepse këta prokurorë nuk kanë kryer detyrën. Nga aktet rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier i është drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit. Me vendimin nr. ***, datë 2.7.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka rrëzuar kërkesën. Më pas, çështja është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky procedim penal është ende në fazë hetimi.

b. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë mbi çështjen e ankuar nga shtetasit I.B dhe M.B, konkretisht: të dokumentojë veprimet hetimore të kryera nga ana e saj në këtë çështje; të dokumentojë vendimin e dhënë ndaj ankesës/materialit kallëzues të shtetasve B.; të qartësojë dhe dokumentojë statusin aktual të vendimit të dhënë mbi materialin kallëzues të shtetasve B. (nëse ka pasur ankim ndaj vendimit të organit të akuzës dhe si ka vijuar çështja në organet e gjyqësorit); të depozitojë kopje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nr. ***, datë 2.7.2018; si dhe të shpjegojë dhe dokumentojë statusin aktual të çështjes së kthyer pas vendimit nr. ***, datë 2.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

c. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se kallëzuesja I.B ka përmendur edhe pronën me nr. ***, për të cilën ajo ka pasur një kallëzim të saj ndaj shtetasit K.U dhe, për këtë arsye, ka vijuar të japë shpjegime duke konfirmuar se nuk ka hetuar ndonjë çështje tjetër me këtë pronë. Subjekti ka sqaruar se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nr. ***, datë 29.3.2018, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, aktet e të cilit

bëjnë fjalë për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal. Fillimisht, ka sqaruar ajo, është marrë vendim mosfillimi datë 13.9.2017, me arsyetimin se punimet nuk konsiderohen punime ndërtimi sipas Kodit Penal (punime druri) dhe se shtetasi K.U ka disponuar një leje shfrytëzimi të marrë nga Bashkia Himarë të një sipërfaqeje në P., Dh. Gjykata e Shkallës së Parë e ka lënë vendimin në fuqi, ndërsa Gjykata e Apelit e ka kthyer për hetime.

ç. Subjekti ka përshkruar një historik të konfliktit pronësor me shtetasin K., për të cilin shtetasja I.B është paraqitur në Komisaratin e Policisë Himarë ndaj shtetasit K.

Subjekti ka konfirmuar kryerjen e disa veprimeve hetimore. Ajo ka pasqyruar veprimet hetimore të kryera pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Apelit, si marrjen e vendimit për kryerjen e ekspertimit teknik topografik në lidhje me sipërfaqen e tokës në të cilën ndodhet ndërtimi prej druri i kryer nga shtetasi K.U, për shkak se kallëzuesja ka pasur pretendime pronësie mbi pasuritë e regjistruara në emër të këtij shtetasi. Subjekti ka konfirmuar se veprimet hetimore të kryera prej saj i përkasin procedimit procedimin penal nr. ***, para bashkimit me disa procedime të tjera dhe dërgimin e tij në gjyq. Sipas subjektit, rezulton se ka pasur disa procedime penale të regjistruara për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, konkretisht shtetasit K.U, dhe se këto procedime janë bashkuar në një procedim të vetëm, duke u dërguar çështja për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë datë 28.8.2022, për veprën penale “Ndërtimi pa leje”, parashikuar nga neni 199a/1 i Kodit Penal. Subjekti ka sqaruar se me vendimin nr. ***, datë 16.5.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ky shtetas është deklaruar fajtor për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal dhe është dënuar me 9 muaj burgim. Në aplikim të gjykimit të shkurtuar është ulur 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 6 muaj burgim dhe është aplikuar neni 63, pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke kryer një punë në interes publik. Nga organi i akuzës është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit K.U dhe dënimi i tij për kryerjen e veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, neni 199/a/1 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 9 burgim. Në aplikim të gjykimit të shkurtuar të ulet 1/3 e dënimit dhe aplikimi i pezullimit të dënimit sipas nenit 59 të Kodit Penal.

d. Në lidhje me çështjen penale nr. ***, me kërkesën datë 29.12.2017, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke kërkuar pushimin e këtij procedimi penal, me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me vendimin nr. ***, datë 2.7.2018, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Fier dhe kthimin e akteve të procedimit penal nr. *** Prokurorisë së Rrethit Fier për vazhdimin e hetimeve”. Pas hetimeve të kryera, si dhe moskompetencave gjatë hetimit të kësaj çështjeje, për shkak se ka qenë regjistruar edhe për veprën penale “Ndërtimi pa leje” përveç veprës “Shpërdorimi i detyrës”, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 7.2.2020 ka paraqitur kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. ***, i cili ka marrë nr. *** në Prokurorinë e Rrethit Fier, dhe me vendimin nr. ***, datë 24.9.2020, është vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier pushimi i procedimit penal nr. ***, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Subjekti ka shpjeguar edhe në lidhje me *pretendimet e shtetasës I.B për zhdukje të kallëzimit penal të paraqitur me shkrim dore në fletë formati, duke kundërshtuar këtë pretendim*, me argumentin se nga eksperiencia e saj shumëvjeçare në sistemin e drejtësisë nuk ka ndodhur që të humbasë asnjë shkresë zyrtare,

ose të paktën gjurma e saj do të shfaqet në protokoll hyrës, pasi asnjë dokument nuk hyn në institucion pa kaluar më parë nga protokollu. Ajo ka sqaruar se edhe në rastin konkret, kallëzimi penal që është paraqitur nga kjo shtetase rezulton të jetë regjistruar në protokoll me numër hyrës.

dh. Subjekti ka konfirmuar se: *“Ky material kallëzues i pretenduar prej kësaj shtetaseje është po i njëjti me atë në hetim nga ana ime për shtetasin K.U dhe pasi është ripërpiluar si akt në një procedim tjetër, është hetuar duke u bashkuar procedimet penale dhe çështja është dërguar për gjykim”.*

Subjekti ka depozituar vendimet e kërkuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, aktet e dosjes së procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit K.U, si dhe vendimin e gjykatës të formës së prerë për deklarimin fajtor të këtij shtetasi.

e. Komisionit, nga hetimi i kryer lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 18.9.2017, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier mbi bazë të kallëzimit të shtetasve I.B dhe M.B, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit në datën 13.9.2017 ka vendosur “Mosfillimin e materialit kallëzues nr. ***” për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, vënë në lëvizje nga shtetasit B. ndaj shtetasit K.U. Shtetasit B. kanë pretenduar se shtetasi K.U ka ndërtuar pa leje në tokën e tyre në Dh. Konstatohet se Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 29.3.2018, ka prishur vendimin e mosfillimit të çështjes, duke e quajtur atë të gabuar dhe ka urdhëruar organin e akuzës të kryhen veprime të tjera të nevojshme hetimore. Pas këtij vendimi subjekti ka regjistruar pa autor procedimin penal nr. ***, datë 2.7.2018, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

ë. Nga aktet në dosje u konstatua se subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer hetime shteruese, si dhe nuk ka konsideruar “sigurimin e padisë” në çështjen civile që ankuesit kanë pasur, apo çdo të dhënë tjetër të dalë gjatë hetimit dhe, për pasojë, nuk është vlerësuar drejt fakti penal⁵⁴; (b) vendimi për kryerjen e aktit të ekspertimit si detyrë e lënë nga gjykata është marrë në kohë relativisht të gjatë nga vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, datë 13.10.2020; (c) nuk pasqyrohen në dosje veprime hetimore të kryera deri në caktimin e kryerjes së aktit të ekspertimit.

f. Në kushte të tilla, mangësitë e konstatuara u vlerësuan së bashku me problematikat e diktuar në çështjet e tjera në vendimin e pezullimit të subjektit për dërgimin e saj në Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

44.4 Drejtoria e Koordinimit Institucional dhe Sektori Protokoll - Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 11.11.2019, ka konfirmuar se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme nuk kanë rezultuar çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit.

44.5 Në lidhje me ankesa të paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2020 kanë rezultuar disa ankesa, si më poshtë trajtohen:

⁵⁴ Shtetasi K.U rezulton përfundimisht i dënuar për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, me vendimin nr. ***, datë 16.5.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

44.5.1 Ankesa nr. ***, viti 2010, e shtetas L.K, e cila ankohej kundër një vendimi mosfillimi të prokurorit, por që vendimi bashkëlidhur ankimit nuk ishte dokument zyrtar i marrë në formën e duhur procedurale dhe nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme.

a. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me këtë ankesë, të depozitojë kopje të vendimit të mosfillimit për të cilën është ankuar shtetasja L.K, si dhe të konfirmojë dhe dokumentojë statusin aktual të vendimit të mosfillimit.

b. Subjekti, ndër të tjera, në lidhje me administrimin e kësaj dosjeje nga arkivi i Prokurorisë së Rrethit Vlorë, ka konfirmuar se *...nuk ndodhen më të arkivuara fizikisht, pasi janë dorëzuar sipas procesverbalit datë 4.8.2023 në Prokurorinë e Përgjithshme.* Pavarësisht kësaj, ajo ka sqaruar se vë në dispozicion nga arkiva e saj elektronike kopje të vendimit të printuar, ku janë sqaruar arsyet e mosfillimit. Subjekti ka vijuar të shpjegojë në lidhje me rrethanat e faktit se *kallëzuesja ka bërë kallëzim penal ndaj bashkëjetuesit të saj H.N, me pretendimin se ky shtetas gjatë natës, kur kanë qenë duke fjetur, i ka vjedhur nga banesa një shumë parash prej 25 (njëzetë e pesë milionë) lekë të vjetra. Në lidhje me këto lekë, ajo ka pretenduar se i ka përfituar nga martesa me një shtetas grek, me të cilin janë ndarë. Nga ana tjetër, H.N po me të njëjtin pretendim ka kryer kallëzim se kjo shtetase i ka vjedhur atij shumen prej 40.000 (dyzetë mijë) euro. Rezulton se pranë prokurorisë është regjistruar procedimi penal nr. ***, ku këta shtetas kanë deklaruar se kanë nisur sërish bashkëjetesën dhe se veprimet me paratë janë kryer pasi kanë pasur të dy administrimin e tyre. Në këto rrethana është administruar një kopje e kësaj dosjeje, e cila është pushuar nga prokurori S.D dhe është marrë vendim mosfillimi, me arsyetimin se nuk ndodhemi përpara elementeve të veprës penale të vjedhjes, sa kohë administrimi është i përbashkët dhe se për pretendime që rrjedhin nga bashkëjetesa palët mund t'i drejtohen edhe gjykatës mbi të drejtat e tyre.*

c. Subjekti ka depozituar kopje të vendimit të saj të mosfillimit datë 16.10.2009, duke sqaruar se vendimi është marrë nga arkiva e saj personale elektronike, në pamundësi të administrimit të dosjes origjinale për shkak të arkivimit. Ajo ka konfirmuar se ndaj vendimit të mosfillimit nuk është bërë ankim dhe për këtë ka depozituar: (i) Kërkesë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme datë 29.9.2023, ku janë kërkuar tri dosje: nr. *** R.T, nr. *** L.K dhe nr. *** L.K. Subjekti ka konfirmuar se dosja nr. *** është hetuar nga prokurori S.D dhe duke qenë se në vendim i është referuar këtij vendimi, ka kërkuar të administrohet për të provuar përmbajtjen edhe të vendimit të saj të mosfillimit, në pamundësi të gjetjes së tij nga arkivi i Prokurorisë së Përgjithshme. Po ashtu ka konfirmuar se më tej dosja është tërhequr nga oficeri i policisë gjyqësore S.K, i cili ka mbajtur procesverbal për këtë dosje sipas kërkesës së saj. Subjekti ka sqaruar se ka komunikuar me shtetasen S. me nr. 068***, e cila është punonjëse e arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ajo e ka sqaruar se dosja nuk është gjetur; (ii) Procesverbalet e mbajtura nga Arkivi Vlorë për nxjerrjen e dosjeve dhe dërgimin në Tiranë; (iii) Kërkesë dhe përgjigje datë 3.10.2023 nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Vlorë, se dosjet nr. ***, nr. *** dhe nr. *** (S.D) janë dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, Arkiva.

ç. Për të provuar faktin që kjo shtetase është njoftuar, subjekti ka depozituar kopje të protokollit të vitit 2009, ku sqaron se rezulton që me nr. protokollit ***, datë 22.10.2009, i dërgohet vendimi i mosfillimit shtetas L.K.

44.5.2 Ankesë nr. ***, viti 2010, e shtetasit R.T, i cili ankohet se nuk është pajisur me vendimin e pushimit të çështjes. Në këtë material nuk përmendet emri i subjektit të rivlerësimit Flora Çela. Ankesa është përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 10.12.2010, për trajtim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

a. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë mbi këtë ankesë, të depozitojë kopje të vendimit të pushimit për të cilën është ankuar ky shtetas, si dhe të qartësojë dhe dokumentojë statusin aktual të vendimit të pushimit të çështjes.

b. Subjekti ka bashkëlidhur vendimin e pushimit datë 23.6.2010, duke sqaruar se nga arkiva e saj elektronike ka nr. procedimi ***, pasi dosja është arkivuar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe nuk gjendet sipas kërkimeve më sipër. Subjekti ka konfirmuar se nga të dhënat nga gjykata, me shkresën datë 3.10.2023 rezulton se ndaj vendimit të pushimit nuk është bërë ankim.

c. Subjekti ka depozituar: (i) Kërkesë drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme datë 29.9.2023, duke sqaruar se janë kërkuar tri dosje: nr. *** R.T, nr. *** L.K dhe nr. *** L.K. Dosja nr. *** është hetuar nga prokurori S.D. Ajo ka konfirmuar se më tej dosja është tërhequr nga oficeri i policisë gjyqësore S.K, i cili ka mbajtur procesverbal sipas kërkesës së saj, ku rezulton e gjetur vetëm një dosje. Subjekti ka sqaruar se ka komunikuar me shtetasen S., me nr. 068***, e cila është punonjëse e arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe se ajo e ka sqaruar se dosja nuk është gjetur; (ii) Procesverbalet e mbajtura nga Arkivi Vlorë për nxjerrjen e dosjeve dhe dërgimin në Tiranë, ku janë dosjet nr. *** R.T dhe nr. *** L.K; (iii) Kërkesë dhe përgjigje datë 3.10.2023 nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Vlorë, se dosjet nr. *** dhe nr. *** dhe *** (S.D) janë dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, Arkiva.

ç. Subjekti, për të provuar faktin që kjo shtetase është njoftuar, ka depozituar kopje të protokollit të vitit 2009, ku sqaron se rezulton se në nr. e protokollit ***, datë 28.6.2010, i dërgohet për njohje vendimi i pushimit të procedimit nr. ***.

44.5.3 Ankesë nr. ***, viti 2011, e shtetasit A.N, i cili është goditur me thikë dhe ankohet kundër kualifikimit që prokurorja Flora Çela i ka bërë veprës penale. Kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe është arkivuar.

a. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë mbi këtë ankesë, të depozitojë kopje të vendimit të dhënë për këtë çështje, si dhe të qartësojë dhe dokumentojë statusin aktual të vendimit të dhënë për këtë çështje.

b. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 1.3.2011, ku është marrë në cilësinë e të pandehurit shtetasi A.O për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”. Çështja është dërguar për gjykim në datën 25.4.2011 dhe nga ana ime është kërkuar deklarimi fajtor i shtetasi A.O për këtë veprë dhe dënimi me tre vjet burgim (gjykim i zakonshëm). Kërkesa e prokurorisë është pranuar nga gjykata.*

*Shtetasi ka pasur një konflikt me shtetasin A.O (si person i panjohur prej tij më parë, por që ka arritur ta identifikojë përmes paraqitjes për njohje me fotografi) dhe rezulton se ky i fundit e ka qëlluar me thikë. Nga akti i ekspertimit nr. ***, datë 16.2.2011, ka rezultuar se ka plagë prerëse në fytyrë në supin e majtë dhe bark, të cilat kanë sjellë paaftësi për punë në masën mbi 9 ditë.*

*Duke mos qenë dakord me këtë konkluzion, kam marrë vendim për kryerjen e riekspertimit mjekoligjor datë 1.4.2011 në IML Tiranë, duke u vënë në dispozicion edhe të gjitha kartelat mjekësore, si dhe duke shoqëruar edhe vetë personin e dëmtuar, në këtë rast ankuesin A.N, kjo me shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2011. Është administruar më tej akti i riekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 29.4.2011, sipas të cilit ka rezultuar se shtetasi A.N ka dëmtim të nervit facial në masën rreth 55% dhe plaga në bark nuk ka qenë depërtuese. Këto dëmtime janë të rënda, pasi kanë sjellë si pasojë dëmtimin e përhershëm në masën 55% të nervit të faqes së majtë.*

*Në këto rrethana është nxjerrë urdhër për ndalimin e shtetasit A.O dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vlerësuar ndalimin për këtë shtetas me vendimin nr. *** akti, datë 14.2.2012, duke caktuar masën e sigurimit “Arrest në burg” dhe më tej çështja është dërguar për gjykim (pas pyetjes edhe të disa personave të tjerë të kërkuar nga palët).*

Gjatë hetimit i dëmtuari ka dhënë deklaratime, por në asnjë rast nuk ka paraqitur kërkesa apo ankesa në lidhje me rrethanat dhe faktet e dala nga hetimi dha as për aktin e ekspertimit. Sqarohet se vendimmarrja për riekspertim ka qenë e imja dhe asnjëherë nga pretendimet e shtetasit A.N”.

c. Subjekti ka depozituar: (i) vendimin nr. ***, datë 2.7.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për deklarimin fajtor të tij dhe dënimin me 3 vjet burgim, për të cilin ka konfirmuar se është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 21.9.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë; (ii) listën e akteve të dosjes nr. ***; (iii) kërkesën për gjykim datë 25.4.2012; (iv) vendimin e riekspertimit dhe aktin e ekspertimit mjekoligjor.

44.5.4 Ankesa nr. ***, viti 2018, e shtetasit A.B, i cili ka kërkuar zëvendësimin e prokurores znj.Flora Çela nga ndjekja e një procedimi penal, në të cilin znj. Flora Çela kishte zëvendësuar një prokuror tjetër. Kjo ankesë nuk është pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe është arkivuar. Nga dokumentacioni i administruar, i përcjellë së bashku me raportin e vlerësimit profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 12.1.2015 ka vendosur “Mosfillimin e kallëzimit penal” ndaj shtetasit A.D për veprën penale “Përndjekja”. Nga verifikimi i akteve rezulton se materiali kallëzues është trajtuar brenda afatit 30-ditor të parashikuar në ligj.

a. Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë mbi ankesën e shtetasit A.B për zëvendësimin e saj, si dhe të qartësojë dhe dokumentojë statusin aktual të vendimit të dhënë për këtë çështje.

b. Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: “Nga aktet që më janë vënë në dispozicion nga Komisioni nuk rezulton një ankesë e shkruar e këtij shtetasi mbi pretendimet që ajo të ketë zëvendësuar një prokuror tjetër në hetimin e çështjes së tij dhe për shkak edhe të kohës së gjatë që ka kaluar nga vendimi, aq sa i kujtohej, ky shtetas ka pasur disa kallëzime penale në prokurori, disa nga të cilat kanë vendimmarrjen e saj”.

c. Subjekti ka konkretizuar se në prokurori është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 24.12.2014, më kallëzues shtetasin A.B ndaj shtetasit A.D, me pretendimin se ky i fundit bënte akuza të padrejta ndaj tij dhe se për këtë fakt gjykata e ka shpallur të pafajshëm kallëzuesin me vendimin nr. ***, datë 24.9.2013. Më tej, ka pretenduar se po në një rast tjetër prokuroria ka vendosur pushim procedimi për një kallëzim penal që shtetasi i kallëzuar ka kryer ndaj tij, nr. ***.

ç. Subjekti ka konfirmuar se është vendosur mosfillimi, me arsyetimin se i kallëzuar ka pasur pretendime të bazuara në disa rrethana fakti të ndodhura mes tyre ndaj shtetasit A.B dhe, për këtë

arsye, i është drejtuar prokurorisë për t'i vlerësuar dhe provuar ato. Fakti që ai është bazuar në disa rrethana fakti që kanë ekzistuar, nuk përbën elemente të veprës penale të përndjekjes, e cila ka si qëllim të shkaktojë gjendje ankthi pa shkak konkret ndaj *një të afërmi ... personi... me lidhje shpirtërore ... ish-bashkëshort...*

d. Sipas të dhënave që ajo ka konfirmuar në regjistrin e regjistrimit të veprave penale, sqaron se nuk i rezulton të ketë zëvendësuar ndonjë prokuror tjetër në ndonjë çështje që lidhet me këtë kallëzues. Subjekti ka depozituar një vendim gjykate, për të cilin sqaron se në të shfaqet një tjetër vendimmarrje e saj me këtë ankues dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë dhe apelit. Po ashtu, ajo ka depozituar: (i) aktet e mosfillimit nr. ***, datë 24.12.2014, mosfilluar në datën 12.1.2015; (ii) përgjigjen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë se ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim; (iii) kopje të vendimit nr. ***, datë 23.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shfuqizuar me vendimin nr. ***, datë 26.9.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke u gjykuar çështja në fakt dhe rrëzuar ankimi i ankuesit A.B.

44.6 Lidhur me ankesat e lartpërmendura, trupi gjykues, pasi u njoh me shpjegimet dhe dokumentet e depozituara nga subjekti për të qartësuar konstatimet e mësipërme, nuk konkludoi në fakte apo rrethana të cilat mund të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, përveçse vërejtje se në çdo rast vendimmarrjet e saj nuk ishin ankimuar.

44.7 SPAK⁵⁵ ka konfirmuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, për të cilin pas kryerjes së veprimeve është vendosur mosfillimi i procedimit penal me datë 12.4.2023. Nga verifikimi i materialit të përcjellë në CD nga SPAK, vërehet se:

44.7.1 SPAK në datën 30.3.2023 ka regjistruar kallëzimin penal nr. *** mbi bazë të materialit kallëzues të shtetasit G.T (në cilësinë e *** të Organizatës së Sindikatës së Pavarur të Naftës P). Kallëzuesi ankohet për disa prokurorë e gjyqtarë të shkallëve të ndryshme. Ai pretendon për veprime e vendime të kundërligjshme të kryera e të dhëna prej tyre, lidhur me pronën e Sindikatës së Pavarur të Kampit të ish-Pionierëve, Vlorë. Kallëzuesi i quan të kallëzuarit se kanë vepruar si një grup i strukturuar kriminal, që në bashkëpunim, sipas pretendimit të tij në kallëzim, kanë ndikuar në vjedhjen e kësaj pasurie. Në vendimin e mosfillimit të SPAK-ut janë renditur pretendimet e kallëzuesit dhe njëkohësisht është arsyetuar edhe mbi secilin prej tyre, si rezultat edhe i marrjes në pyetje të këtij shtetasi. Në këtë vendim, përveçse citohet kallëzimi i adresuar ndaj subjektit të rivlerësimit, nuk jepen të dhëna të tjera. Konkretisht, në vendimin e mosfillimit të SPAK-ut thuhet se kallëzuesi ka kallëzuar prokuroren Çela, e cila ka hetuar procedimin penal nr. ***.

44.7.2 Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi këtë procedim penal (***), si dhe të sqarojë dhe dokumentojë statusin aktual të tij (nga prokuroria apo gjykata, nëse ka pasur ankim).

44.7.3 Subjekti ka sqaruar se kjo çështje është hetuar nga prokurori A.K për veprën penale "Vetëgjyqësia", parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Çështja që lidhet me ankesën e këtij shtetasi është procedimi penal nr. *** i vitit 2015 dhe është hetuar nga prokurori K.L, i cili e ka dërguar në gjykatë me kërkesën për gjykim datë 19.11.2019. Subjekti ka konfirmuar se kjo çështje, me transferimin e tij në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Sarandë, i ka kaluar asaj për

⁵⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.7.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

përfaqësim në gjykatë, sipas procesverbalit nr. *** prot., datë 27.1.2022 dhe se aktualisht kjo çështje është në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me gjyqtare V.C, në fazën e konkluzioneve përfundimtare të prokurorit. Subjekti ka konfirmuar gjithashtu se në lidhje me këtë çështje ka kryer vetëm përfaqësimin në gjykatë sipas shortit pranë zyrës së regjistrit dhe asnjë veprim tjetër. Ajo ka depozituar: (a) kërkesën e prokurorit K.LL për dërgimin në gjyq të çështjes penale; (b) procesverbalin e shortit; (c) shkresën datë 4.10.2023 për verifikimin e procedimit nr. ***; (ç) kërkesën e prokurorit A.K për procedimin penal nr. ***; (d) shkresën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për statusin e saj.

44.7.4 Trupi gjykues pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të administruara nuk vërejtí fakte apo rrethana që mund të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

44.8 SPAK, gjithashtu, në shkresën e përcjellë ka konfirmuar se nga verifikimi i kryer në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nuk rezulton që në ngarkim të shtetas, subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

DENONCIME

45. Në lidhje me 11 denoncimet⁵⁶ e depozituara në Komision, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe në një çështje penale të identifikuar nga aksesi në median *online*⁵⁷, Komisioni u ndal në 7 denoncime⁵⁸, si dhe në çështjen penale të identifikuar nga aksesi në media, duke i kërkuar subjektit të shpjegojë dhe dokumentojë të kundërtën e pretendimeve të denoncuesve, pasi për rastet e tjera nuk konstatoi fakte apo rrethana të cilat mund të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

45.1 Në vijim të shqyrtimit të 7 denoncimeve, Komisioni pas kërkesës për të dhënë subjekti shpjegime dhe depozituar dokumentacion sipas rastit për 2 denoncimet e depozituara, përkatësisht nga shtetasit V.T⁵⁹ dhe J.S⁶⁰, i përfaqësuar nga shtetasi A.GJ, në analizë të prapësimeve të përcjella konstatoi se subjekti ishte bindëse në shpjegimet e saj dhe, për pasojë, nuk konkludoi në fakte apo rrethana të cilat mund të ndikonin në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

46. Ndërsa, sa i përket 5 denoncimeve të tjera dhe çështjes penale/procedimit nr. ***, datë 13.7.2017, pasqyruar në median *online*, Komisioni konstatoi si vijon:

⁵⁶ Nr. *** prot., datë 17.7.2018, i shtetasit M.J; nr. *** prot., datë 15.5.2018, i shtetasit L.M; nr. *** prot., datë 26.12.2017, i shtetasit A.B; nr. *** prot., datë 19.1.2023, i shtetasit G.T, përcjellë nga Komisioneri Publik me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2023; nr. *** prot., datë 25.10.2021, i shtetas M.C, përcjellë nga Komisioneri Publik me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021; nr. *** prot., datë 11.8.2021; nr. *** prot., datë 11.8.2021 dhe nr. *** prot., datë 28.12.2022, të shtetasit V.H; nr. *** prot., datë 21.10.2020, i shtetas R.B; nr. *** prot., datë 5.12.2018 dhe nr. *** prot., datë 13.5.2019, i shtetas K.M; nr. *** prot., datë 12.1.2022, i shtetasit M.M; nr.*** prot., datë 13.6.2023, i shtetasit V.T; nr. *** prot., datë 29.8.2023 dhe nr. *** prot., datë 20.9.2023, i shtetasit J.S, administruar në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ https://tirana***

⁵⁸ Nr. *** prot., datë 25.10.2021, i shtetas M.C, përcjellë nga Komisioneri Publik me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021; nr. *** prot., datë 11.8.2021, nr. *** prot., datë 11.8.2021 dhe nr. *** prot., datë 28.12.2022, të shtetasit V.H; nr. *** prot., datë 21.10.2020, i shtetas R.B; nr. *** prot., datë 5.12.2018 dhe nr. *** prot., datë 13.5.2019, i shtetas K.M; nr. *** prot., datë 12.1.2022, i shtetasit M.M; nr. *** prot., datë 13.6.2023, i shtetasit V.T; nr. *** prot., datë 29.8.2023 dhe nr. *** prot., datë 20.9.2023, i shtetasit J.S.

⁵⁹ Nr. *** prot., datë 13.6.2023, i shtetasit V.T.

⁶⁰ Denoncimi nr. *** prot., datë 29.8.2023 dhe nr. *** prot., datë 20.9.2023.

46.1 Denoncim⁶¹ i shtetases M.C

46.1.1 Denoncuesja (me detyrë pedagoge në Fakultetin e Sh “****”, Vlorë) ankohet ndaj vendimit të mosfillimit të subjektit të rivlerësimit, marrë mbi kallëzimin penal nr. ***, datë 15.10.2021. Sipas denoncimit, kallëzimi është vënë në lëvizje prej saj, për disa vepra penale sipas neneve 301, 248, 293/b, 143/b, 186/a etj. Denoncuesja nuk identifikon shkelje konkrete, por thjesht dhe vetëm ka depozituar kallëzimin penal, nuk ka depozituar kopje të vendimit për mosfillim të kallëzimit penal. Ankuesja pretendon se ka kallëzuar dy shtetase, për të cilat sqaron se kanë ndikuar në pengimin e zbulimit të së vërtetës nëpërmjet falsifikimit kompjuterik, duke mashtruar dhe ndërhyrë në të dhëna kompjuterike. Denoncuesja ankohet se ato kanë kryer plagjiaturë, duke krijuar kështu përfitime monetare dhe institucionale. Përgjithësisht në formularin e ankimit citon se çështja është zvarritur, duke përfshirë në ankesën e saj edhe shkeljen e etikës.

46.1.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit: (a) të japë shpjegime në lidhje me këtë denoncim; (b) të depozitojë kopje të vendimit për mosfillimin e çështjes; (c) të qartësojë dhe dokumentojë statusin ligjor të vendimit të mosfillimit të kësaj çështjeje deri aktualisht.

46.1.3 Subjekti në lidhje me këtë ankesë ka sqaruar se kjo shtetase ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. *** prot., hyrës datë 26.7.2021, i cili ka marrë numër kallëzimi penal ***, datë 27.7.2021. Nga materiali kallëzues ka rezultuar se kjo shtetase është me profesion pedagoge në universitetin “****”, Vlorë dhe për shkak të punës së saj ajo ka kallëzuar dy kolegë, duke pretenduar se kanë ndikuar në vlerësimin e një punimi shkencor të realizuar nga shtetasja M.Z. Sipas kallëzueses, punimi i kësaj shtetaseje është plagjiaturë në masën 49.15%, dhe ndërkohë është vlerësuar nga shtetasja E.L, në detyrën e kryetares së Këshillit të Etikës në universitet, se është plagjiaturë në masën 5.99%.

46.1.4 Subjekti ka konfirmuar se nga të dhënat e administruara dhe të vëna në dispozicion nga kallëzuesja, rezulton se sipas vlerësimit të kryer nga universiteti “****”, Vlorë, datë 25.9.2020, mbi bazën e ankesës së saj, materiali është brenda normave të pranueshme të një dizertacioni, bazuar në vendimin e Senatit Akademik të universitetit nr. ***, datë 11.2.2020. Gjithashtu, ajo ka konfirmuar se për këto arsye është vendosur mosfillimi mbi bazën e akteve të ndodhura në kallëzimin e dërguar nga kjo shtetase, në datën 4.10.2021. Ky vendim i është njoftuar kallëzueses me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2021. Në vijim ka shpjeguar se *duke qenë se kallëzimi është regjistruar në datën 27.7.2021 dhe kemi qenë para muajit gusht të lejes së zakonshme, duke u rikthyer javën e dytë të muajit shtator, është marrë vendim në një afat kohor të tillë vendimmarrje. Përtej kësaj, duke marrë parasysh edhe llojin e veprës për të cilin është bërë kallëzimi penal, është marrë koha e nevojshme për studimin e materialit në detaje, rreth 30 ditë nga marrja në dorëzim e tij.*

46.1.5 Në lidhje me statusin e çështjes, subjekti ka sqaruar se ndaj vendimit të mosfillimit të mësipërm nuk është bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Subjekti ka depozituar kopje të vendimit të mosfillimit dhe kopje të shkresës së njoftimit.

⁶¹ Nr. *** prot., datë 25.10.2021, administruar në dosjen e Komisionit, përcjellë nga Komisioneri Publik me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2021.

46.1.6 Komisioni lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 27.7.2021, të shtetases M.Ç, kundër shtetaseve E.L dhe M.Z, akuzuar për veprat penale të parashikuara përkatësisht nga neni 147 i Kodit Penal “Mashtrimi për veprat e artit e të kulturës”, neni 148 “Botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet” dhe neni 149 “Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit”, ka konstatuar subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendim mosfillimi datë 4.10.2021. Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm konstatohet se vendimi i mosfillimit (edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit për ekzistencën e muajit gusht si kohë e kryerjes së pushimeve vjetore) është marrë në tejkalim të afatit 15-ditor, sikurse parashikohet në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale. Në kushte të tilla, mangësia e konstatuar në këtë rast është përfshirë në vendimin e pezullimit të subjektit nga ushtrimi i detyrës për dërgimin e saj në Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

46.2 Denoncim⁶² i shtetasit V.H

46.2.1 Denoncuesi ankohet për shumë subjekte, ndër ta edhe për subjektin e rivlerësimit, që me veprimet apo mosveprimet e tyre kanë sjellë moszgjidhje të një konflikti pronësor. Denoncuesi ka depozituar kallëzim për ndërtim të paligjshëm dhe vetëgjyqësi. Denoncuesi përshkruan historikun e këtij konflikti. Ai shpjegon se është bashkëpronar në kompleksin “***”, me vendndodhje në Dh. Kompleksi përbëhet nga tri godina me sip. 600 m² ndërtim dhe 2.400 m² ambiente të përbashkëta. Bashkëpronarët janë: në godinën nr. *** denoncuesi me 4 shtetas të tjerë; në godinën *** pronar LL.J, pronar i truallit ku është ngritur kompleksi; dhe në godinën nr. *** pronar N.M, nënkontraktor i firmës së ndërtimit “***”. Denoncuesi ka kallëzuar në policinë e Himarës në vitin 2017 shtetasin N.M për ushtrim të dhunës fizike ndaj tij, kallëzim i tërhequr dhe mbyllur më pas, për arsye se ky i fundit kishte kërkuar ndjesë. Por, në vijim, në muajin qershor 2018 denoncuesi denoncon shtetasin N.M në polici për përvetësim dhe shfrytëzim të ambienteve të përbashkëta të kompleksit dhe ndërtim të paligjshëm. Ai pretendon se subjekti i rivlerësimit e ka pushuar padrejtësisht çështjen në mënyrë të përsëritur. Gjithashtu pretendon edhe për zvarritje në hetimin e kësaj çështjeje.

46.2.2 Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti, por edhe nga ai i administruar nga Komisioni⁶³, konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë 13.2.2019, ka rrëzuar ankimin e denoncuesit, i cili kishte si objekt shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 17.7.2018, për veprën penale “Vetëgjyqësia”, marrë nga subjekti i rivlerësimit, pasi fakti nuk përbënte vepër penale.

46.2.3 Më tej, po sipas dokumentacionit të depozituar, vërehet se Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 9.4.2019, ka prishur vendimin e shkallës së parë dhe ka kthyer çështjen organit të akuzës për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, duke konkretizuar: (a) Kryerjen e ekspertizës topografike nga një inxhinier ndërtimi, për të parë nëse është e mundur hyrja në kompleks nga një drejtim tjetër me makina pa kaluar nga rruga hyrëse aktuale, nëse kjo rrugë është pronë private e shtetasit N.M apo është për përdorim të përbashkët nga të gjithë bashkëpronarët, për të përcaktuar nëse hyrja për parkim është në përputhje me projektin e miratuar nga KRRT,

⁶² Nr. *** prot., datë 11.8.2021, nr. *** prot., datë 11.8.2021 dhe nr. *** prot., datë 28.12.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶³ Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

Bashkia Himarë; (b) Hetim të thelluar mbi përcaktimin e pronësisë së bashkëpronarëve nëpërmjet kontratave me firmën ndërtuese “Gjiguria”; (c) Organi i akuzës duhet të marrë në pyetje edhe banorë të tjerë të kompleksit, për të ditur nëse shtetasi N.M ka konflikt me ta apo vetëm me V.H etj. Përsëri subjekti ka kërkuar pushimin e çështjes me kërkesën e saj datë 29.7.2021, në të cilën pasqyrohen detyrat e kryera në funksion të vendimit të Gjykatës së Apelit. Në të thuhet se është marrë vendim për kryerjen e aktit të ekspertimit, duke cituar edhe konkluzionet e aktit. Në këtë kërkesë ishte e paqartë të kuptohej nëse ishin pyetur banorët e tjerë, sikurse ishte lënë detyrë nga Gjykata e Apelit; (ç) Dukej se kryerja e hetimeve pas vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë datë 9.4.2019 kishte zgjatur më shumë se 2 vjet deri në kërkesën për pushimin e çështjes, datë 29.7.2021. Nga aktet rezultoi se detyra e lënë nga Gjykata e Apelit për kryerjen e aktit të ekspertimit topografik është përmbushur në datën 31.5.2021, sipas vendimit të subjektit të rivlerësimit, për kryerjen e aktit të ekspertimit. Dukej se ky veprim hetimor ishte ndërmarrë dy vite pas vendimit të Gjykatës së Apelit.

46.2.4 Rezultoi se pas kërkesës së përsëritur për pushimin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë 25.7.2022, nuk ka miratuar kërkesën e subjektit për pushimin e çështjes dhe, për këtë arsye, vendimi është ankimuar, nga ku rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 3.11.2022, ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

46.2.5 Sa më sipër, në gjendjen që ndodheshin aktet, Komisioni konstatoi se: (a) dukej se subjekti në kthimin e çështjes për hetime të tjera nuk ka përmbushur detyrën e lënë nga Gjykata e Apelit Vlorë për të pyetur banorët e tjerë të godinës, pasi në dosje nuk ka të administruar ndonjë akt që të provojë këtë fakt; (b) dukej se kryerja e hetimeve pas vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë datë 9.4.2019, për kthimin e çështjes për hetime të tjera, ka zgjatur më shumë se 2 vjet deri në kërkesën për pushimin e çështjes datë 29.7.2021, në mënyrë të pajustificuar, pasi nga aktet nuk konstatohet kryerja e ndonjë veprimi hetimor; (c) nga aktet rezulton se detyra e lënë nga Gjykata e Apelit për kryerjen e aktit të ekspertimit topografik është përmbushur në datën 31.5.2021, veprim hetimor ky i ndërmarrë dy vite pas vendimit të Gjykatës së Apelit. Mbi këto konstatime Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi subjektit: (i) të japë shpjegime dhe të dokumentonte të kundërtën e konstatimeve; (ii) të dokumentonte statusin ligjor të kësaj çështjeje.

46.2.6 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 7.7.2018, regjistruar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, rezultoi se subjekti ka disponuar me vendim pushimi datë 12.10.2018. Më tej, kallëzuesi ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 13.2.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit V.H dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit të Prokurorisë. Ndaj këtij vendimi është ushtruar sërish ankim nga kallëzuesi V.H dhe me vendimin nr. ***, datë 9.4.2019, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe vazhdimin e hetimeve për procedimin penal nr. ***, duke kthyer aktet.

46.2.7 Në shpjegimet e saj, subjekti ka konfirmuar se me shkresën datë 24.10.2019, këto akte janë dërguar pranë Prokurorisë së Rrethit Vlorë, por nuk janë kthyer aktet e procedimit penal. Më tej, me shkresën nr. *** prot., datë 20.2.2020, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është kërkuar kthimi i akteve të procedimit, të cilat duhet t’i bashkëlidheshin vendimit të formës së prerë.

Sipas shkresës së Gjykatës nr. *** prot., datë 4.3.2020, rezulton se aktet në dosjen gjyqësore nr. ***, datë 13.2.2019, janë fotokopje dhe ndaj nuk është bërë kthimi i tyre. Pas kësaj, ajo ka konfirmuar se ka rifilluar hetimi me marrjen e kësaj përgjigjeje nga gjykata në datën 4.3.2021 dhe kjo çështje është bashkuar me procedimin penal nr. ***, regjistruar për veprën “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, me prokuror A.S, me të njëjtat pretendime të ankuesit V.H. Më tej ka sqaruar se është marrë vendimi datë 10.6.2021 për kryerje ekspertimi, e cila me shkresën nr. *** prot. i është njoftuar shtetasve V.H dhe N.M, pasi ndërkohë janë administruar të dhëna nga Bashkia Himarë për punimet e ndërtimit të pretenduara në objektin e shtetasit N.M. Gjithashtu, ka pretenduar se duke qenë se me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë *nuk është përcaktuar lista e personave që duhet të pyeteshin sipas kërkesës së ankuesit V.H*, në këto rrethana është bërë i vështirë zbatimi i këtij vendimi, pasi vetë ankuesi referonte në një shtetas, LL.J. Subjekti ka sqaruar se me procesverbalin e këqyrjes datë 21.7.2021 është administruar edhe kontrata e porosisë së këtij shtetasi me firmën për të sqaruar rrethanat e pretenduara. Me administrimin e akteve të ekspertimit datë 5.7.2021, nr. *** prot. hyrës, nuk janë konstatuar punime ndërtimi pa leje dhe se kallëzuesi V.H ka pasur mundësi të hyjë në objekt në rrugë tjetër kalimi. Subjekti ka konfirmuar se është pyetur pronari i truallit ku është kryer ndërtimi, shtetasi LL.J, është marrë vendim ekspertimi duke u zbatuar vendimi i Gjykatës së Apelit, edhe pse pa përcaktuar listë dëshmitarësh në vendimmarrje, dhe arsyen pse duhet të pyeten ata dhe në këto rrethana është marrë sërish vendim pushimi i procedimit penal datë 29.7.2021.

46.2.8 Subjekti ka shpjeguar se nga data 4.3.2021, kur është marrë përgjigja nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë mbi gjendjen e akteve, deri në datën 29.7.2021 kishin kaluar vetëm 4 muaj (referuar dhe ngarkesës dhe përparësisë së çështjeve me të arrestuar, ndërsa kjo është kundërvajtje penale). Por edhe nëse do t’i referohemi njoftimit të vendimit të formës së prerë në tetor të vitit 2019, ka sqaruar se gjithsej janë 9 muaj hetime për dy procedime penale të bashkuara, vetëgjyqësi dhe ndërtim i paligjshëm (referuar edhe ngarkesës dhe përparësisë së çështjeve me të arrestuar).

46.2.9 Sipas subjektit, kjo çështje është kthyer nga Apeli për shkelje procedurale të gjyqtarit gjatë gjykimit të saj (pasi ka marrë vendim ekspertimi në seancën e shqyrtimit të kërkesës për pushim) dhe aktualisht është në pritje të njoftimit për seancën gjyqësore.

46.2.10 Subjekti ka depozituar aktet e dosjes, duke konfirmuar gjithashtu se në vendim janë sqaruar edhe veprimet hetimore.

46.2.11 Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, konstatohet se subjekti: (a) është vënë në lëvizje në intervale të gjata kohore për marrjen e akteve, duke proceduar në tejkallim të afateve kohore të arsyeshme; (b) ka marrë vendim thuajse pas 3 muajve nga nisja e rihetimit datë 4.3.2021, me datë 31.5.2021 (njoftuar denoncuesit më 10.6.2021), për bërjen e aktit të ekspertimit, duke mos ndërmarrë në kohë veprimin e lënë nga Gjykata.

46.2.12 Trupi gjykues për këtë çështje vlerësoi se subjekti shfaq mangësi në drejtim të administrimit të akteve dhe mbikëqyrjen e tyre, ka ceduar në efektivitetin e zbatimit të procedurave brenda afateve kohore dhe, për pasojë, këto mangësi u përfshinë në vendimin e pezullimit të subjektit nga ushtrimi i detyrës për dërgimin e saj në Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

46.3 Denoncim⁶⁴ i shtetas R.B

46.3.1 Denoncuesja pretendon se është nxjerrë forcërisht nga një banesë që e ka blerë dhe institucionet shtetërore nuk kanë zbatuar ligjin për ta mbrojtur dhe dënua fajtorët. Denoncuesja i është drejtuar SPAK-ut me materialin kallëzues për disa shtetas, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit, oficerë të policisë gjyqësore e punonjës të Komisarariatit të Policisë Gjyqësore Vlorë, për arsye të pretendimeve të saj mbi kallëzimet e vazhdueshme që ka depozituar. Ajo ka kallëzuar këta shtetas, por edhe punonjës të tjerë të institucioneve publike dhe jo vetëm për veprat penale të korrupsionit pasiv, shpërdorimit të detyrës, mashtrimit, vetëgjyqësisë, dhunimit të banesës etj. Denoncuesja ankohet se SPAK-u duhet të kishte dalë me vendim dhe jo t’ia kalonte çështjen për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për shkak se nga përmbajta e kallëzimit nuk rezultonin *indicie* për këtë vepër penale, por kjo vjen (ka pretenduar ajo) si shkak i personave të kallëzuar, të cilët kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, ku ndër ta ka përfshirë edhe shtetasin A.M, duke cituar se është vëllai i ish-gjyqtarit M.

46.3.2 Nga dokumentacioni i administruar nuk prezantohet ndonjë e dhënë lidhur me subjektin e rivlerësimit, përveçse qartësohet se ndaj kallëzimit për subjektin e rivlerësimit Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin nr. ***, datë 2.7.2020.

46.3.3 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë lidhur me pozitën e saj në hetimin e kallëzimit të adresuar në prokurori nga denoncuesja, i hetuar i përfunduar prej saj, shkak i të cilit është bërë më tej edhe kallëzimi në SPAK për shpërdorim detyre, të dokumentojë veprimet hetimore të kryera në lidhje me kallëzimin që mund të kishte trajtuar, të sqarojë dhe dokumentojë statusin aktual të kallëzimit të hetuar prej saj, përfshirë depozitimin e kopjes së vendimit të dhënë (nëse kishte një të tillë), si dhe të sqarojë dhe dokumentojë statusin aktual të çështjes nëse ajo ishte në hetim apo kishte përfunduar në organet e gjyqësorit.

46.3.4 Subjekti në lidhje me kërkimin e Komisionit ka shpjeguar se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal nr. *** mbi bazën e materialit të referuar nga Komisarati i Policisë Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 4.12.2019, për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Nga hetimet e kryera në kuadër të këtij procedimi penal ka rezultuar se në datën 27.11.2019 është paraqitur në Komisarariatit të Policisë Vlorë shtetas R.B dhe L.M (bashkëshortja e shtetasit M.M, i cili ka kryer ankimin më lart), duke bërë ankim penal për fillimin e çështjes penale ndaj shtetasit A.M, për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Në ankimin e saj shtetasja R.B ka sqaruar se në datën 27.11.2019, rreth orës 15:40 ka qenë duke shkuar tek apartamenti i saj në lagjen “***”, Vlorë, pallati “***”. Sapo ka shkuar tek hyrja i ka dalë para shtetasi A.M, i cili i ka zënë portën me krah. Ajo ka tentuar të hapë portën së bashku me shtetasen L.M, por janë shtyrë nga shtetas A.M, duke u kërcënuar me fjalët “*nuk do ta hash ti djersën time, nuk lejohet pasi është pronë private*”. Në këto rrethana, ato kanë njoftuar në telefon policinë. Po kështu, në ankimin e saj shtetasja L.M ka deklaruar se në datën e mësipërme ka shkuar së bashku me shtetasen R.B për tek pallati dhe u ka dalë para shtetasi A.M dhe me shumë sforcë ato kanë arritur të hyjnë, duke u kërcënuar nga ky shtetas me fjalët “*do ta shikoni çfarë do t’ju bëj*”. Në lidhje me dhunën apo goditjet e ushtruara

⁶⁴ Nr. *** prot., datë 21.10.2020, administruar në dosjen e Komisionit.

nga shtetasi A.M, ato kanë sqaruar se thjesht janë shtyrë. Shtetasi A.M nuk ka pranuar faktin që i ngarkohet nga kallëzuesja, duke sqaruar se rrethanat e tij janë të ndryshme. Ai sqaron se nuk e ka kanosur atë dhe sipas tij ato kanë zënë një apartament pa të drejtë në pallatin ku ai është administrator, por përtej kësaj nuk kanë paguar detyrimet që lidhen me shfrytëzimin e ambienteve të përbashkëta. Sipas tij, ky apartament i është dhënë kallëzueses R.B nga shtetasi M.M, ndërkohë që janë në vazhdim proceset civile mes tyre.

46.3.5 Subjekti ka konfirmuar se pushimi është marrë me arsyetimin se nuk ndodhemi para elementeve të veprës penale të kanosjes, pasi nuk plotësohen kërkesat e dispozitës për ekzistencën e saj, duke qenë se konflikti ka qenë për pagesa detyrimesh ashensori apo të përdorimit të ambienteve të përbashkëta të pallatit. Po kështu, për veprën penale të fyerjes sipas nenit 59 të Kodit Procedurës Penale, subjekti ka sqaruar se palët mund t'i drejtoheshin gjykatës me ankim të drejtpërdrejtë.

46.3.6 Mbi konfirmimin e statusit të çështjes subjekti ka sqaruar se fillimisht mbi këtë material është marrë vendim pushimi datë 26.2.2020, i cili është ankimuar nga shtetasja R.B. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka lënë në fuqi këtë vendim me vendimin nr. ***, datë 13.10.2020, i cili është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, e cila e ka kthyer çështjen për hetime në drejtim të veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Ajo ka shpjeguar se në vazhdim, në respektim të vendimit të Gjykatës së Apelit, është hetuar në drejtim të vetëgjyqësisë dhe gjatë hetimit ka rezultuar se është regjistruar një procedim tjetër penal nr. ***, për veprën penale “Vetëgjyqësia”, ku rezulton se ka shkuar për gjykim në ngarkim të shtetasit A.M dhe është marrë pafajësi me vendimin nr. ***, datë 8.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Duke qenë se është trajtuar e njëjta çështje objekt hetimi me atë të procedimit penal nr. *** prej saj për këtë procedim, është marrë vendim pushimi.

46.3.7 Subjekti ka konfirmuar se ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë nga kallëzuesja R.B dhe me vendimin nr. ***, datë 5.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së shtetasës R.B”, porse ka sqaruar se vendimi nuk ka marrë formë të prerë.

46.3.8 Subjekti ka dhënë shpjegime edhe lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 18.12.2019, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 4.12.2019, për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, për të cilin është marrë vendim pushimi datë 26.2.2020, i cili është ankimuar nga shtetasja R.B. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 13.10.2020, ka lënë në fuqi këtë vendim, i cili më tej është prishur nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 22.12.2020, duke u kthyer çështja për hetime të tjera në drejtim të veprës penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

46.3.9 Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, trupi gjykues konstatoi se subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të identifikimit të elementeve të veprës tjetër penale të vetëgjyqësisë, ashtu sikurse kishte konstatuar edhe gjykata mbi vendimet e subjektit, të cilat rezultuan të prishura.

46.3.10 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, vlerësoi se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore; si dhe në aspektin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kritere të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 dhe pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këto kushte, mangësitë e konstatuara u përfshinë në vendimin e pezullimit të ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit për dërgimin e saj në Shkollën e Magjistraturës, për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

46.4 Denoncim⁶⁵ i shtetases K.M

46.4.1 Denoncuesja, në cilësinë e motrës së viktimës, ankohet për zvarritje të hetimeve në çështjen penale në ngarkim të shtetases A.S, akuzuar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, me pasojë vdekjen e vëllait të saj, B.M.

46.4.2 Denoncuesja ka kërkuar me anë të kërkesës datë 22.11.2018, drejtuar Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, përjashtimin e subjektit të rivlerësimit, kërkesë e cila sipas shpjegimit të saj nuk është pranuar, duke u lënë në fuqi përfaqësimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit. Në kërkesë pasqyrohet se që prej datës së njoftimit të aksidentit të ndodhur vëllait të saj, 14.7.2017, e deri në datën e kësaj kërkesë, ajo ka qenë në pritje të përfundimit të hetimeve dhe zbardhjes së arsyes së vdekjes së vëllait të saj.

46.4.3 Denoncuesja ankohet se prokurorja së bashku me gjyqtaren e çështjes kanë bashkëpunuar duke shkelur ligjin dhe manipuluar çështjen.

46.4.4 Sipas vendimit të drejtuesit të organit të akuzës në dhjetor 2018, thuhet se çështja është dërguar për gjykim në datën 19.11.2018 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt gjykimin e kësaj shtetaseje, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe pushimin e çështjes penale për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal.

46.4.5 Në një memo të depozituar nga denoncuesja thuhet se vetëm pas njohjes me vendimin e drejtuesit të prokurorisë për mospranimin e kërkesës për përjashtimin e prokurores, ata kanë ardhur në dijeni të faktit se hetimi i çështjes kishte përfunduar.

46.4.6 Komisioni, për të qartësuar këtë çështje, në nivelin që ishin aktet e depozituara nga denoncuesi, i kërkoi subjektit: (a) të shpjegojë rolin/pozitën e saj në këtë çështje, si dhe mbi pretendimet e denoncueses për zvarritje të saj/çështjes; (b) të dokumentojë veprimet hetimore të kryera prej saj, përfshirë njoftimin e përfundimit të hetimeve familjarëve të viktimës; (c) të sqarojë dhe dokumentojë deri aktualisht statusin e çështjes.

46.4.7 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se fillimisht në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar procedimi penal nr. ***, datë 16.7.2017, me hetimin e të cilit është ngarkuar prokurori E.SH, për shkak të gatishmërisë. Materialet janë referuar në ngarkim të shtetases A.S për veprat penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga nenet 290 dhe 291 të Kodit Penal.

⁶⁵ Nr. *** prot., datë 5.12.2018 dhe nr. *** prot., datë 13.5.2019, administruar në dosjen e Komisionit.

46.4.8 Subjekti ka prezantuar një përmbledhje të historikut të çështjes. Ajo ka konfirmuar se me transferimin e prokurorit E.SH, të komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme, kjo çështje është shortuar sipas shortit datë 15.1.2018 dhe hetimi i kësaj dosjeje i ka kaluar asaj.

46.4.9 Subjekti ka konfirmuar se zgjatja e parë është datë 16.1.2018, me një afat tre muaj, pasi në vlerësimin për këtë çështje duhet të administroheshin të dhënat nga kompanitë telefonike të nisura nga prokurori i mëparshëm, këqyrjet e tabulateve, si palët duhet të njiheshin me aktin e ekspertimit për të paraqitur pretendimet e tyre. Zgjatja tjetër, nga data 16.4.2018 deri më 16.7.2018, është kryer me qëllim që të verifikoheshin pretendimet e shtetasës M.M, ish-bashkëshortja e viktimës B.M, mbi aktin e ekspertimit autoteknik. Po kështu, pretendime mbi aktin e ekspertimit autoteknik ka paraqitur edhe mbrojtja e shtetasës A.S. Është parë e nevojshme që shtetasja A.S të jepte shpjegime në lidhje me tabulatet telefonike dhe pretendimet e motrës së viktimës K.M dhe ish-bashkëshortes së tij M.M më tej, nga data 16.10.2018 deri më 16.1.2019, për shkak të pritjes së aktit të riekspertimit mjekoligjor. Nga administrimi i aktit të ekspertimit autoteknik datë 11.10.2017, rezulton se mjeti tip “Mercedes-Benz” që drejtohej nga shtetasja A.S ka qenë me shpejtësi brenda normave të lejuara. Aksidenti ka ndodhur duke përplasur kokën viktimës me këndin e pasmë të krahut të djathtë, të mjetit tip “Kamionçinë Benz” me targë ***. Kjo goditje ka ardhur për shkak të mosmarrjes parasysh të pasagjerit të distancës me mjetin e parkuar përpara në të djathtë të karrexhatës sipas drejtimit të lëvizjes së mjetit. Nga ana e drejtuesit të mjetit tip kamionçinë nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Nga ana e drejtuesit të mjetit tip “Mercedes-Benz” me targë ***, konstatohen shkelje të nenit 115/1 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, ku thuhet se: *“Nuk mund të drejtohen automjete dhe motomjete pa marrë lejedrejtimin e lëshuar nga dega e përgjithshme e shërbimeve të transportit rrugor, e cila përfshin rrethin e banimit”*. Subjekti ka vjuar të shpjegojë se si ka ndodhur ngjarja/aksidenti.

46.4.10 Subjekti ka sqaruar se në këto rrethana kjo çështje është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ngarkim të shtetasës A.S, datë 19.11.2018, për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal, si dhe kërkesa për pushimin e procedimit penal për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, pasi faji rezultonte i viktimës.

46.4.11 Me vendimin nr. ***, datë 5.4.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes ndaj shtetasës A.S për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe pushimin e çështjes për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë 27.6.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 5.4.2019, për pjesën e pushimit, duke urdhëruar prokurorinë të vazhdojë hetimet, që lidhen me kryerjen e riekspertimit autoteknik, ndërkohë që me vendimin nr. ***, datë 20.6.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur të deklarojë fajtores shtetasën A.S dhe ta dënojë atë me 1 në vit e 3 muaj burgim. Në gjykim të shkurtuar i ulet 1/3 e dënimit dhe vuajta e dënimit fillon nga data 14.7.2017, pasi rezultonte që kjo shtetase, për shkak se ka qenë edhe me masë sigurimi “Arrest në burg”, kishte kryer dënimin.

46.4.12 Subjekti ka shpjeguar në lidhje me konkluzionet e aktit të ekspertimit autoteknik lidhur me: pretendimet që ka pasur shtetasja K.M gjatë hetimit për vrasje të vëllait të saj B.M nga e

dashura e tij A.S, në bashkëpunim me persona të tjerë; marrjen e vendimit për ekspertim telefoni të vendimit të riekspertimit mjekoligjor i njoftuar palëve; administrimin e tabulateve telefonike lidhur me riadministrimin e kartelave mjekësore të viktimës etj. dhe sipas subjektit nuk ka rezultuar ekzistenca e veprës penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe as nuk janë konstatuar elemente të ndonjë vepre penale tjetër, aq më pak të vrasjes, si ka pretenduar kjo shtetase.

46.4.13 Subjekti ka depozituar shkresat e njoftimeve të vendimeve, procesverbalet e akteve të dosjes së gjykatës në lidhje me veprimet hetimore, si dhe vendimmarrjet mbi memot e kësaj shtetaseje dhe ka sqaruar se në datën 7.7.2020 ka paraqitur *kërkesë për pushimin e këtij procedimi penal, në përfundim të të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme, duke kryer çdo veprim hetimor të pretenduar nga ankuesja*. Gjithashtu, ajo ka sqaruar se në lidhje me pretendimet e kësaj shtetaseje për ndonjë sekser apo për elemente korruptive në drejtim të saj, këto pretendime janë shpifje dhe se nuk ka asnjë lidhje me sjellje dhe shpifje të tilla. Subjekti ka sqaruar se veprimet hetimore në këtë dosje janë të plota dhe çdo vendimmarrje është e arsyetuar dhe e bazuar në akte shkresore.

46.4.14 Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 19.1.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e çështjes, për të cilin sqaron se nuk ka marrë formë të prerë, si dhe vendimin nr. ***, datë 20.6.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilin sqaron se është vendosur deklarimi fajtor i shtetases A.S në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

46.4.15 Në lidhje me njoftimin e kërkesës për pushim dhe përfundim hetimesh, si dhe kërkesës së gjykimit sipas nenit 328/2 i Kodit të Procedurës Penale (pasi njëkohësisht është zbritur edhe kërkesa për gjykim dhe ajo e pushimit), subjekti ka konfirmuar se janë njoftuar me shkresën nr. *** prot., datë 22.7.2020, shtetaset M.M, B.T për K.M etj., për të cilën gjithashtu ka depozituar fletën e protokollit dhe akte të dosjes mbi ekspertimet, memoriet e ankueses, vendimin mbi memoriet e paraqitura etj.

46.4.16 Lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 16.7.2017⁶⁶, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ngarkim të shtetases A.S, për veprat penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuara nga nenet 290 dhe 291 të Kodit Penal, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dërguar për gjykim në datën 19.11.2018 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesën me objekt gjykimin e kësaj shtetaseje, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe pushimin e çështjes penale për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal. Kjo e fundit është rikthyer nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 27.6.2019, për hetime të tjera.

46.4.17 Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, Komisioni konstatoi se subjekti: (a) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për të përcaktuar qartë të gjithë mekanizmin e ngjarjes dhe sqarimin e rrethanave mbi dëmtimet e konstatuara tek viktimat nga ekspertët mjekoligjorë; (b) ka munguar në respektimin e afateve të caktuara nga gjykata, pasi Komisioni konstaton se hetimet

⁶⁶ Ndjekur fillimisht nga një subjekt tjetër rivlerësimi. Sipas shortit datë 15.1.2018, hetimi ka vijuar të ndiqet nga subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela.

duhet të kryheshin brenda 2 muajve, ndërsa kërkesa për pushimin e çështjes nga subjekti ishte dërguar në Gjykatë në datën 7.7.2020, pas 6 muajve. Edhe në konsideratë të shpjegimeve të subjektit Komisioni konstatoi se përsëri afati i kryerjes së hetimeve pas kthimit nga Gjykata e Apelit është tejkaluar me 4 muaj; (c) nuk ka ndërmarrë veprime hetimore nga momenti i disponimit të akteve të procedimit penal nr. ***, rezultuar me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë për kthimin e çështjes, shkurt 2020 – 10.3.2020, kur edhe ka marrë vendimin për kryerjen e riekspertimit autoteknik (detyrë e lënë nga gjykata), si dhe pas rreth 4 muajve po nga disponimi i dosjes, në datën 19.5.2020 ka marrë vendimin për eksperimentin hetimor.

46.4.18 Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, duke i përfshirë mangësitë e konstatuara në vendimin e pezullimit të subjektit për ushtrimin e detyrës dhe dërgimin në Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

46.5 Denoncim⁶⁷ i shtetasit M.M

46.5.1 Denoncuesi ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar disa pretendime. Ai ankohet se nga subjekti i rivlerësimit po hetohen disa çështje në të cilat është person nën hetim. Në renditjen e çështjeve sqaron se njëra prej tyre, ku sipas tij njihet autori i cili e ka goditur e kërcënuar, vijon të zgjatet për 4 vite radhazi. Denoncuesi pretendon se personi i cili e ka goditur është shtetasi E.Z, djali i tezes së ish-gjyqtarit A.M, i cili ka njohje me subjektin e rivlerësimit. Ai pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka administruar në hetim kamerat e një biznesi ku identifikohet autori i ngjarjes dhe se ky fakt ndodh për shkak të ndikimit të kolegut të saj.

46.5.2 Denoncuesi sqaron se subjekti e ka zvarritur çështjen pa arsye, e ka lënë atë pa veprime, pa autor dhe e ka kualifikuar si plagosje. Denoncuesi, si një ndër pronarët e pasurisë ndërtim i zhvilluar mbi truallin e tij dhe të tjerë bashkëpronarë, situatën e kësaj çështjeje e lidh me një konflikt pronësor mes shtetases R.B dhe dhunuesit të apartamentit të saj, A.M, por njëkohësisht dhunues edhe fizikisht e psikologjikisht ndaj shtetases B. Ai pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk vepron në zbardhjen e çështjes së konfliktit pronësor (dhunim banese), i cili sipas tij vjen si pasojë e veprimeve të vëllait të A.M. Në vijim, denoncuesi ankohet për çështjen penale që i përket procedimit nr. ***, me kallëzuese O.O, ku subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim për kryerje të aktit të ekspertimit. Ai sqaron se çështja është vënë në lëvizje nga motra e tij, kallëzuesja O.

46.5.3 Denoncuesi ankohet pasi, pavarësisht se është njohur me vendimin për kryerjen e aktit të ekspertimit, nuk kupton pozitën e tij procedurale në akt. Më konkretisht, ankohet se për shkak të mbivendosjes së kontratave kanë ardhur edhe mbivendosjet e pronave dhe tjetërsimet e tyre. Denoncuesi pretendon se është marrë i pandehur nga subjekti i rivlerësimit, e ndikuar nga kolegu i saj A.M, me qëllimin e vetëm për të qenë nën presion dhe kërcënime. Standardin e parashtruar ai e quan shpërdorim detyre nga subjekti i rivlerësimit dhe sipas tij ajo po vepron në konflikt të hapur interesi, duke qenë e implikuar me z. M, të cilin për shkak të problematikave pronësore e quan armikun e tij. Denoncuesi ka depozituar: (i) urdhrin e subjektit të rivlerësimit, datë 12.1.2018, për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal dhe për regjistrimin e emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale,

⁶⁷ Nr. *** prot., datë 12.1.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

shtetasit E.Z; (ii) vendimin datë 13.1.2018 të subjektit të rivlerësimit për arrestimin në flagrancë të shtetasit E.Z; (iii) kërkesën e tij/denoncuesit për *përrjashtimin e subjektit të rivlerësimit*, duke arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka bërë kualifikim të padrejtë të veprës penale, ka lënë çështjen pa autor e zvarrit çështjen prej 4 vitesh, nuk ka hetuar për të grumbulluar provat, me qëllim për të mos dalë e vërteta; (iv) vendimin pa datë për kryerjen e aktit të ekspertimit, i përcjellë për dijeni edhe denoncuesit në datën 29.12.2021, që i përket procedimit penal nr. ***.

46.5.4 Në nivelin që ndodhen provat nuk rezultuan të dhëna mbi veprimet hetimore të kryera për çështjen objekt hetimi.

46.5.5 Komisioni administroi⁶⁸ fashikullin penal, që i përket procedimit nr. ***. Nga verifikimi i akteve rezultoi:

a. Paraprakisht provohet se procedimi penal ka zgjatur për më shumë se tri vite (2018) dhe ky konstatim rezulton nga krahasimi i të dhënave në urdhërimin e subjektit për të regjistruar emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe shkresës përcjellëse për njohje me vendimin për kryerjen e aktit të ekspertimit.

b. Në bazë të të dhënave të pasqyruara në dokumentacionin e hetimit për procedimin penal nr. ***, për pretendimin e denoncuesit se subjekti i rivlerësimit ka lënë pa autor çështjen e këtij procedimi penal, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë kryer hetime paraprake. Bazuar në procesverbalin datë 11.1.2018, për njohje të personit me fotografi nga shtetasi i dhunuar M.M, kryer nga oficerët e policisë gjyqësore GJ.V dhe A.S në ambientet e spitalit të Vlorës, si dhe provave të pamjeve filmike të marra në vendngjarje, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arresti në flagrancë” të shtetasit E.Z. Me kërkesën datë 13.1.2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për shtetasin E.Z, i dyshuar për veprën penale “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89⁶⁹ i Kodit Penal.

c. Nga dokumentacioni i depozituar për procedimin penal nr. ***, Komisioni konstatoi se procedimi është bashkim i dy procedimeve penale për të njëjtin fakt hetimi i ardhur nga vendimi⁷⁰ i Prokurorisë së Rrethit Vlorë. Subjekti i rivlerësimit në zbatim të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka kryer hetime paraprake dhe ka urdhëruar ekspertim të vendngjarjes për procedimin penal nr. ***, ka kërkuar procedim penal bazuar në nenin 277⁷¹ të Kodit Penal për veprën penale “Vetëgjyqësia” ndaj shtetasin M.M.

ç. Me urdhrin datë 26.5.2021, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e materialit si procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

⁶⁸ Përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

⁶⁹ Neni 89/Plagosja e lehtë me dashje: “Plagosja e kryer me dashje, që ka shkaktuar paafësi të përkohshme në punë më tepër se 9 ditë përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet”.

⁷⁰ Vendim i Prokurorisë së Rrethit Vlorë datë 27.9.2021: “Meqenëse është i njëjti fakt, ardhur nga i njëjti kallëzues, shtetasja O.O, me të njëjtin person të dyshuar, shtetasin M.M, vendos bashkimin e 2 vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë 1) nr. *** dhe 2) nr. ***, për fillim të hetimit nga e njëjta prokurorë të procedimit penal nr. ***”.

⁷¹ Neni 277/Vetëgjyqësia: “Ushtrimi i një të drejte prej personit që i përket ose që kujton se i përket dhe që nuk njihet nga tjetri pa iu drejtuar organit kompetent shtetëror përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”.

d. Në datën 27.9.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur bashkimin e procedimit penal nr. *** me procedimin penal nr. ***, i cili gjithashtu ka qenë nën hetim po nga subjekti i rivlerësimit.

dh. Në datën 1.4.2022, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, M.M, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

e. Me vendim (pa datë) subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen e aktit të ekspertimit për verifikim në terren të objekteve të ndërtuara dhe cenimit/dhunimit të tyre (nëpërmjet ndërrimit të bravës).

ë. Në datën 5.5.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e procedimit penal nr. *** kundër të pandehurit M.M, akuzuar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

46.5.6 Në gjendjen që ndodheshin dukej se nga regjistrimi i procedimit penal deri në regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale kishte kaluar pothuajse një vit pa u ndërmarrë veprime procedurale, pa u cilësuar gjatë kësaj periudhe me akt, veprime të tjera hetimore për t’u kryer dhe pa u dokumentuar ndonjë veprim i kryer. Vendimi për aktin e ekspertimit pa datë pamundësonte konkluzionin e kryerjes së veprimit hetimor në kohë ose jo.

46.5.7 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoj subjektit: (a) të shpjegonte dhe dokumentonte të kundërtën e konstatimeve, duke provuar me dokumentacion kryerjen e veprimeve hetimore, si dhe të konfirmonte e dokumentonte statusin aktual të kësaj çështjeje hetimore.

46.5.8 Subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është regjistruar materiali kallëzues nr. ***, datë 8.1.2021, i cili sipas formularit të shortit elektronik datë 22.1.2021 i kishte rënë asaj për ndjekje dhe veprim. Shtetasja O.O, që rezulton motra e shtetasit M.M, ka pretenduar se ka rreth 7 apartamente tek objekti “***” sh.p.k., ku rezulton të ketë edhe shtetasi M.M. Kallëzuesja ka pretenduar se vëllai i saj i ka zaptuar dy apartamente dhe, për këtë arsye, i është drejtuar prokurorisë. Ndërkohë, shtetasi M.M ka pretenduar se nuk ka konflikte me motrën e tij. Fillimisht ky material është mosfilluar në datën 1.2.2021, me arsyetimin se nuk shfaqet si konflikt me natyrë penale, pasi janë marrëdhënie familjare që lidhen me ndarjet e pronësisë, referuar kontratave të sipërmarrjes. Ky vendim u është komunikuar palëve dhe kallëzuesja O.O ka ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjykata me vendimin nr. ***, datë 20.4.2021, ka vendosur shfuqizimin e këtij vendimi, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal me qëllim kryerjen e veprime të tjera hetimore, që lidhen me këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe marrjen e deklarimeve. Pasi vendimi ka marrë formë të prerë në datën 24.5.2021, në datën 26.5.2021 është regjistruar ky procedim penal nr. *** për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Pas regjistrimit në datën 1.6.2021 është ripyetur kallëzuesja sipas vendimit të gjykatës, e cila ka dhënë deklaratimet e saj. Gjithashtu është ripyetur sërish në datën 1.4.2022 mbi pretendimet e aktit të ekspertimit. Pasi është dërguar fletëthirrje në datën 1.6.2021, pra 6 ditë nga regjistrimi i procedimit penal datë 26.5.2021, shtetasi M.M ka dhënë deklaratime në datën 18.6.2021, i cili ka sqaruar se çështja civile mes tyre ndodhej në Gjykatën e Lartë dhe ka kërkuar kohë për të paraqitur dokumentacion, të cilin e ka depozituar me memon nr. *** prot. hyrës, datë 15.11.2021. Ndërkohë, nga ana tjetër, kallëzuesja O.O në datën 24.6.2021 ka paraqitur gjithashtu dokumente mbi pretendimet e saj me gjithë*

dokumentacionin mbi kontratat e sipërmarrjes, të energjisë elektrike, procesverbalet e dorëzimit, të marrjes në dorëzim të tyre etj.

Në datën 25.10.2021 është administruar tabela fotografike përmes oficerit të policisë gjyqësore K.L, pasi nuk rezultonte në dosje për shkak të mosfillimit dhe paraqiste rëndësi për të konkluduar mbi momentin e parë të kryerjes së veprimeve hetimore dhe që kërkohej domosdoshmërisht nga kallëzuesja.

*Më tej rezulton se është regjistruar edhe një material tjetër kallëzues nr. ***, datë 25.11.2020, i cili sipas formularit elektronik të po kësaj date është caktuar të hetohet nga unë. Po e njëjta kallëzuese O.O ndaj vëllai të saj M.M, duke pretenduar sërish së i ka dëmtuar bravat e dyerve të disa apartamenteve pranë “***” sh.p.k., ***, Vlorë dhe se nuk e lejon të hyj në banesat e saj. Në lidhje me këtë material, duke qenë se është vlerësuar si ai më lart me natyrë civile dhe që lidhet me ndarjen e pasurisë mes familjarëve, në datën 1.12.2020 është mosfilluar. Edhe ndaj këtij vendimi kallëzuesja ka ushtruar ankim në gjykatë, e cila me vendimin nr. ***, datë 10.5.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të mosfillimit dhe urdhërimin e vazhdimin të hetimeve. Në këto rrethana, duke qenë se ishin dy vendime për shfuqizimin me të njëjtat pretendime, janë regjistruar dy procedime penale me nr. *** dhe nr. ***, të cilat janë bashkuar me vendimin datë 27.9.2021, kur është regjistruar edhe procedimi i dytë”.*

46.5.9 Subjekti ka konfirmuar se: *“Duke e ditur që ishin dy çështje të shfuqizuara në muajin maj për të njëjtat fakte, me të njëjtën kallëzuese dhe të kallëzuar, është pritur që edhe kjo çështje të regjistrohej në mënyrë që të hetoheshin bashkë.*

*Me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2021, shtetasit M.M i është dërguar vendimi për kryerjen e ekspertimit dhe, pavarësisht faktit që nuk ka në vendim datë, ai ka shkresën përcjellëse datë 29.12.2021, e cila provon datën e këtij akti. Me marrjen e këtij njoftimi me shkresën nr. *** prot. hyrës, datë 7.1.2022, ky shtetas ka bërë memo mbi aktin e ekspertimit e duke ngritur pretendimet e tij, pra provohet dijenia e tij. Gjithashtu, ka bërë edhe kërkesë për përjashtim në datën 6.1.2021, për të cilën është marrë vendim mospranimi. Sërish janë depozituar dokumente nga palët për konfliktin mes tyre datë 1.12.2021 nga shtetasi M.M dhe po kështu në datën 7.1.2022, si dhe është kërkuar përjashtimi im si prokurorë.*

Në datën 31.1.2022 është administruar akti i ekspertimit dhe pasi palët janë njoftuar, shtetasi M.M nuk paraqitej më në organin e akuzës për pretendime në lidhje me këtë fakt. Në këto rrethana, pasi janë vlerësuar të plota hetimet dhe analizuar dokumentacioni përkatës, është regjistruar emri i tij në datën 1.4.2022 dhe më pas dërguar në gjykim, me akuzën e vetëgjyqësisë, referuar edhe aktit të ekspertimit.

Lidhur më vonesat në hetim prej një viti dhe në lidhje me regjistrimin e emrit dhe dërgimin e çështjes në gjykim, është parë e arsyeshme të analizohet mirë çdo provë shkresore e administruar nga palët dhe është analizuar drejt edhe konflikti civil mes tyre, që aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë (referuar edhe ngarkesës për shkak të mungesës së prokurorëve si pasojë e Vetting-ut dhe faktit që unë kam qenë në seksionin e të miturve dhe dhunës në familje, ku numri i arrestimeve dhe çështjeve të gjyqit është i lartë, në këtë drejtim u është dhënë përparësi këtyre dosjeve për shkak të afateve të paraburgimit në raport me kundërvajtjet penale të regjistruara pranë kësaj

prokurorie)”. Aktualisht ka konfirmuar subjekti, çështja është në gjykim me gjyqtarin Hektor Sinani.

46.5.10 Komisioni konstatoi se lidhur me procedimin penal nr. ***, datë 27.9.2021, regjistruar si bashkim i procedimit penal nr. ***, datë 26.5.2021 dhe procedimit penal nr. ***, datë 27.9.2021, ndaj shtetasit M.M, akuzuar për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka mosfilluar dy kallëzime të shtetasës O.O, e cila ka pretenduar për zaptim të dy apartamenteve në pronësi të saj nga shtetasi M (vëllai i znj. O).

46.5.11 Nga aktet në dosje Komisioni konstatoi se kjo shtetase kishte depozituar materialin kallëzues nr. ***, datë 25.11.2020, i cili ishte mosfilluar nga subjekti i rivlerësimit në datën 1.12.2020 dhe mbi ankimin e saj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, kjo e fundit kishte shfuqizuar vendimin e mosfillimit të subjektit me vendimin nr. ***, datë 10.5.2021. Po ashtu, kjo shtetase kishte depozituar përsëri në organin e akuzës kallëzimin penal nr. ***, datë 8.1.2021, i cili gjithashtu ishte mosfilluar nga subjekti i rivlerësimit në datën 1.2.2021. Mbi ankimin e shtetasës O.O, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë kishte shfuqizuar përsëri vendimin e subjektit të rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 20.4.2021. Në të dyja vendimet urdhërohej regjistrimi i personit të cilit i atribuohet vepra penale dhe vazhdimi i hetimeve duke përcaktuar, ndër të tjera, edhe kryerjen e aktit të ekspertimit etj. Në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm u konstatua se subjekti i rivlerësimit në mënyrë të përsëritur ka reaguar me të njëjtin qëndrim/vendim mosfillimi mbi të njëjtin material kallëzues, mbi të njëjtat fakte e objekt kallëzimi. Subjekti i rivlerësimit ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në datën 27.9.2021, pas 4 muajve nga vendimi i gjykatës nr. ***, datë 10.5.2021, ku urdhërohej regjistrimi dhe vazhdimi i hetimeve.

46.5.12 Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit penal të bashkuar në një të vetëm, ka munguar të kryejë veprimet hetimore në kohë, sikurse ka disponuar me vendim për kryerje të aktit të ekspertimit për verifikim në terren të apartamenteve, në datën 29.12.2021, pas 3 tri muajve nga regjistrimi i procedimit penal datë 27.9.2021.

46.5.13 Trupi gjykues mangësitë e konstatuara në këtë çështje i ka trajtuar/përfshirë në vendimin e pezullimit të ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit, për dërgimin e saj në Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

46.6 Mbi denoncimin e shtetasit K.B lidhur më çështjen penale nr. *** akti, datë 7.2.2022, ku ai është në cilësinë e viktimës. Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, Komisioni konstatoi mospraninë e subjektit të rivlerësimit si prokuror i çështjes (edhe pse në procesverbalet e seancave gjyqësore konfirmohet se është thirrur), në disa seanca në gjykimin e kërkesës ndaj shtetasit G.D, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, për të cilin është regjistruar procedimi nr.***, datë 4.12.2020, pa paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm, përveçse provoi mungesën e saj në seancën gjyqësore të datës 28.3.2023, me depozitimin e kartelës së pacientit.

46.6.1 Subjekti në lidhje me këtë denoncim, ndër të tjera, ka sqaruar⁷² se në seancat gjyqësore të datave 3.5.2023, 30.5.2023 dhe 5.7.2023 ka qenë në punë. Ajo ka sqaruar se në datën 28.3.2023

⁷² Mbi kërkimin e Komisionit me *email*-in datë 9.10.2023.

ka qenë e vetmja datë e këtyre seancave kur nuk ka qenë në punë dhe për këtë ka depozituar kartelën mjekësore të dentistit në Tiranë tek “***” ku, sipas saj, pikërisht në datën 28.3.2023 i është nënshtruar mjekimit në këtë klinikë dentare. Subjekti ka renditur pjesëmarrjen e saj në disa procese gjyqësore, duke konfirmuar datën dhe orën. Subjekti ka theksuar se si prokurore është shumë korrekte në përfaqësimin e saj në çdo seancë gjyqësore me çdo gjyqtar... Ajo ka parashtruar se ditën që është shtyrë procesi me shtetasin G.D ka pasur proces me të njëjtin gjyqtar për të pandehurin E.M, ku ka qenë e pranishme, pasi të gjitha palët kanë qenë të pranishme. Ajo ka kundërshtuar pretendimin e denoncuesit nën argumentin se nuk ka sesi të jetë në një seancë gjyqësore me këtë gjyqtar në fillim të ditës... dhe më pas të mos i japë asnjë adresë gjykatës mbi pamundësinë e paraqitjes së saj apo largimit të saj nga vendi i punës, ndërkohë që me çdo gjyqtar tjetër, thekson se është pasqyruar arsyeja e vonesës apo mosparaqitjes së saj. Subjekti ka kundërshtuar nën argumentin se nëse ajo do të shfaqte probleme në zvarritje seancash, nuk do mungonte vetëm në këtë proces gjyqësor, por do të krijonte zvarritje edhe në proceset e tjera, gjë që në fakt, thekson ajo, nuk ka ndodhur nga procesverbalet e seancave të tjera gjyqësore në këto data. Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar se kjo çështje është dërguar për gjykim nga prokurori M.S dhe se ajo më pas e ka marrë çështjen në gjykim, pasi ajo kishte kaluar pas largimit të këtij prokurori tek prokurori E.M. Subjekti ka konfirmuar se i pandehuri është dërguar në gjyq në gjendje të lirë, ka firmosur aktet e përfundimit të hetimit dhe rezulton i padënuar më parë. Subjekti ka theksuar faktin se *shumë seanca nuk fillojnë në orar, për shkak të angazhimeve të avokatit, prokurorit apo edhe vetë gjykatës në gjykimet me tre anëtarë, si dhe faktin se ka probleme me shoqërimin e të arrestuarve, apo për shkak edhe të numrit të lartë të proceseve gjyqësore, duke konfirmuar në këtë mënyrë angazhimin për të gjetur një formë mirëkuptimi për moszvarritje procesesh, duke qenë në kontakt qoftë edhe telefonik mbi oraret e fillimit të tyre po shkaqet e mosparaqitjes tonë.* Subjekti ka depozituar kopje të kërkesës për gjykim, shkresën e gjykatës me seancat gjyqësore të përfaqësuara prej saj në datat e ankesës, fletën e kalendarit të saj të punës, si dhe kartelën mjekësore.

46.6.2 Trupi gjykues pas verifikimit të dokumentacionit të administruar vërejti se subjekti nuk arriti të provojë mungesën e saj në procesin gjyqësor (objekt i këtij denoncimi) me ndonjë prej shkaqeve objektive të pretenduara prej saj (pasi në procesverbalet e depozituara rezultoi se ishte thirrur dhe nuk ishte paraqitur në proces gjyqësor) dhe, për pasojë, vlerësoi se ajo shfaq mangësi në drejtim të efektivitetit të zhvillimit të procesit gjyqësor me rolin e saj si prokurore e çështjes dhe përfaqësuese e organit të akuzës. Në këto kushte, mangësinë e konstatuar trupi gjykues e ka trajtuar/përfshirë në vendimin e pezullimit të ushtrimit të detyrës nga subjekti i rivlerësimit për dërgimin e saj në Shkollën e Magjistraturës për të ndjekur programin e trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë.

47. Gjetje të tjera

47.1 Nga aksesi në median e shkruar *online*⁷³, publikohet lajmi i një super operacioni policor në Ll dhe D në Vlorë, në vitin 2017, ku u sekuestruan 20 tonë drogë dhe u arrestuan 9 persona si të dyshuar, pjesëtarë të një grupi trafikantësh, që janë liruar vetëm dy ditë pas arrestimit.

⁷³ https://tirana***

47.2 Sipas shkrimit në media, informohet se prokurorja znj. Flora Çela tri ditë pas superoperacionit policor në Ll dhe D është drejtuar me kërkesë për lirimin e shtetasve M.T dhe E.T, duke kërkuar detyrimin e tyre për paraqitje në policinë gjyqësore dhe jo masën e arrestit në burg.

47.3 Për këtë çështje:

i. Komisioni i kërkoi subjektit: (a) të shpjegojë në detaje lidhur me ngjarjen e bërë publike; (b) të sqarojë rrethanat e çështjes objekt hetimi; (c) të sqarojë dhe dokumentojë kërkimin e saj për masën e sigurimit personal për secilin shtetas, të sqarojë arsyet, faktet dhe rrethanat mbi të cilat u bazua për të kërkuar masën e sigurimit personal “Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore”, në raport me rrezikshmërinë e veprës penale të bërë publike dhe dënimin e parashikuar për të; (iv) të qartësojë nëse në vijim ka pasur kërkesa të tjera për zëvendësim të masës së sigurimit personal dhe çfarë është vendosur për to, duke depozituar edhe çdo dokumentacionin mbështetës.

ii. Po ashtu, Komisioni i kërkoi subjektit: (a) të shpjegojë nëse kjo çështje është hetuar më tej nga ana e saj; dhe në varësi të kësaj të fundit i kërkoi (b) të qartësojë dhe dokumentojë veprimet hetimore të kryera, njoftimin e akuzës, kohën e zgjatjes së kryerjes së hetimeve, kërkimin e saj në gjykatë për themelin e çështjes, vendimmarrjen e organit gjyqësor, si dhe statusin aktual të çështjes.

iii. Komisioni i kërkoi subjektit të mbështesë me dokumentacion (urdhra, vendime, procesverbale, kërkesa drejtuar gjykatës, diskutim/e përfundimtare, njoftim akuze, vendim/e gjyqësore etj.) të gjitha shpjegimet e dhëna lidhur me këtë çështje objekt hetimi.

47.4 Subjekti ka shpjeguar se: *“Nga aktet e procedimit penal rezulton se nga ana e Drejtorisë së Policisë Vlorë, seksioni kundër narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, në datën 13.7.2017 është marrë informacion mbi një sasi të konsiderueshme lëndë narkotike të llojit cannabis sativa të ndodhur në fshatin D, Vlorë. Menjëherë me marrjen e këtij informacioni, është organizuar grupi i punës, duke shkuar shërbimet në vendin e ngjarjes. Fillimisht objekt këqyrjeje është një banesë në fshatin D, Vlorë, e pabanuar aktualisht, e cila sipas informacioneve rezultonte të ishte në pronësi të shtetasit Z.A, i cili nuk jeton në Shqipëri, por i larguar jashtë vendit. Në lidhje me informacionet policore mbi këtë fakt nga shërbimet e policisë gjyqësore, është kërkuar të vendoset në përgjim një numër telefonik, i cili i përkiste shtetasit R.T, banues në Vlorë. Me vendimin datë 13.7.2017, është autorizuar përgjimi telefonik i numrit të shtetasit R.T, përgjim i cili është vlefshësuar me vendimin nr. ***, datë 15.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pas këqyrjes së kësaj banese, nga ana e grupit hetimor ka vazhduar kontrolli i mëtejshëm në këtë fshat, duke u kapur në flagrancë në banesën e tij shtetasi R.A me një sasi lëndë narkotike, për të cilin ka pasur edhe mjet përpunues për vaj hashashi. Konkretisht, në momentin që është shkuar në banesën e këtij shtetasi, janë gjetur në objektin ku strehohej lëndë narkotike edhe disa filxhanë kafeje dhe pjesa e banesës ishte rrethuar me lule të ujitura. Gjithashtu, ky shtetas është gjetur në vendin e ngjarjes. Më tej është ushtruar kontroll i imtësishëm i territorit dhe në banesën dykatëshe të shtetasit L.L, inspektor i policisë në këtë zonë, ku janë konstatuar kubikë të kultivimit të bimës narkotike cannabis sativa, si dhe bimë të mbjella të cannabis sativa. Nga verifikimet ka rezultuar se banesa ishte në pronësi të përbashkët të shtetasit L.L dhe A.L, vëllait të tij, të cilët janë gjetur në vendin e ngjarjes. Operacioni i radhës ishte në banesën e shtetasit K.T dhe djalit të tij E.T, ku në një magazinë afër banesës së tyre janë gjetur dy thasë me lëndë narkotike, si dhe në mjetin e*

parkuar në oborrin e banesës është konstatuar lëndë narkotike. Duke qenë se në banesat e shtetasve A.L dhe L.L, oficer policie, K.T, E.T e R.A janë gjetur dhe sekuestruar lëndë narkotike të llojit cannabis sativa. Nga oficerët e policisë gjyqësore është kryer arrestimi në flagrancë i tyre, duke më dakordësuar edhe me mua si prokurore e pranishme gjatë këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe më tej është caktuar masë sigurimi edhe për shtetasin B.GJ, kryeplak fshati, e A.S, inspektor zone. Për të gjithë këta shtetas është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg nga ana ime. Për shkak të forcave të shumta policore, banorët në fshat filluan ta hidhnin lëndën narkotike me qëllim fshehjen e saj nëpër toka bujqësore. Në vijim të këtij operacioni, për shtetasit R.T, M.T dhe E.T është vendosur të mbahen në përgjim dhe hetimi të vazhdojë me metoda speciale. Ndërkohë, në datën 14.7.2017, rreth orës 00:25 nga shërbimet e policisë gjyqësore është kryer me iniciativën e tyre arrestimi i shtetasve E.T dhe M.T dhe pse sipas komunikimit me qendrën e përgjimit në Tiranë, nuk ka pasur të dhëna për implikim të tyre deri në atë moment (pasi transkriptet janë marrë më vonë). Pas arrestimit të shtetasve M.T dhe E.T, janë ushtruar kontrole në banesat e tyre dhe nuk kanë rezultuar të dhëna me interes për hetimin dhe as nuk janë administruar prova që të lidhen me hetimin. Po kështu, as nga kontrolli personal i tyre nuk janë gjetur sende të kundërligjshme që të lidhin me veprën penale, pra lëndën narkotike të sekuestruar në banesën e shtetasit Z.A, referuar kjo edhe disa deklarimeve të marra në vendin e ngjarjes”. Pra, ndodhur në rrethana të tilla, ajo shpjegon se nuk ka qenë dakord për arrestimin e tyre, me arsyetimin se duhet të vazhdonte përgjimi i këtyre shtetasve, ashtu sikurse ishte urdhëruar një natë më parë, në datën 13.7.2017, dhe në vlerësimin e saj duhet të mbaheshin në vëzhgim nëse dyshimi ka qenë në drejtim të këtyre shtetasve sipas të dhënave policore.

47.5 Për këto arsye, duke qenë se një pjesë e personave të arrestuar në kuadër të këtij operacioni janë kapur në flagrancë, në banesat e tyre është sekuestruar edhe lënda narkotike, ndaj tyre është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg”, ndërsa për shtetasit E.T dhe M.T, në kushtet kur: (a) nuk ishin kapur në flagrancë në banesën e shtetasit Z.A, ku ishte gjetur lënda narkotike; (b) kanë qenë në përgjim; (c) nuk janë gjetur sende të kundërligjshme në kontrollin e banesave të tyre në fshat dhe në qytet; (ç) nuk janë gjetur të dhëna në aparatet telefonike – ajo ka konfirmuar se është caktuar masa e sigurimit “Detyrim për paraqitje”, parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal.

47.6 Subjekti ka dhënë shpjegime të arsytimit duke iu referuar: (a) nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit askush nuk mund t’i nënshtrohet masave të sigurimit personal nëse në ngarkim të tij nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm dhe i bazuar në prova, si dhe në rastet kur ka shkaqe padënueshmërie ose shuarje të veprës penale; (b) nenit 229 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit masa e sigurimit duhet të caktohet në raport me rëndësinë faktit, sanksionin që parashikohet për veprën penale, rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parashikuara nga Kodi Penal, si dhe duhet të jetë e përshtatshme me nevojat e sigurimit në çdo rast konkret; (c) nenit 251 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se 5 vjet.

47.7 Subjekti ka vijuar të shpjegojë gjerësisht lidhur me rolin e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore, të cilët kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se 2 vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilin ligji cakton

dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se 10 vjet etj.

47.8 Në arsyetim të sa më sipër, subjekti ka konfirmuar se: (a) shtetasit M. dhe E.T nuk janë kapur në flagrancë menjëherë pas kryerjes së veprës penale gjatë ndjekjes së tyre apo me sende dhe prova materiale që i përkasin veprës penale në fjalë; (b) nga kontrollet personale dhe të banesës së tyre nuk janë administruar sende të kundërligjshme që të lidhen me veprën penale; (c) së bashku me shtetasin R.T kanë qenë persona ndaj të cilëve po aplikoheshin metoda speciale të hetimit proaktiv, përgjimi telefonik sipas vendimit të prokurorit; (ç) nga të dhënat e qendrës së përgjimeve deri në momentin e arrestimit të tyre nuk janë transkriptuar biseda që lidhen me faktin penal; (d) banesa ku është gjetur lënda narkotike nuk ka qenë e këtyre shtetasve dhe nuk ka pasur të dhëna të tjera për mirëmbajtësin e saj.

47.9 Subjekti vlerëson se: *“Pavarësisht faktit se ndodhemi para një fakti penal të rëndë, masa e sigurimit duhet të caktohet në raport me nevojat e sigurimit në çdo rast konkret dhe në këtë rast nuk kam vlerësuar të drejtë një masë sigurimi shtrënguese arrest në burg, kur mund të vazhdoja hetimin në rrethanat e një mase tjetër sigurie, e cila, edhe nëse nuk zbatohej, e lejonte që brenda ligjit të kërkonte zëvendësimin e saj dhe kthimin e tyre nën një masë tjetër shtrënguese”.*

47.10 Në lidhje me mënyrën e zbatimit nga ana e saj të masave të sigurimit, në raste të tilla, kur gjendja e flagrancës nuk ekziston, ajo mendon se duhet të investohet organi i akuzës dhe policia në gjetjen e metodave të tjera të hetimit (përgjime, vëzhgime, administrim aktesh mbi provat e sekuestruara në vendin e ngjarjes, pra në gjetjen e një ure lidhëse mes faktit dhe personit, përtej bazueshmërisë së dyshimit mbi thjesht informacione, pa një dyshim të bazuar në prova).

47.11 Në lidhje me vazhdimin e hetimit për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, subjekti ka sqaruar se janë kryer të gjitha veprimet hetimore në drejtim të identifikimit të autorëve të saj dhe lidhjes së shtetasve M. dhe E.T, apo familjarë të tjerë të tyre me këtë ngjarje; janë administruar të gjitha aktet e ekspertimeve, ADN, daktiloskopike për gjurmët e administruara në vendin e ngjarjes, nga të cilat nuk ka pasur të dhëna në ngarkim të këtyre shtetasve; janë administruar pamjet filmike të lokalit ku ata ushtrojnë aktivitetin e tyre dhe është urdhëruar ekspertimi i pamjeve, nga të cilat nuk ka të dhëna për përfshirjen e tyre në këtë ngjarje; janë administruar të dhëna nga kompanitë telefonike dhe këqyrjet e analizimet përkatëse, nga ku nuk rezultojnë të dhëna në ngarkim të tyre për kryerjen e kësaj veprë penale; janë marrë vendime për ekspertim topografik mbi banesën e shtetasit ku është sekuestruar lënda narkotike dhe ka rezultuar jashtë shtetit, si dhe nuk kanë dalë të dhëna për përdorimin e kësaj banese nga këta shtetas; janë administruar transkriptet e përgjimeve telefonike dhe nuk kanë rezultuar të dhëna me interes në përfshirjen e tyre në kryerjen e kësaj veprë penale; janë marrë gjurmët papilare të shtetasit R.T, me qëllim krahasimin e tyre, dhe nuk kanë rezultuar të dhëna me interes për hetimin etj.

47.12 Subjekti ka konfirmuar se në përfundimin e hetimit të këtij procedimi penal nuk është provuar që këta shtetas të kenë kryer veprën penale të mësipërme dhe për këtë është dërguar kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e procedimit penal në ngarkim të tyre, pasi nuk provohej që ata të kishin kryer këtë veprë penale.

47.13 Subjekti ka konfirmuar edhe statusin e çështjes dhe, më konkretisht, ka sqaruar se me vendimin nr. ***, datë 9.7.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjyqtare V.C, ka vendosur

pranimin e kërkesës për pushimin e procedimit në ngarkim të këtyre shtetasve, vendim i cili ka marrë formë të prerë.

47.14 Subjekti ka depozituar aktet e dosjes, duke konfirmuar kryesisht ekspertime, kërkesa për ekspertime, përgjime dhe prova shkencore.

47.15 Po ashtu, ajo ka sqaruar se në raport me bërjen e lajmit publik se masa e sigurimit nuk është dënim ndaj personit në hetim, masa e sigurimit vendoset kur ka dyshime të arsyeshme dhe të bazuara në prova se një shtetas ka konsumuar një fakt penal, ekzistenca e të cilit është provuar. Në lidhje me këtë fakt, ka sqaruar se nga ana e saj në kuadër të këtij operacioni është kërkuar masa e sigurimit “Arrest në burg” për shtetasit L.L, A.L, B.GJ, K.T, R.A etj., të cilët janë dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, por që janë kapur në flagrancë me prova të veprës penale.

47.16 Subjekti ka depozituar dokumentacionin përkatës për caktimin e masave të sigurimit, me qëllim krahasimin e rrethanave të fakteve për secilin me rastin konkret objekt verifikimi, si dhe kushtet në të cilat janë dërguar në gjykim dhe masat e dënimit për secilin prej tyre të përfshirë në lajmin *online*.

47.17 Komisioni, lidhur me këtë çështje, nga dokumentacioni i administruar ka konstatuar se rasti i referohet procedimit penal nr. ***, datë 13.7.2017, regjistruar për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, si dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 283/2, 278 dhe 287 të Kodit Penal, ku sipas informacionit për referimin e veprës penale në Prokurori janë gjetur e sekuestruar në cilësinë e provës materiale 9166 kg. e 600 gr. lëndë narkotike e llojit *cannabis sativa*, 112 kg. e 500 gr. e llojit hashash, tri armë zjarri automatike kallashnikov, si dhe një arkë me fishekë, nga aktet e administruara në fashikullin e depozituar nga subjekti i rivlerësimit. Rezulton se subjekti për një pjesë të personave të arrestuar në kuadër të operacionit policor, të kapur në flagrancë, ka kërkuar masën e sigurimit “Arrest në burg”, ndërsa me kërkesën datë 15.7.2017 “Për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit”, për shtetasit E.T dhe M.T, ka kërkuar masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje”, parashikuar nga neni 234 i Kodit Penal. Nga aktet e dosjes rezultoi se subjekti në datën 23.4.2019 ka kërkuar pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasve M, E dhe R.T. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, me qëllim hetimin pasuror të shtetasve M dhe E.T dhe lidhjet me krimin në sigurimin e kësaj pasurie, ka vlerësuar të kryejë hetime për anëtarët e tjerë të familjes T. në bankat e nivelit të dytë, Qendrën Kombëtare të Biznesit, autoritetet tatimore e doganore, ZVRPP-në, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit dhe Transportit Rrugor, ndërsa sipas akteve të administruara në fashikullin penal, nuk pasqyrohen të dhëna hetimore për anëtarin e familjes R.T, i dyshuar si organizator i kësaj veprimtarie të kundërligjshme, për të cilin gjithashtu është kërkuar pushimi i procedimit. Duket se⁷⁴ subjekti në vlerësimin e kërkesës për pushimin e çështjes edhe për shtetasin R.T është mjaftuar vetëm me hetimin lidhur me transkriptimet e përgjimeve telefonike dhe gjurmët papilare të këtij shtetasi.

⁷⁴ Sipas kopjes së akteve të administruara në fashikullin e çështjes, depozituar nga subjekti i rivlerësimit.

47.18 Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, pavarësisht vendimmarrjes përfundimtare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme dhe të plota hetimore në drejtim të qartësimit të çdo rrethane dyshuese të dalë nga hetimi.

47.19 Komisioni vlerëson se subjekti shfaq mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në tregues të tillë si: aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore, kriteret të parashikuara në pikën 2 të nenit 73 dhe në pikën 1 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

47.20 Në përfundim të analizimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumenteve ligjore të paraqitura në çështjet e trajtuara më lart, trupi gjykues i Komisionit, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësisë profesionale sipas përcaktimeve të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ Ka mangësi në aftësinë për të hetuar, duke mos ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, duke mos mbledhur provat e kërkuara me ligj, duke mos interpretuar ligjin, në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kjo mangësi në rastet e analizuara në vlerësimin e trupit gjykues është e lidhur kryesisht me: (i) moskryerjen e hetimeve nga subjekti në drejtim të verifikimit të çdo dyshimi të lindur gjatë procesit hetimor, pavarësisht rezultatit përfundimtar; (ii) vlerësimin nga subjekti të rrethanave në drejtim të kualifikimit të një vepre tjetër penale, kur nga faktet rezultojnë të dhëna të tilla.
- ✓ Ka mangësi në aspektin e administrimit të akteve, mbikëqyrjen e plotësisë së tyre dhe respektimit të afateve.
- ✓ Shfaq mangësi në drejtim të prezencës së saj në ndjekjen e procedurave gjyqësore brenda kriterëve dhe afateve të nevojshme për kryerjen e një procesi të rregullt gjyqësor.

47.21 Trupi gjykues i ka çmuar këto mangësi në raport me përmbushjen e qëllimit të vlerësimit të aftësive profesionale, e sanksionuar në nenin E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësive profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Referuar nenit E, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit kualifikohet “Me mangësi”, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, nuk ka respektuar normalisht të drejtat e palëve ose viktimave, nuk është efektiv, me pasojë detyrimin nga Komisioni për të kryer program trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës, me qëllim për të plotësuar këto mangësi brenda një viti sipas përcaktimit të nenit E, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

47.22 Për këto arsye dhe për sa është analizuar më sipër, trupi gjykues, vlerëson se sipas përcaktimeve të nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konsiderohet “Me mangësi” dhe, për pasojë, u çmua që këto mangësi mund të plotësohen duke ndjekur programin e

trajnimin pranë Shkollës së Magjistraturës brenda 1 viti, për të cilën Komisioni u shpreh me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 17.10.2023.

Vlerësimi i Shkollës së Magjistraturës pas ndjekjes së programit të trajnimit

48. Bazuar në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit nr. 4, datë 17.10.2023, ku është vendosur “Pezullimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, për një periudhë njëvjeçare”, Shkolla e Magjistraturës⁷⁵, me vendimin qarkullues nr. *** “Për miratimin e planit dhe programit për subjektin e rivlerësimit të formimit fillestar për vitin akademik 2023 – 2024” të Këshillit Drejtues datë 20.12.2023, ka vendosur fillimin e ndjekjes së programit njëvjeçar të trajnimit sipas kurrikulave të miratuara nga kjo shkollë, duke konfirmuar edhe lëndët që do të ndiqeshin nga subjekti (E Drejtë penale, Procedurë penale, Shkrim dhe arsyetim ligjor, Etikë profesionale, Administrim Gjykate dhe Menaxhim i kohës). Më tej, Shkolla e Magjistraturës⁷⁶ ka konfirmuar rezultatin e arritur nga subjekti pas ndjekjes së kurrikulave të miratuara nga ky institucion. Ky institucion ka informuar se subjekti i rivlerësimit ka ndjekur rregullisht mësimin, duke filluar nga data 2.10.2023 deri më 17.5.2024 dhe se ka zhvilluar provimin përfundimtar. Informacioni konfirmon se subjekti i rivlerësimit, bazuar në mënyrën e vlerësimit të përcaktuar në rregullore dhe planin mësimor, është vlerësuar gjithsej 82.09 pikë, të cilat janë 82.09% sipas vlerësimit me shkallë dhe vlerësimi me nivele është “Mirë”. Shkolla e Magjistraturës ka konfirmuar se këto rezultate janë miratuar në Këshillin Pedagogjik dhe më pas në Këshillin Drejtues, me vendimin nr. ***, datë 30.7.2024, i cili ka miratuar vlerësimin përfundimtar për znj. Flora Çela, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky institucion ka përcjellë në formatin përkatës edhe vlerësimin përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Flora Çela, duke pasqyruar vlerësimin teorik dhe praktik të lëndëve në pikë dhe përqindje, pas të cilëve ka konkluduar përfundimisht në vlerësimin e nivelit “Mirë”.

Në vlerësimin përfundimtar për këtë kriter, trupi gjykues, duke pasur në konsideratë:

- a. Nenin E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”*;
- b. Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: *“...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)*;

⁷⁵ Referuar informacionit të dhënë për Komisionin dhe vëzhguesin ndërkombëtar, me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2023, administruar në dosjen e Komisionit.

⁷⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2024, administruar në dosjen e Komisionit.

- c. Nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë...;
- d. Pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet se: *“Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”*;
- e. Pikën 4 e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet se: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”* – çmon se:

– Për mangësitë e konstatuara në rastet e referuara sa më sipër, në raport me dispozitat e mësipërme, nuk rezultuan të dhëna/prova të mjaftueshme për t’i vlerësuar ato/mangësitë si sjellje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e subjektit në veprimtarinë profesionale të saj, si dhe nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtuësme me pozicionin e tij, sa të gjejë zbatim neni 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

49. Në përfundim, lidhur me vlerësimin e kriterit profesional, trupi gjykues i Komisionit, pasi: (i) administroi vlerësimin e ardhur nga Shkolla e Magjistraturës, e cila ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit; (ii) shqyrtoi në tërësi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë – arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Flora Çela: (a) ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në datën 16.9.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 1 dhe 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Flora Çela, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 23.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka